



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 9

Tiranë – E martë, 13 janar 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 88/2025, datë 12.12.2025	Për koncesionet dhe partneritetin publik privat.....	735
Dekret i Presidentit nr. 7, datë 8.1.2026	Për shpallje ligji.....	769
Ligj nr. 92/2025, datë 18.12.2025	Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë.....	770
Dekret i Presidentit nr. 8, datë 8.1.2026	Për shpallje ligji.....	782
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 845, datë 30.12.2025	Për krijimin e shoqërisë aksionare “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sh.a. (OSHIS sh.a.) për ofrimin e shërbimeve të integruara të procesit të sterilizimit.....	782
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1425, datë 30.12.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës.....	783
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1426, datë 30.12.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Suedisë.....	784
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1427, datë 30.12.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.....	785
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1428, datë 30.12.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Lituanisë.....	787

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1429, datë 30.12.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë	788
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1430, datë 30.12.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	790
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1431, datë 30.12.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës....	791
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1432, datë 30.12.2025	Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Ngjalës Evropiane (<i>Anguilla anguilla</i>) në Shqipëri, për periudhën 2026–2030.....	792
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1, datë 5.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	794
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 2, datë 5.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Danimarkës	795
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 3, datë 5.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	796
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 4, datë 5.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës.....	797
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 5, datë 5.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	798
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 6, datë 5.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	799
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 7, datë 5.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Letonisë.....	800
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 8, datë 5.1.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	803
Urdhër i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar nr. 16, datë 7.1.2026	Për delegim kompetencash.....	805
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 230, datë 7.1.2026	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	805

Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 294, datë 8.1.2026	Mbi denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare.....	805
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 337, datë 18.12.2025	Mbi vlerësimin e Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., për vitin 2024.....	806
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Jeto Mukaj.....	844

**LIGJ**
Nr. 88/2025**Neni 3**
Përkufizime**PËR KONCESIONET DHE**
PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT¹

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:****KREU I**
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**Neni 1**
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim krijimin e një kuadri të favorshëm e të qëndrueshëm për nxitjen, tërheqjen dhe krijimin e lehtësive për investimet, që realizohen si koncesione/partneritete publike private.

Neni 2
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon kompetencat e autoriteteve dhe të enteve kontraktuese për të hyrë në marrëveshje për investime të bazuara në koncesione/partneritete publike private, procedurat për dhënien e marrëveshjeve të tilla, si: nënshkrimi, ndërprerja dhe ndryshimet e marrëveshjeve të koncesionit/partneritetit publik privat, ndarja e risqeve fiskale, çështjet që kanë të bëjnë me rregullimet financiare dhe mbështetjen, në lidhje me koncesionet/partneritetet publike private, politikën e këtyre koncesioneve dhe autoritetin për zbatimin e tyre, si dhe çështje të tjera që lidhen me koncesionet/partneritetet publike private.

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. “Koncesion” është koncesioni i punëve publike ose koncesioni i shërbimeve publike.

2. “Koncesioni i punëve publike” është një marrëveshje me interes financiar, e lidhur me shkrim ndërmjet autoritetit ose entit kontraktues dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, objekti i së cilës është kryerja e punimeve, ku shpërblimi për punimet që duhet të kryhen përbëhet nga e drejta për të shfrytëzuar veprat, të cilat janë objekt i kontratës, ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën.

3. “Koncesioni i shërbimeve publike” është një marrëveshje me interes financiar, e lidhur me shkrim ndërmjet autoritetit ose entit kontraktues dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, objekti i së cilës është sigurimi dhe menaxhimi i shërbimeve, ku shpërblimi për shërbimet që do të sigurohen përbëhet nga e drejta për të shfrytëzuar shërbimet, që janë objekt i kontratës, ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën.

4. “E drejta për të shfrytëzuar veprat dhe/ose shërbimet” ka kuptimet e mëposhtme:

a) e drejta për të nxjerrë të ardhura, në përputhje me kontratën e koncesionit;

b) transferimi të koncesionari i një risku operacional në shfrytëzimin e atyre punëve ose të shërbimeve, që përfshijnë riskun e kërkesës ose të ofertës ose të dyja. Koncesionari konsiderohet se merr përsipër riskun operacional, kur, në kushte normale operimi, nuk garantohej rikuperimi i investimeve të kryera ose i kostove të krijuara gjatë operimit të punimeve ose shërbimeve, që janë objekt i koncesionit. Pjesa e riskut që i transferohet koncesionarit përfshin ekspozimin real ndaj ndryshimeve të papritura të tregut, në mënyrë që çdo humbje e mundshme e vlerësuar, e shkaktuar nga koncesionari, nuk është thjesht nominale ose e papërfillshme.

5. “Risku operacional” është risku që lidhet me përdorimin e veprave ose ofrimin e shërbimeve ose risku që lidhet me disponueshmërinë e objektit të infrastrukturës që ndërtohet ose përdoret për të siguruar shërbime për përfituesit fundorë, në

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me direktivën 2014/23/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 26 shkurt 2014, “Për dhënien e kontratave koncesionare”, numri CELEX: 32014L0023,

Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, f. 1–64.



përputhje me kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat.

6. “Komunikimi me shkrim” është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, të kopjohen e të komunikohen, përfshirë edhe informacionin që transmetohet e ruhet me mjete elektronike.

7. “Realizimi i punëve” është realizimi ose projektimi dhe realizimi i punëve, që lidhen me objektin e koncesionit/partneritetit publik privat ose me realizimin, me çfarëdo mjeti, të një pune, që përputhet me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktues, që ushtron një ndikim vendimtar në llojin ose projektimin e punës.

8. “Punë” është objekti, i cili është rezultati i ndërtimit ose i veprave civile inxhinierike, të marra si një tërësi, i cili është i mjaftueshëm në vetvete për të përbushur një funksion ekonomik ose teknik.

9. “Sigurimi i shërbimeve” është sigurimi apo realizimi i shërbimit publik, që korrespondon me objektin e koncesionit/partneritetit publik privat dhe me kërkesat e specifikuar nga autoriteti ose enti kontraktues.

10. “Objekti i koncesionit/partneritetit publik privat” janë veprat publike dhe/ose shërbimet publike të siguruar në bazë të një marrëveshjeje koncesioni/partneriteti publik privat në çdonjërin nga sektorët e përcaktuar në këtë ligj.

11. “Koncesionari” është operatori ekonomik ose subjekti për qëllime të veçanta, me të cilin autoriteti ose enti kontraktues ka nënshkruar një kontratë koncesioni.

12. “Subjekti për qëllime të veçanta (SPV)” është një person juridik privat, me seli në Republikën e Shqipërisë, i krijuar me kërkesë të autoritetit ose të entit kontraktues nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, me të cilin lidhet kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat.

13. “Projekte” janë një sërë aktivitetesh të ndërlydhura, që ndërmerren në një mënyrë të caktuar, me qëllimin e arritjes së objektivave të qartë brenda një periudhe kohore të specifikuar dhe brenda një kuadri të caktuar financiar.

14. “Objekti” është rezultati i ndërtimit ose i një infrastrukture ekzistuese publike në posedim, që përdoret ose zotërohet nga koncesionari/partneri privat, ose një infrastrukturë publike, që do të realizohet në zbatim të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat dhe që mund të sigurohet

për të mirën e publikut ose të ndonjë pjese të publikut.

15. “Mbështetja financiare” është lloji i mbështetjes monetare ose jomonetare dhe/ose financimi i dhënë nga sektori publik, duke përfshirë, por pa u kufizuar, subvencione, garanci financiare apo të tjera, kontribute kapitale dhe transferim të të drejtave të pronësisë.

16. “Vlera për para” është një term, i cili përdoret për të përcaktuar nëse autoriteti ose enti kontraktues ka marrë fitimet maksimale të mundshme nga punët apo shërbimet e dhëna me koncesion/partneritet publik privat. Ky term nuk kufizohet në masën e vlerës për para të punëve/shërbimeve, por përfshin, gjithashtu, edhe vlerësimin e cilësisë, të kostos dhe shfrytëzimin e burimeve, përshtatshmërinë me qëllimin dhe objektivin e kontratës, kohën e mundësinë për të vendosur nëse të gjitha këto elemente të kombinuara përbëjnë vlerën më të mirë ekonomike.

17. “Operator ekonomik” është çdo person, fizik ose juridik, ent publik ose grup personash dhe/ose entesh të tilla, që ofrojnë në treg, respektivisht, realizimin e punëve dhe/ose të punëve dhe shërbimeve.

18. “Kandidat” është një operator ekonomik, që ka paraqitur një kërkesë për shprehje interesi ose është ftuar për të marrë pjesë në një procedurë konkurruese të dhënies me koncesion/partneritet publik privat.

19. “Ofertues” është operatori ekonomik, i cili ka paraqitur një ofertë në një procedurë konkurruese të dhënies me koncesion/partneritet publik privat.

20. “Dokumentet e tenderit” janë dokumentet që autoriteti ose enti kontraktues ua vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për të përshkruar ose përcaktuar elemente të koncesionit/partneritetit publik privat ose të procedurës, duke përfshirë njoftimin e kontratës, specifikimet teknike, kushtet e propozuara të kontratës, formularët për paraqitjen e dokumenteve nga kandidatët dhe ofertuesit, informacionin për detyrimet e përgjithshme të zbatueshme dhe çdo dokument shtesë.

21. “Mjet elektronik” është pajisje elektronike për përpunimin (përfshirë kompresimin digjital) dhe ruajtjen e të dhënave, të cilat transmetohen, dërgohen dhe merren nëpërmjet telit, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike.



22. “E drejtë ekskluzive” është një e drejtë e dhënë nga një autoritet kompetent me anë të një ligji, rregulloreje ose akti administrativ publik, efekti i së cilës është të kufizojë ushtrimin e një aktiviteti në një operator të vetëm ekonomik e që ndikon në mënyrë thelbësore në aftësinë e operatorëve të tjerë ekonomikë për të kryer një aktivitet të tillë.

23. “E drejtë e veçantë” është një e drejtë e dhënë nga një autoritet kompetent me anë të një ligji, rregulloreje ose akti administrativ publik, efekti i së cilës është të kufizojë ushtrimin e një aktiviteti në dy ose më shumë operatorë ekonomikë dhe që ndikon në mënyrë thelbësore aftësinë e operatorëve të tjerë ekonomikë për të kryer një aktivitet të tillë.

24. “Kontratë koncesioni” është një kontratë e nënshkruar ndërmjet autoritetit/entit kontraktues në njërën anë dhe operatorit ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm apo subjektit, për qëllime të veçanta (SPV), i themeluar nga operatori ekonomik në fjalë, kontratë, e cila përmban përcaktimet që rregullojnë të drejtat e detyrimet lidhur me koncesionin e dhënë.

25. “Kontratë e partneritetit publik privat” është një kontratë pune publike apo kontratë shërbimi publik, e cila nuk është kontratë koncesioni, që plotëson kushtet, të cilat e përcaktojnë atë si një partneritet publik privat, sikurse është rregulluar në këtë ligj e që nënshkruhet ndërmjet autoritetit/entit kontraktues në njërën anë dhe operatorit ekonomik të përzgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm ose subjektit për qëllime të veçanta (SPV), i themeluar për këtë qëllim.

26. “Inovacion” është realizimi i një produkti, shërbimi ose procesi të ri ose të përmirësuar ndjeshëm, duke përfshirë, por pa u kufizuar, proceset e prodhimit, ndërtimit ose konstruksionit, në një metodë të re marketingu ose në një metodë të re organizative në praktikë të punës, në organizimin e vendit të punës ose në marrëdhëniet e jashtme.

27. “Veprimtari sektoriale” është veprimtari nga fusha e prokurimit në sektorët e ujit, të energjetikës, transportit dhe shërbimeve postare, të cilat janë të përcaktuara në këtë ligj.

28. “Kontratat sektoriale” janë kontrata publike, të lidhura nga entet kontraktore, që veprojnë në sektorët e shërbimit ujor, energjetik, të transportit dhe të atij postar, ndërmjet një ose më shumë operatorëve ekonomikë, që kanë si qëllim kryerjen e veprimtarive të përcaktuara në këtë ligj.

29. “Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare” është dokumenti i miratuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me formën, kriteret dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, ose në çdo akt tjetër të mëvonshëm, që ndryshon apo zëvendëson këtë vendim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.

30. “Detyrim kontingjent” është detyrimi që mund t’i lindë njësisë së qeverisjes së përgjithshme në raport me të tretë, në të ardhmen, si rezultat i risqeve të mundshme, të lidhura me ngjarje apo nisma, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, të viteve të mëparshme.

31. “Risqe fiskale” janë ngjarje të mundshme, që mund të kenë ndikim negativ mbi financat publike.

Neni 4

Fusha e zbatimit të koncesioneve/partneriteteve publike private

1. Koncesionet/partneritetet publike private mund të jepen për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve për sektorët dhe qëllimet e mëposhtme:

a) transport (sistemi i hekurudhave, transporti hekurudhor, portet, aeroportet, rrugët, tunelet, urat, parkimi, transporti publik);

b) prodhim dhe shpërndarje e energjisë elektrike dhe e energjisë për ngrohje;

c) prodhim dhe shpërndarje e ujit, trajtim, mbledhje, ujitje, drenazhim, pastrim i kanaleve dhe digave;

ç) menaxhim i mbeturinave, duke përfshirë mbledhjen, trajtimin, transferimin dhe depozitimin e tyre;

d) telekomunikacion;

dh) shkencë dhe arsim;

e) turizëm, argëtim dhe hoteleri;

ë) kulturë dhe sport;

f) shëndetësi;

g) shërbime sociale;

gj) burgje dhe infrastrukturë gjyqësore;

h) rehabilitim i tokës dhe i pyjeve;

i) parqe industriale, miniera dhe infrastrukturë të ngjashme për mbështetjen e biznesit;

j) strehim;



k) godina të administratës publike, teknologji e informacionit dhe infrastrukturë e bazës së të dhënave;

l) shpërndarje e gazit natyror;

ll) rehabilitim dhe zhvillim urban e suburban;

m) ndriçim publik në territorin e njësive administrative vendore;

n) bujqësi;

nj) kontrata të tjera në sektorët utilitarë.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrive të linjës, të ministrisë përgjegjëse për pushtetin vendor ose të ministrisë përgjegjëse për ekonominë, vendos për sektorë të tjerë në të cilët mund të zbatohen koncesionet/partneritetet publike private.

Neni 5

Përgjithshme

1. Ky ligj nuk zbatohet për koncesionet/partneritetet publike private në rastet e mëposhtme:

a) për kontratat, vlera e përlogaritur e të cilave është nën kufirin minimal monetar;

b) kur realizimi i tyre duhet të shoqërohet me masa të veçanta të sigurisë, në përputhje me ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative në fuqi apo kur një gjë e tillë kërkohet nga mbrojtja e interesave thelbësorë të shtetit;

c) për blerjen ose marrjen me qira, me çfarëdoj mjetesh financiare, të pasurisë së paluajtshme ose të të drejtave të lidhura me to. Megjithatë, kontratat e shërbimeve financiare, të nënshkruara në të njëjtën kohë para ose pas kontratës së blerjes ose të qirasë, në çfarëdoj forme, i nënshtrohen këtij ligji;

ç) për blerjen, zhvillimin, prodhimin ose bashkëprodhimin e materialit programor të destinuar për shërbime mediatike audiovizive ose shërbime mediatike radiofonike, që jepen nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive ose radiofonike, ose koncesionet për kohën e transmetimit ose ofrimin e programit, që i jepen ofruesit të shërbimeve mediatike audiovizive ose radiofonike;

d) për koncesione/partneritete publike private që u nënshtrohen rregullave të ndryshme dhe që janë dhënë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat Republika e Shqipërisë i ka lidhur me një ose disa shtete të tjera, të nënshkruara në pajtim me Traktatin për Funksimin e Bashkimit Evropian dhe që përfshijnë punë, mallra apo

shërbime të destinuara për zbatimin e përbashkët ose përdorimin e projekteve nga ana e vendeve nënshkruese;

dh) për koncesionet, të cilat u nënshtrohen rregullave të ndryshme dhe që jepen në përputhje me rregullat procedurale të veçanta të organizatave ndërkombëtare ose të institucioneve financiare ndërkombëtare, ku koncesionet në fjalë financohen plotësisht nga ato organizata ose institucione. Në rastin e koncesioneve të bashkëfinancuara, në pjesën më të madhe nga një organizatë ndërkombëtare ose institucion financiar ndërkombëtar, palët bien dakord për procedurat e zbatueshme të prokurimit;

e) për shërbimet e arbitrazhit e të pajtimit;

ë) për shërbimet financiare në lidhje me nxjerrjen, shitjen, blerjen apo transferimin e titujve ose të instrumenteve të tjera financiare, në mënyrë të veçantë, transaksionet nga autoritetet kontraktuese ose entet kontraktuese për të mbledhur para ose kapital;

f) për huat, pavarësisht nëse janë ose jo të lidhura me emetimin, shitjen, blerjen ose transferimin e titujve ose të instrumenteve të tjera financiare;

g) për shërbimet e mbrojtjes civile, të emergjencave civile dhe shërbimet e parandalimit të rrezeve, që ofrohen nga organizata ose shoqata jofitimprurëse, përveç shërbimeve të transportit me ambulancë;

gj) për shërbimet e fushatave politike, kur jepen nga partitë politike në kuadër të fushatave elektorale;

h) për shërbimet e lotarisë, të dhëna për një operator ekonomik në bazë të një të drejte ekskluzive;

i) për shërbimet e transportit ajror bazuar në dhënien një licence operimi, sipas legjislacionit të fushës në fuqi;

j) për koncesionin/partneritetin publik privat, në atë masë që ky ligj bie ndesh me një detyrim të shtetit, që është në bazë ose që rrjedh prej një marrëveshjeje me një ose më shumë shtete të tjera a me një organizëm ndërkombëtar, mbizotërojnë dispozitat e kësaj marrëveshjeje. Në të gjitha aspektet e tjera, procedurat dhe parimet e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat rregullohen me këtë ligj;

k) për koncesionet e shërbimit publik që një autoritet kontraktues ia ka dhënë një autoriteti tjetër kontraktues ose një shoqate të autoriteteve kontraktuese, në bazë të një të drejte ekskluzive që ata gëzojnë sipas legjislacionit në fuqi;



l) për koncesionet në fushën e ujit të dhëna:

i. për të siguruar ose për të operuar rrjete fikse të destinuara për të ofruar një shërbim për publikun në lidhje me prodhimin, transportin ose shpërndarjen e ujit të pijshëm;

ii. për furnizimin me ujë të pijshëm për rrjete të tilla;

ll) për koncesionet me njërin ose të dyja objektet e mëposhtme, kur ato lidhen me një veprimtari të parashikuar në shkronjën “k” të kësaj pike:

i. projekte inxhinierike hidraulike, ujitje ose kullim të tokës, me kusht që vëllimi i ujit, që do të përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm, të përfaqësojë më shumë se 20% të vëllimit të përgjithshëm të ujit të vënë në dispozicion nga këto projekte ose instalime vaditëse ose kulluese; ose

ii. largimin apo trajtimin e ujërave të zeza.

2. Rastet e përjashtuara, sipas pikës 1 të këtij neni, rregullohen me akte të tjera ligjore ose nënligjore.

Neni 6

Licencat dhe lejet

Ky ligj nuk zbatohet për licencat dhe lejet administrative, që u jepen operatorëve ekonomikë, autoriteteve kontraktuese, enteve kontraktuese dhe organeve të tjera të sektorit privat apo publik.

Neni 7

Kontratat e përziera

1. Koncesionet, që kanë si objekt të tyre si punë, ashtu edhe shërbime, jepen në përputhje me dispozitat e zbatueshme për llojin e koncesionit, që karakterizojnë objektin kryesor të kontratës në fjalë.

Në rastin e koncesioneve të përziera, që përbëhen pjesërisht nga shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike, sipas nenit 27 të këtij ligji, dhe pjesërisht nga shërbime të tjera, objekti kryesor përcaktohet sipas asaj se cila nga vlerat e parashikuara të shërbimeve përkatëse është më e larta.

2. Në rastin e kontratave që kanë si objekt punë ose shërbime të mbuluara nga ky ligj, si dhe furnizime, punë ose shërbime, që rregullohen nga regjime të tjera juridike, autoritetet/entet kontraktuese mund të zgjedhin të lidhin kontrata të veçanta për pjesët e veçanta ose të japin një kontratë të vetme kur për arsye objektive është e pamundur dhënia e kontratave të veçanta. Kur autoritetet/

entet kontraktuese zgjedhin të japin kontrata të veçanta për pjesë të veçanta, vendimi se cili regjim juridik zbatohet për secilën nga këto kontrata të veçanta merret në bazë të karakteristikave të pjesës së veçantë në fjalë.

Në çdo rast, zgjedhja midis dhënies së një kontrate të vetme apo të disa kontratave të ndara nuk duhet të bëhet me qëllimin për ta përjashtuar kontratën ose kontratat nga fusha e zbatimit të këtij ligji.

3. Kur autoritetet/entet kontraktuese zgjedhin të japin një kontratë të vetme, për dhënien e kontratës do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) në rastin e kontratave të përziera, që përmbajnë elemente të koncesioneve dhe të kontratave publike, sipas ligjit të prokurimit publik, kontrata e vetme jepet në përputhje me ligjin e prokurimit publik, nëse vlera e parashikuar e pjesës së kontratës, që mbulohet nga ligji i prokurimit publik, e llogaritur në përputhje me parashikimet e ligjit të prokurimit publik, është e barabartë ose më e madhe se kufiri i lartë monetar;

b) në rastin e kontratave për të cilat është objektivisht e pamundur të përcaktohet se për cilën veprimtari është menduar fillimisht kontrata, rregullat që zbatohen përcaktohen në përputhje me sa vijon:

i. kontrata jepet në përputhje me ligjin e prokurimit publik nëse një nga aktivitetet për të cilat synohet kontrata është objekt i këtij ligji dhe tjetri është objekt i prokurimit në sektorin klasik sipas ligjit të prokurimit publik;

ii. kontrata jepet në përputhje me këtë ligj nëse një nga aktivitetet për të cilat synohet kontrata i nënshtrohet këtij ligji dhe tjetri nuk i nënshtrohet as këtij ligji, as ligjit të prokurimit publik;

c) në rastin kur pjesë të ndryshme të një kontrate të caktuar mbulohen nga ligji për prokurimet në fushën e mbrojtjes e të sigurisë, kontrata mund të jepet pa zbatuar këtë ligj, me kusht që dhënia e një kontrate të vetme është e justifikuar për arsye objektive;

ç) në rastin kur një pjesë e një kontrate të caktuar mbulohet nga ligji për prokurimet në fushën e mbrojtjes e të sigurisë, kontrata mund të jepet në përputhje me këtë ligj ose në përputhje me ligjin për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, me kusht që dhënia e një kontrate të vetme justifikohet për arsye objektive;



d) në rastin e kontratave që synojnë të mbulojnë një veprimtari sektoriale, që i nënshtrohet këtij ligji, dhe një tjetri që mbulohet nga ligji për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, autoriteti/enti kontraktues mund të zgjedhë të japë një kontratë ose në përputhje me këtë ligj, ose në përputhje me ligjin për prokurimet në fushën e mbrojtjes e të sigurisë.

4. Kur është e pamundur që pjesë të ndryshme të një kontrate publike të përzier të ndahen, kontrata e vetme do të jepet në bazë të rregullave të zbatueshme për objektin kryesor të saj.

5. Për kontratat e përziera për të cilat është e pamundur të ndahen dhe është e pamundur të përcaktohet se cila veprimtari është objekti kryesor, rregullat e zbatueshme përcaktohen si më poshtë:

a) në rast se kontrata të tilla përfshijnë elemente të një koncesioni shërbimesh dhe të një kontrate mallrash, objekti kryesor përcaktohet sipas asaj se cila nga vlerat e parashikuara të shërbimeve ose të mallrave përkatëse është më e larta;

b) në rast se kontratat e përziera përfshijnë elemente të një koncesioni dhe të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve sipas ligjit të prokurimeve në fushën e mbrojtjes e të sigurisë, autoriteti/enti kontraktues mund të zgjedhë për të lidhur një kontratë në përputhje me këtë ligj ose në përputhje me ligjin për prokurimet në fushën e mbrojtjes e të sigurisë.

Neni 8

Partneriteti publik privat

1. Partneriteti publik privat nënkupton një formë bashkëpunimi afatgjatë, të rregulluar me kontratë, ndërmjet autoritetit/entit kontraktues, partnerit publik, dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, ose SPV, partnerit privat, ku:

a) partneri publik merr përsipër të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë financiare, pjesërisht ose plotësisht për realizimin e investimit në kontratat e punëve publike ose kontratat e shërbimeve të partneritetit publik privat;

b) partneri privat merr përsipër detyrimin për t'u ofruar shërbime publike përdoruesve të shërbimeve brenda fushës së kompetencave të partnerit publik dhe/ose detyrimin për t'i siguruar partnerit publik parakushtet e nevojshme për t'u ofruar shërbimet publike përdoruesve të shërbimeve dhe/ose veprimtaritë brenda fushës së kompetencave të tij;

c) partneri privat, me qëllim që të përmbushë detyrimet e shkronjës “a” të kësaj pike, mund të marrë përsipër:

i. detyrimin që të financojë, të projektojë, të ndërtojë dhe/ose të rindërtojë/të rinovojë objektin e infrastrukturës publike, të operojë dhe të mirëmbajë objektin e infrastrukturës publike të ndërtuar dhe/ose të rindërtuar/të rinovuar rishtazi;

ii. detyrimin që të përdorë, të operojë dhe të mirëmbajë një objekt ekzistues të infrastrukturës publike;

iii. çdo kombinim të detyrimeve të përmendura më lart për sa kohë që kombinimi i këtyre detyrimeve është për qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike;

ç) në kuadër të marrjes përsipër të detyrimeve të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, partneri privat zakonisht merr përsipër nivele dhe shtrirje të ndryshme të risqeve, që lidhen me financimin, ndërtimin, kërkesën dhe/ose disponueshmërinë, dhe të tjera, si: operimi, menaxhimi, mirëmbajtja dhe risqet teknike, varësisht nga forma e partneritetit publik privat dhe varësisht nga përcaktimi, rast pas rasti;

d) për kohëzgjatjen e partneritetit publik privat, çdo partner zakonisht merr përgjegjësinë për rastet e riskut, që janë nën sferën e ndikimit të tij ose kur përgjegjësia ndahet;

dh) partneri privat shpërblehet kryesisht, por jo ekskluzivisht, dhe në përputhje me kontratën:

i. me pagesat e rregullta të drejtpërdrejta të paguara nga ose në emër të partnerit publik, zakonisht në lidhje me disponueshmërinë e objektit dhe/ose shërbimit të ofruar;

ii. me forma të tjera të mbështetjes financiare, duke përfshirë transferimin e të drejtave materiale dhe të të drejtave të tjera reale;

iii. një kombinim i mjeteve të përshkruara më lart;

e) partneri publik i mundëson partnerit privat kryerjen e aktiviteteve tregtare, të përcaktuara në kontratë së bashku me detyrimet, që rrjedhin nga shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, nëse kjo siguron nivelin e nevojshëm të efikasitetit të kostos së pjesëmarrjes private dhe kthimit të arsyeshëm të investimit, si dhe një vlerë më të mirë të parasë.

2. Kontratat publike, që nuk i plotësojnë kushtet e këtij neni, nuk konsiderohen partneritet publik privat. Kushte të tilla nënkuptojnë, por nuk kufizohen vetëm në kohëzgjatjen e kontratës,

transferimin e risqeve kryesore të natyrshme dhe mjetet e shpërblimit.

Neni 9

Parimet themelore

1. Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private zbatohet në përputhje me parimet e transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efikasitetit, trajtimit të barabartë, reciprocitetit dhe të sigurisë ligjore.

2. Përgatitja e procedurës konkurruese të dhënies me koncesion/partneritet publik privat, duke përfshirë përlogaritjen e vlerës, nuk bëhet me qëllimin e përjashtimit nga objekti i këtij ligji ose për të favorizuar ose disavantazhuar në mënyrë të padrejtë një numër operatorësh ekonomikë ose punësh, mallrash ose shërbimesh të caktuara.

3. Ky ligj njeh parimin e administrimit të lirë nga autoritetet kombëtare, qendrore dhe vendore. Këto autoritete janë të lira të vendosin se si ta menaxhojnë më mirë ekzekutimin e punimeve ose ofrimin e shërbimeve për të siguruar në veçanti një nivel të lartë cilësie, sigurie dhe përbalueshmërie, trajtim të barabartë dhe promovimin e aksesit universal dhe të të drejtave të përdoruesve në shërbimet publike. Këto autoritete mund të zgjedhin të kryejnë detyrat e tyre me interes publik me burimet e tyre ose në bashkëpunim me autoritete të tjera ose t'ua delegojnë ato operatorëve ekonomikë.

4. Ky ligj nuk ndikon në sistemet e pronësisë së Republikës së Shqipërisë, ku, në veçanti, nuk kërkohet privatizimi i ndërmarrjeve publike, që ofrojnë shërbime për publikun.

Neni 10

Ministria përgjegjëse për ekonominë

Ministria përgjegjëse për ekonominë është institucioni përgjegjës, i cili orienton dhe harmonizon veprimtaritë për zhvillimin e koncesioneve/partneriteteve publike private.

Neni 11

Ministria përgjegjëse për financat

1. Autoriteti i ministrisë përgjegjëse për financat lidhur me koncesionet/partneritetet publike private ushtrohet sipas përcaktimeve në nenet e veçanta të këtij ligji.

2. Ministria përgjegjëse për financat vlerëson e miraton paraprakisht të gjitha studimet e fizibilitetit të projekteve të koncesionit/partneritetit publik privat, si dhe çdo ndryshim apo transferim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Nëse autoriteti ose enti kontraktues nuk e ka shpallur procedurën konkurruese të dhënies me koncesion/partneritet publik privat brenda 2 vjetëve nga marrja e miratimit nga ministria përgjegjëse për financat, do të dërgojë studimin e fizibilitetit të rishikuar edhe një herë për miratim.

3. Autoritetet kontraktuese ose entet kontraktuese janë të detyruara që përpara nënshkrimit të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat me operatorin ekonomik të shpallur si fitues, ta paraqesin atë për vlerësim, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, në ministrinë përgjegjëse për financat.

4. Autoritetet kontraktuese ose entet kontraktuese i paraqesin sa herë që kërkohet, por jo më pak se katër herë në vit, ministrit përgjegjës për financat raportet e përmblledhura të monitorimit të zbatimit të kontratave të koncesionit/partneritetit publik privat me argumentet dhe shpjegimet përkatëse. Forma, përmbajtja dhe afatet e raporteve të monitorimit përcaktohen me udhëzim të veçantë të ministrit përgjegjës për financat.

5. Bazuar në raportet e monitorimit, të specifikuar në pikën 4 të këtij neni, ministria përgjegjëse për financat mund t'u rekomandojë autoriteteve kontraktuese ose ente kontraktuese marrjen e masave për përmirësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve dhe të punëve publike, objekt i këtyre kontratave, si dhe për minimizimin apo eliminimin e risqeve të drejtpërdrejta e të tërthorta, që ndikojnë në buxhetin e shtetit.

6. Autoritetet kontraktuese ose entet kontraktuese, brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti, dërgojnë në ministrinë përgjegjëse për financat pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe të konfirmuara nga autoritetet tatimore të vitit paraardhës të shoqërive koncesionare.

7. Bazuar në të dhënat e mbledhura, në përputhje me pikat 4 e 6 të këtij neni, ministri përgjegjës për financat përgatit një raport vjetor të përmblledhur për ecurinë e kontratave aktive të koncesionit/partneritetit publik privat, si aneks i raportit vjetor të



zbatimit të buxhetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.

8. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për vlerësimin e miratimin e projekteve sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 12

Agjencia e Prokurimit Publik

Agjencia e Prokurimit Publik kryen detyrat e mëposhtme:

a) kryen publikimin e dokumenteve standarde të tenderit;

b) përjashton një operator ekonomik, sipas dispozitave të ligjit të prokurimit publik, nga përfitimi i kontratave publike.

Neni 13

Institucioni përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat

1. Institucioni përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat është institucion publik buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë.

2. Institucioni përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat financohet nga buxheti i shtetit, si dhe nga të ardhurat që sigurohen nga shërbimet që ofron.

3. Punonjësit e institucionit përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat, të cilët hartojnë studime fizibiliteti, përfitojnë shpërblym të veçantë.

4. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit, shpërblymimet e veçanta për punonjësit, si dhe procedurat e niveli i tarifave të shërbimeve, që do të ofrohen nga institucioni përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Institucioni përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat ka për qëllim rregullimin dhe mbikëqyrjen e praktikave të koncesioneve dhe partneriteteve publike private në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet evropiane.

6. Kompetencat e institucionit përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat janë si më poshtë:

a) përgatit studimin e fizibilitetit për projektet e institucioneve qendrore dhe enteve në varësi të tyre;

b) për institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe entet e përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 2 të nenit 15, studimet e fizibilitetit hartohen kundrejt pagesës së një tarife të posaçme dhe në varësi të disponueshmërisë;

c) propozon pranë ministrit përgjegjës për ekonominë ndryshimin e legjislacionit në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, si dhe udhëzimet për zbatimin e dispozitave të këtij ligji;

ç) harton dokumentet standarde të koncesionit/partneritetit publik privat dhe bashkëpunon me Agjencinë e Prokurimit Publik për publikimin e dokumenteve standarde të tenderit;

d) kryen procedurat e përzgjedhjes së konsulentëve të jashtëm në përputhje me procedurat e prokurimit publik;

dh) mbikëqyr veprimtarinë e njësisë së zbatimit të kontratës, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me detyrimet e nenit 60 të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 14

Marrëdhënia e institucionit përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat me autoritetet/entet kontraktuese

1. Institucioni përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat jep mbështetje teknike dhe asistencë për autoritetin/entet kontraktuese për identifikimin e projekteve të mundshme për koncesionin apo partneritetin publik privat.

2. Autoritetet/entet kontraktuese janë të detyruara të raportojnë periodikisht, të paktën 2 herë në vit, tek institucioni përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat për performancën financiare dhe jofinanciare të kontratave të koncesionit/partneritetit publik privat, si dhe një raport vjetor për ecurinë e zbatimit të kushteve dhe të afateve të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, duke identifikuar çdo problematikë të hasur gjatë periudhës së raportimit.

3. Institucioni përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat dhe autoritetet/entet kontraktuese bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar:

a) standardizimin me praktikën e Bashkimit Evropian;

b) shkëmbimin e eksperiencës dhe trajnimin e personelit;



c) përmirësimin e legjislacionit dhe të procedurave.

4. Autoritetet/entet kontraktuese janë të detyruara të respektojnë udhëzimet metodologjike dhe standardet e miratuara nga institucioni përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat, për sa nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

Neni 15

Autoritetet/entet kontraktuese

1. Autoritetet/entet kontraktuese janë institucionet dhe entet, të cilave ky ligj u jep kompetencat për të ndërmarrë një procedurë për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat.

2. Autoritetet kontraktuese janë:

a) institucionet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore;

b) çdo ent:

i. i themeluar për të ndjekur një interes të përgjithshëm dhe me karakter joekonomik apo tregtar;

ii. i cili ka personalitet juridik;

iii. i financuar kryesisht nga shteti, autoritetet rajonale apo vendore ose nga ente të tjera publike apo i administruar prej tyre ose me një bord administrativ, menaxherial apo mbikëqyrës, ku më shumë se gjysma e anëtarëve të tyre emërohen nga shteti, autoritetet rajonale ose vendore apo nga entet e tjera publike.

3. Entet kontraktuese janë institucionet dhe entet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, të cilat në fushën e tyre të përgjegjësisë kryejnë një nga aktivitetet në sektorët utilitarë të përcaktuar në këtë ligj dhe që do të ndërmarrin një procedurë për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat për ushtrimin e njërit prej këtyre aktiviteteve.

4. Entet kontraktuese janë, gjithashtu, entitete, të ndryshme nga ato të përmendura në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, por që veprojnë në bazë të të drejtave të veçanta ose ekskluzive, të dhëna për ushtrimin e njërit prej aktiviteteve në sektorët e shërbimeve të specifikuar në këtë ligj.

5. Kur objekti i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat është fushë e veprimtarisë së më shumë se një autoriteti kontraktues, Këshilli i Ministrave me vendim përcakton autoritetin kontraktues, sipas rastit.

Neni 16

Rregulla të zbatueshme për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe entet publike

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk mund të lidhin kontrata koncesioni/partneriteti publik privat nëse vlera totale e tyre kalon vlerën e 5 për qind të aktiveve, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qindësh të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor.

2. Entet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 15 të këtij ligji, nuk mund të lidhin kontratë koncesioni/partneriteti publik privat nëse vlera totale e tyre kalon vlerën e 5 për qind të aktiveve, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Neni 17

Regjistri i koncesionit/partneritetit publik privat

1. Regjistri i koncesionit/partneritetit publik privat është një bazë të dhënash elektronike e të gjitha kontratave të koncesionit dhe të partneritetit publik privat, të cilat janë dhënë në Republikën e Shqipërisë.

2. Regjistri i koncesionit/partneritetit publik privat krijohet dhe mbahet nga institucioni përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për përmbajtjen dhe formën e regjistrit të koncesioneve/partneritetit publik privat.

Neni 18

Konfidencialiteti

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, të cilit i nënshtrohet autoriteti kontraktues, veçanërisht legjislacioni në lidhje me aksesin në informacion, dhe pa cenuar detyrimet në lidhje me njoftimin e kontratave të koncesionit të shpallura fituese dhe me informacionin për kandidatët dhe ofertuesit e përcaktuar në nenet 31, 40 dhe 48 të këtij ligji, autoriteti ose enti kontraktues nuk e publikon



informacionin e përcjellë atij nga operatorët ekonomikë, të cilin ata e kanë caktuar si konfidencial, duke përfshirë, por pa u kufizuar në sekretet teknike ose tregtare dhe aspektet konfidenciale të ofertave. Ky nen nuk zbatohet në rastet e publikimit të pjesëve jokonfidenciale të kontratave të lidhura, duke përfshirë çdo ndryshim të mëvonshëm.

2. Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera, që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Autoriteti kontraktues ose enti kontraktues, në përputhje me legjislacionin në fuqi, mund t'u imponojë operatorëve ekonomikë kërkesa që synojnë mbrojtjen e natyrës konfidenciale të informacionit, që ai vë në dispozicion gjatë gjithë procedurës së dhënies së koncesionit.

Neni 19

Parandalimi i korrupsionit dhe i konfliktit të interesit

1. Autoriteti kontraktues ose enti kontraktues është i detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme gjatë zhvillimit të procedurës konkurruese të dhënies së koncesion/partneritet publik privat për parandalimin në kohë të korrupsionit dhe eliminimin e pasojave të dëmshme të korrupsionit, si dhe për identifikimin dhe parandalimin e çdo lloji konflikti interesi, me qëllim garantimin e konkurrencës, transparencës dhe të trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe ofertuesve.

2. Konflikti i interesit, për qëllime të këtij ligji, përfshin çdo situatë kur punonjësit e autoritetit kontraktues ose entit kontraktues, të cilët marrin pjesë në zhvillimin e procedurës së dhënies së koncesionit dhe që mund të ndikojnë në rezultatin e kësaj procedure, kanë drejtpërdrejt ose tërthorazi një interes financiar, ekonomik ose një interes tjetër personal, që mund të cenojë paanshmërinë dhe pavarësinë e tyre, në kuadër të procedurës së dhënies së koncesionit.

3. Masat e ndërmarra në lidhje me konfliktin e interesit duhet të jenë në përpjesëtim me nevojën për të parandaluar një konflikt të mundshëm interesi

ose për të shmangur një konflikt interesi të identifikuar.

KREU II VEPRIMET PËR DHËNIEN E KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

Neni 20

Veprimet për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat

1. Veprimet për dhënien e një koncesioni/partneriteti publik privat quhen të gjitha aktivitetet e ndërmarra që nga identifikimi i projekteve deri në fazën e lidhjes së kontratës, në zbatim të këtij ligji.

2. Autoriteti kontraktues ose enti kontraktues mund të angazhojë këshilltarë të jashtëm për të siguruar mbështetjen e ekspertëve në përgatitjen dhe dhënien e projekteve të koncesionit/partneritetit publik privat.

3. Në rastet kur studimi i fizibilitetit përgatitet nga vetë autoritetet kontraktuese ose entet kontraktuese dhe këta të fundit kanë nevojë për ekspertizë të specializuar për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe/ose oponencën e projekteve të koncesionit/partneritetit publik privat, i drejtohen me kërkesë të argumentuar institucionit përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat. Kërkesa duhet të përmbajë argument mbi përshtatshmërinë, nevojën dhe elemente të leverdisshmërisë së dhënies së këtij projekti me koncesion/partneritet publik privat, si dhe referencat për ekspertizën e duhur.

4. Këshilli i Ministrave miraton rregulla më të hollësishme në zbatim të këtij neni.

Neni 21

Identifikimi i projekteve të mundshme të koncesionit/partneritetit publik privat

1. Autoriteti ose enti kontraktues identifikon dhe shqyrton projektet e mundshme të koncesionit/partneritetit publik privat brenda sferës së kompetencave të tij.

2. Autoriteti ose enti kontraktues informohet dhe mund të marrë në shqyrtim projektet e mundshme të koncesionit/partneritetit publik privat të identifikuar apo të propozuara nga:



- a) Kryeministria;
- b) autoritetet e tjera kontraktuese të së njëjtës hierarki administrative, organet e qeverisjes qendrore apo vendore;
- c) institucionet dhe organizatat vendase e ndërkombëtare financiare dhe të zhvillimit;
- ç) institucionet dhe organizatat shkencore vendase e ndërkombëtare.

Neni 22

Komisioni i koncesionit/partneritetit publik privat

1. Për shqyrtimin dhe dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat, autoriteti ose enti kontraktues krijon komisionin e koncesionit/partneritetit publik privat.

2. Anëtarët e komisionit duhet të jenë me profesion juristë, ekonomistë dhe me profesione nga fusha të tjera përkatëse, në varësi të objektit dhe karakteristikave të koncesionit/partneritetit publik privat.

3. Numri i anëtarëve në komisionin e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është tek, por jo më pak se 5 anëtarë. Për projekte koncesioni/partneriteti publik privat, objekti i të cilave është i ngjashëm në natyrë, mund të krijohet një komision i vetëm.

4. Komisioni i koncesionit/partneritetit publik privat kryen detyrat e mëposhtme:

- a) harton raportin përmbledhës mbi bazën e të cilit autoriteti/enti kontraktues merr vendimin për shtyrjen, refuzimin e plotë ose vazhdimin e procedurave;
- b) përcakton procedurën e zbatueshme për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat dhe harton dokumentacionin e tenderit;
- c) shqyrton dhe vlerëson ofertat e pranuar dhe/ose kërkesat për pjesëmarrje, që janë dorëzuar;
- ç) formulon propozimin e përzgjedhjes së ofertës së suksesshme ose propozimin e vendimit për ndërprerjen e procedurës së dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat, si dhe një shpjegim të tyre;
- d) kryen të gjitha aktivitetet e tjera, që kërkohen për zhvillimin e procedurës së koncesionit/partneritetit publik privat, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Komisioni i dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat dokumenton në mënyrë të përshtatshme të gjitha proceset e punës së tij.

Neni 23

Studimi i fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat

1. Studimi i fizibilitetit për koncesionin/partneritetin publik privat përmban, në mënyrë të veçantë:

- a) përmbledhjen operacionale dhe përshkrimin e përgjithshëm të projektit;
- b) analizat teknike, financiare, ligjore dhe ekonomike, që përfshijnë patjetër detajimin e investimeve të planifikuara, kostot e mirëmbajtjes, amortizimin dhe ndikimet e inflacionit të pritshëm;
- c) studimet mjedisore dhe implikimet në natyrë;
- ç) anekset shoqëruese, shtesat e kërkuara, konkluzionet dhe rekomandimet, përcaktimin e llojit dhe objektin e koncesionit/partneritetit publik privat;
- d) vlerësimin e risqeve të drejtpërdrejta financiare dhe ndikimin në buxhetin e qeverisë qendrore e vendore;
- dh) vlerën e parashikuar të kontratës;
- e) vlerësimet në lidhje me kriteret e zgjedhjes dhe të dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat;
- ë) kohëzgjatjen e propozuar të kontratës, si edhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për përgatitjen e dokumentacionit të tenderit.

2. Në studimin e fizibilitetit merren parasysh, në veçanti, interesi publik, ndikimi në mjedis dhe mbrojtja e mjedisit, qëndrueshmëria, përshtatshmëria financiare e projektit, treguesit e vlerës për para, harmonizimi i projektit me objektivat kombëtarë dhe sektorialë strategjikë, risqet direkte e indirekte financiare dhe ndikimet në buxhetin qendror dhe në atë të qeverisjes vendore, mbështetja e nevojshme financiare, realizueshmëria teknike e tregtare, si dhe interesi i tregut dhe aftësia për të tërhequr operatorët e interesuar ekonomikë dhe mbështetësit financiarë.

3. Përpara shpalljes së procedurës së dhënies me koncesion/partneritet publik privat, autoritetet kontraktuese dhe entet kontraktuese dërgojnë në ministrinë përgjegjëse për financat, për miratim paraprak, studimin e fizibilitetit, si dhe çdo ndryshim të mëtejshëm të tij së bashku me projektkontratën e ndarë në pjesën e panegociueshme dhe të



negociueshme. Ministria përgjegjëse për financat e vlerëson dhe e miraton studimin së bashku me projektkontratën, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji.

4. Përfshirja në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, që shoqërohen me investime, të cilat mund të kërkojnë angazhimin e fondeve të buxhetit të shtetit, direkt apo indirekt, aktualisht ose në të ardhmen, dhe kur vlera e plotë e investimit është mbi vlerat kufi të miratuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat, miratohen sipas rregullave që caktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për menaxhimin e investimeve publike. Në këtë rast, pas maturimit të projektit në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, vijohen procedurat për dhënien me koncesion, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

5. Pas maturimit të projektit në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, nëse studimi i fizibilitetit përcakton se koncesioni/partneriteti publik privat është forma më e mirë e financimit, ndiqen procedurat e mëtejshme sipas këtij ligji.

6. Të gjitha projektet e koncesionit/partneritetit publik privat, të cilat janë nën kufijtë financiarë të vendosur me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat, ndjekin procedurat sipas këtij ligji.

Neni 24

Kufiri monetar

1. Për qëllime të këtij ligji zbatohet një kufi monetar.

2. Kufiri minimal monetar miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 25

Llogaritja e vlerës së koncesionit/partneritetit publik privat

1. Autoriteti/enti kontraktues llogarit vlerën e parashikuar të koncesionit si xhiro totale e koncesionarit të krijuar gjatë kohëzgjatjes së kontratës, pa TVSH, e vlerësuar nga autoriteti kontraktues ose enti kontraktues për punët dhe shërbimet, që janë objekt i koncesionit/partneritetit publik privat, si dhe për mallrat që lidhen me këto punë dhe shërbime.

2. Për qëllim të pikës 1 të këtij neni, nëse vlera e koncesionit në kohën e dhënies është më shumë se 20% më e lartë se vlera e tij e parashikuar, vlerësimi

i vlefshëm është vlera e koncesionit/partneritetit publik privat në kohën e dhënies së tij.

3. Ky vlerësim është i vlefshëm në momentin kur dërgohet njoftimi i koncesionit ose në momentin kur autoriteti kontraktues ose enti kontraktues fillon procedurën e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat.

4. Vlera e parashikuar e koncesionit llogaritet në bazë të të dhënave, që përmban studimi i fizibilitetit përkatës të koncesionit/partneritetit publik privat.

5. Vlera e parashikuar e koncesionit llogaritet duke përdorur një metodë objektive të përcaktuar në dokumentet e koncesionit. Gjatë llogaritjes së vlerës së parashikuar të koncesionit, autoritetet kontraktuese dhe entet kontraktuese, sipas rastit, marrin parasysh në veçanti:

a) vlerën e çdo forme opsioni dhe çdo zgjatje të kohëzgjatjes së koncesionit;

b) të ardhurat nga pagesa e tarifave dhe gjobave nga përdoruesit e punimeve ose shërbimeve të ndryshme nga ato të mbledhura për llogari të autoritetit kontraktues ose entit kontraktues;

c) pagesat ose çdo avantazh financiar në çfarëdolloj forme, të bëra nga autoriteti kontraktues ose enti kontraktues ose çdo autoritet tjetër publik për koncesionarin, duke përfshirë kompensimin për përmbushjen e një detyrimi për shërbimin publik dhe subvencionet e investimeve publike;

ç) vlerën e granteve ose të çdo përfitimi tjetër financiar, në çfarëdolloj forme, nga palët e treta për realizimin e koncesionit;

d) të ardhurat nga shitja e çdo prone që është pjesë e koncesionit;

dh) vlerën e të gjitha mallrave dhe shërbimeve, që vihen në dispozicion të koncesionarit nga autoritetet kontraktuese ose entet kontraktuese, me kusht që ato të jenë të nevojshme për kryerjen e punimeve ose ofrimin e shërbimeve;

e) çdo çmim ose pagesë për kandidatët ose ofertuesit.

6. Zgjedhja e metodës së përdorur për llogaritjen e vlerës së parashikuar të një koncesioni nuk bëhet me qëllim të përjashtimit të tij nga fusha e zbatimit të këtij ligji. Koncesioni nuk nënndahet, me qëllim që të mos hyjë në objektin e këtij ligji, përveç rasteve kur justifikohet nga arsye objektive.

7. Vlera e parashikuar e kontratës së partneritetit publik privat në formën e kontratës së punës ose shërbimit publik, sipas nenit 8 të këtij ligji, llogaritet



sipas përcaktimeve në legjislacionin e prokurimit publik.

8. Kur një punë ose shërbim i propozuar mund të rezultojë në dhënien e koncesioneve në formën e loteve të veçanta, do të merret parasysh vlera totale e vlerësuar e të gjitha këtyre loteve.

9. Kur vlera e agreguar e loteve është e barabartë ose e kalon kufirin minimal monetar të përcaktuar sipas pikës 2, të nenit 24 të këtij ligji, atëherë do të zbatohen rregullat e përcaktuara në këtë ligj për dhënien e secilit lot.

Neni 26

Dokumentet e tenderit

1. Dokumentet e tenderit hartohen dhe trajtohen nga komisioni i koncesionit/partneritetit publik privat në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij ligji.

2. Rregullat më të hollësishme për çështjet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Pa cenuar pikën 1 të këtij neni, në dokumentet e tenderit për procedurën për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat mund të përfshihet informacion shtesë sipas përcaktimeve në akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

Neni 27

Shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike

1. Koncesionet për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike u nënshtrohen vetëm detyrimeve të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni.

2. Llojet e shërbimeve, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Autoriteti/enti kontraktues bën të ditur synimin për dhënien e planifikuar të koncesionit të shërbimeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni nëpërmjet publikimit të një njoftimi paraprak të informacionit. Ky njoftim duhet të përmbajë minimalisht informacionin e mëposhtëm:

a) emrin, numrin e identifikimit, adresën, duke përfshirë numrin e telefonit, *email*-in dhe adresën e internetit të autoritetit ose të entit kontraktues;

b) kur është e përshtatshme, *email*-in ose adresën e internetit në të cilën do të jenë të disponueshme specifikimet dhe çdo dokument mbështetës;

c) llojin e autoritetit ose të entit kontraktues dhe veprimtarinë kryesore të ushtruar;

ç) kodet CPV. Kur kontrata është e ndarë në lote, ky informacion duhet të jepet për çdo lot;

d) përshkrimin e shërbimeve, renditja treguese e madhësisë ose e vlerës;

dh) kushtet për pjesëmarrje;

e) kur është e mundshme, afatin ose afatet kohore për kontaktimin me autoritetin ose entin kontraktues në funksion të pjesëmarrjes;

ë) kur është e mundshme, përshkrim të shkurtër të veçorive kryesore të procedurës së dhënies së kontratës, që do të zbatohet;

f) çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

4. Autoritetet ose entet kontraktuese publikojnë njoftimin e fituesit bazuar mbi rezultatet e procedurës së dhënies së koncesionit. Ky njoftim duhet të përmbajë informacionin minimal të mëposhtëm:

a) emrin, numrin e identifikimit, adresën, duke përfshirë numrin e telefonit, *email*-in dhe adresën e internetit të autoritetit ose të entit kontraktues;

b) llojin e autoritetit ose të entit kontraktues dhe veprimtarinë kryesore të ushtruar;

c) kodet CPV. Kur kontrata është e ndarë në lote, ky informacion duhet të jepet për çdo lot;

ç) një përshkrim të objektit të koncesionit;

d) numrin e ofertave të marra;

dh) vlerën e ofertës së suksesshme, duke përfshirë tarifat e çmimit;

e) emrin dhe adresën e telefonit, adresën e *email*-it dhe adresën e internetit të operatorit apo të operatorëve të suksesshëm ekonomikë;

ë) çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

5. Njoftimi i kontratës dhe njoftimi i fituesit për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera specifike, të përcaktuara në këtë nen, publikohen sipas një formulari standard, pjesë e dokumenteve të koncesionit.

Neni 28

Koncesionet e rezervuara

Autoritetet/entet kontraktuese mund të rezervojnë të drejtën për të marrë pjesë në procedurat e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat për punëtori sociale dhe të mbrojtura, si dhe operatorët ekonomikë, qëllimi kryesor i të cilëve është integrimi social e profesional i personave me aftësi të kufizuara ose të



pafavorizuar ose mund të parashikojë që këto koncesione të realizohen në kuadër të programeve të punësimit të mbrojtur, me kusht që të paktën 30% e punonjësve të këtyre punëtorëve, operatorëve ekonomikë ose programeve të jenë punonjës me aftësi të kufizuara ose persona në nevojë, sipas legjislacionit në fuqi.

Në rastin e koncesioneve të rezervuara aplikohet pika 3 e nenit 27 të këtij ligji.

Neni 29

Shërbimet e kërkimit dhe të zhvillimit

1. Ky ligj zbatohet vetëm për koncesionet, shërbimet kërkimore dhe të zhvillimit dhe shërbimet e konsulencës të lidhura me to, për të cilat plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

a) përfitimet i përkasin ekskluzivisht autoritetit kontraktues ose entit kontraktues, që t'i përdorë për kryerjen e punëve të veta;

b) shërbimi i ofruar shpërblehet tërësisht nga autoriteti kontraktues ose enti kontraktues.

2. Lista e shërbimeve, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohet konkretisht me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 30

Operatorët ekonomikë

1. Operator ekonomik është çdo person, fizik ose juridik, ent publik ose grup personash dhe/ose entesh të tilla, që ofrojnë në treg, respektivisht, realizimin e punëve dhe/ose të punëve dhe shërbimeve.

2. Personave juridikë mund t'u kërkohet të tregojnë në ofertë ose në kërkesën për pjesëmarrje emrat dhe kualifikimet përkatëse profesionale të personelit, që do të jetë përgjegjës për zbatimin e kontratës në fjalë.

3. Grupet e operatorëve ekonomikë, duke përfshirë bashkimet e përkohshme, mund të marrin pjesë në procedurat e dhënies së koncesionit. Autoritetet kontraktuese ose entet kontraktuese nuk u kërkojnë atyre një formë të caktuar ligjore për të paraqitur një ofertë ose kërkesë për pjesëmarrje.

4. Pavarësisht përcaktimeve të pikave 1 e 3 të këtij neni, autoritetet ose entet kontraktuese mund t'u kërkojnë grupeve/bashkimeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike pasi t'u jepet kontrata, siç parashikohet në nenin 63

të këtij ligji, në masën që ky ndryshim është i nevojshëm për realizimin e kënaqshëm të kontratës.

5. Rregulla më të hollësishme në zbatim të këtij neni do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III

RREGULLA TË APLIKUESHME PËR DHËNIEN E KONCESIONEVE

Neni 31

Rregulla dhe parime të përgjithshme

1. Procedura konkurruese për dhënie e koncesioneve fillon me miratimin e urdhrit përkatës nga autoriteti ose enti kontraktues, pasi të jetë miratuar studimi i fizibilitetit nga ministria përgjegjëse për financat ose të jetë maturuar në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare dhe përfundon me publikimin e njoftimit të fituesit për dhënie e kontratës ose me publikimin e njoftimit të anulimit të procedurës.

2. Autoriteti ose enti kontraktues organizon procedurën për përzgjedhjen e fituesit të koncesionit, në përputhje me këtë ligj.

3. Organizimi i procedurës së dhënies së koncesionit duhet të respektojë parimet e përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji. Në veçanti, gjatë procedurës së dhënies së koncesionit, autoriteti ose enti kontraktues nuk duhet të japë informacion në mënyrë diskriminuese, që mund t'u japë disa kandidatëve ose ofertuesve një avantazh ndaj të tjerëve.

4. Autoriteti ose enti kontraktues merr masat e duhura për të siguruar që gjatë zbatimit të kontratave të koncesioneve, operatorët ekonomikë të kontraktuar të respektojnë detyrimet që zbatohen në fushat e së drejtës mjedisore, sociale dhe të punës, të përcaktuara nga e drejta e Bashkimit Evropian, e drejta kombëtare dhe e drejta ndërkombëtare e detyrueshme për t'u zbatuar nga Republika e Shqipërisë.

5. Rregullat më të hollësishme për zhvillimin e procedurave konkurruese për dhënie me koncesion përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 32

Mjetet e komunikimit

1. Gjatë procedurës së dhënies së kontratës me koncesion, autoriteti ose enti kontraktues mund të shkëmbejë informacion me operatorin ekonomik, duke përdorur një ose disa nga mjetet e mëposhtme të komunikimit:

- a) mjete elektronike;
- b) postë;
- c) komunikimin verbal, të cilin autoriteti kontraktues është i detyruar ta regjistrojë me shkrim;
- ç) dërgim dorazi i vërtetuar me dokument.

2. Mjetet e zgjedhura të komunikimit duhet të jenë përgjithësisht të disponueshme dhe jodiskriminuese dhe nuk duhet të kufizojnë aksesin e operatorëve ekonomikë në procesin e dhënies së koncesioneve. Mjetet dhe pajisjet e përdorura për komunikim me mjete elektronike, si dhe karakteristikat e tyre teknike, duhet të jenë të ndërveprueshme me produktet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në përdorim të përgjithshëm.

Rregullat dhe procedurat për këtë formë komunikimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Në çdo komunikim, shkëmbim dhe ruajtje informacioni, autoriteti ose enti kontraktues siguron ruajtjen e integritetit të të dhënave dhe konfidencialitetin e kërkesave për pjesëmarrje dhe ofertave.

Neni 33

Nomenklaturat

Çdo referencë për nomenklaturat në kontekstin e dhënies së kontratave të koncesioneve/partneriteteve publike private do të bëhet duke përdorur Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV), i miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 34

Njoftimi i kontratës së koncesionit

1. Autoriteti ose enti kontraktues bën të njohur qëllimin e tij për të dhënë një koncesion me anë të një njoftimi.

2. Njoftimi i kontratës duhet të përfshijë, minimalisht, informacionin e mëposhtëm:

a) emrin, numrin unik të identifikimit, adresën, duke përfshirë numrin e telefonit, *email*-in dhe adresën e internetit të autoritetit kontraktues ose të entit kontraktues;

b) llojin e autoritetit ose të entit kontraktues dhe veprimtarinë kryesore të ushtruar;

c) vendndodhjen e aktivitetit të koncesionit që do të ndërmerret;

ç) kohëzgjatjen e kontratës së koncesionit;

d) përshkrimin e koncesionit, si: natyra dhe shtrirja e punimeve, natyra dhe shtrirja e shërbimeve, shkalla e ndikimit ose vlera treguese dhe, kur është e mundur, kohëzgjatja e kontratës. Kur koncesioni ndahet në lote, ky informacion duhet të jepet për secilin lot. Kur është e përshtatshme, përshkrimi i çdo optionsi;

dh) vlerën e parashikuar të kontratës së koncesionit sipas studimit të fizibilitetit të hartuar;

e) kur është e përshtatshme, *email*-in ose adresën e internetit në të cilën do të jenë të disponueshme pa pagesë dokumentet e tenderit;

ë) kodet CPV. Kur kontrata është e ndarë në lote, ky informacion duhet të jepet për çdo lot;

f) kushtet për pjesëmarrje, duke përfshirë:

i. kur është e përshtatshme, tregues nëse koncesioni është i kufizuar në punëtori të mbrojtura ose nëse ekzekutimi i tij është i kufizuar në kuadrin e programeve të mbrojtura të punës;

ii. kur është e përshtatshme, tregues nëse ofrimi i shërbimit është i rezervuar me ligj, rregullore ose dispozitë administrative për një profesion të caktuar; referencë në ligjin, rregulloren ose dispozitën administrative përkatëse;

iii. një listë dhe përshkrim të shkurtër të kriterëve të përzgjedhjes, kur është e aplikueshme, nivelet minimale të standardeve, që mund të kërkojnë, tregimi i informacionit të kërkuar (vetëdeklarimet, dokumentacioni);

g) afatin e fundit për dorëzimin e ofertave;

gj) adresën në të cilën do të dorëzohen ofertat;

h) gjuhën/gjuhët në të cilën/të cilat duhet të hartohet/n ofertat;

i) kohën dhe vendin e hapjes publike të ofertave;

j) kriteret që do të zbatohen në dhënien e koncesionit kur nuk figurojnë në dokumentet e tjera të koncesionit;

k) datën e shpërndarjes së njoftimit të koncesionit;

l) emrin dhe adresën e organit përgjegjës për shqyrtimin e ankesave. Informacion i saktë në lidhje



me afatin për paraqitjen e ankesave ose, nëse është e nevojshme, emrin, adresën, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike të shërbimit nga i cili mund të merret ky informacion;

ll) kur është e përshtatshme, kushtet e veçanta, objekt i performancës së koncesionit;

m) kur është e përshtatshme, tregues të kërkesave dhe kushteve në lidhje me përdorimin e mjeteve të komunikimit elektronik;

n) kriteret e përjashtimit të ofertuesve;

nj) llojin dhe vlerën e garancisë së ofertës që do të dorëzohet nga ofertuesit.

3. Njoftimi i kontratës publikohet sipas një formulari standard, pjesë e dokumenteve të koncesionit.

Neni 35

Ftesa për ofertë

1. Në procedurat me faza, autoriteti ose enti kontraktues fton nëpërmjet komunikimit me mjete elektronike ose me shkrim, njëkohësisht, të gjithë kandidatët e përzgjedhur për të vazhduar në fazën e dytë, për të dorëzuar ofertat ose për të negociuar. Ftesa përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që t'u mundësojë kandidatëve të përzgjedhur dorëzimin e ofertave të tyre.

2. Përmbajtja e ftesës për ofertë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

Kërkesat teknike dhe funksionale

1. Kërkesat teknike dhe funksionale përcaktojnë karakteristikat e kërkuara të punëve ose shërbimeve, që janë objekt i koncesionit dhe përcaktohen në dokumentet e tenderit.

2. Këto karakteristika mund t'i referohen edhe procesit specifik të krijimit ose ofrimit të punëve ose shërbimeve të kërkuara, me kusht që ato të jenë të lidhura me objektin e kontratës dhe në përpjesëtim me vlerën dhe objektivat e saj. Karakteristikat mund të përfshijnë, për shembull, nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, projektin për të gjitha kërkesat (përfshirë aksesin për personat me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, sigurinë ose dimensionet, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit dhe testimin, shënimin dhe etiketimin, ose udhëzimet e përdoruesit.

3. Me përjashtim të rasteve kur justifikohet nga objekti i kontratës, kërkesat teknike dhe funksionale nuk i referohen një marke ose burimi të veçantë ose një procesi të veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik, ose markave tregtare, patentave, llojeve ose një prodhim specifik, që ka si efekt favorizimin ose eliminimin e sipërmarrjeve të caktuara ose produkteve të caktuara. Një referencë e tillë lejohet, në raste të jashtëzakonshme, kur nuk është i mundur një përshkrim mjaft i saktë dhe i kuptueshëm i objektit të kontratës. Në çdo rast, një referencë e tillë shoqërohet me fjalët “ose ekuivalent”.

4. Autoriteti ose enti kontraktues nuk refuzon një ofertë me arsyetimin se punët dhe shërbimet e ofruara nuk janë në përputhje me kërkesat teknike dhe funksionale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në rastet kur ofertuesi arrin të provojë me çdo mjet të përshtatshëm, që zgjidhjet që ka propozuar ai në ofertën e tij, plotësojnë në mënyrë ekuivalente kërkesat teknike dhe funksionale.

Neni 37

Garancitë procedurale

1. Kontratat e koncesionit jepen në bazë të kriterëve të vlerësimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktues ose enti kontraktues, në përputhje me nenin 41 të këtij ligji, me kusht që të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta është në përputhje me kërkesat teknike minimale të përcaktuara, sipas rastit, nga autoriteti kontraktues ose enti kontraktues;

b) ofertuesi plotëson kushtet për pjesëmarrje të përmendura në pikën 1 të nenit 38 të këtij ligji;

c) ofertuesi nuk ndodhet në kushtet e përjashtimit nga pjesëmarrja në procedurën e dhënies së koncesionit, sipas pikave 4, 5, 6, 8, 9 dhe 10, të nenit 38 të këtij ligji.

2. Kërkesat minimale teknike të përmendura në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni përmbajnë kushtet dhe karakteristikat (veçanërisht teknike, fizike, funksionale dhe ligjore), që çdo ofertë duhet të plotësojë ose të zotërojë.

3. Autoriteti kontraktues ose enti kontraktues duhet të sigurojë:

a) një përshkrim të objektit të koncesionit dhe të kushteve të pjesëmarrjes në njoftimin e kontratës së koncesionit;



b) një përshkrim të kriterëve të vlerësimit dhe, sipas rastit, të kërkesave minimale që duhen plotësuar në njoftimin e kontratës së koncesionit, në ftesën për ofertë ose në dokumentet e tenderit.

4. Autoriteti ose enti kontraktues mund të kufizojë numrin e kandidatëve ose të ofertuesve në një nivel të përshtatshëm, me kusht që kjo të bëhet në mënyrë transparente dhe në bazë të kriterëve objektive. Numri i kandidatëve ose i ofertuesve të ftuar duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar konkurrencë të vërtetë.

5. Autoriteti ose enti kontraktues siguron që në dokumentet e tenderit pasqyrohet informacioni i nevojshëm për operatorët ekonomikë të interesuar lidhur me zhvillimin e procedurës konkurruese, si dhe një afat orientues i përfundimit të saj. Çdo modifikim i dokumenteve të tenderit u komunikohet të gjithë operatorëve ekonomikë në masën që ka të bëjë me elementet e shpallura në njoftimin e kontratës së koncesionit dhe në dokumentet e tenderit. Modifikimi i dokumenteve të tenderit kryhet nëpërmjet hartimit të një shtojce, e cila komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të kontratës.

6. Autoriteti ose enti kontraktues siguron dokumentimin e duhur të fazave të procedurës, duke përdorur mjetet që ai i gjykon të përshtatshme.

7. Autoriteti ose enti kontraktues mund të zhvillojë negociata me kandidatët dhe ofertuesit. Objekti i koncesionit, kriteret e vlerësimit dhe kërkesat minimale teknike nuk ndryshohen gjatë zhvillimit të negociatave.

Neni 38

Përzgjedhja dhe vlerësimi i kandidatëve

1. Autoritetet dhe entet kontraktuese verifikojnë kushtet e pjesëmarrjes në lidhje me aftësinë teknike dhe profesionale, si dhe gjendjen ekonomike e financiare të kandidatëve ose ofertuesve. Verifikimi kryhet mbi bazën e vetëdeklarimeve dhe/ose të dokumenteve, që paraqiten si provë, në përputhje me kriteret e kualifikimit, të përcaktuara në njoftimin e kontratës së koncesionit dhe në dokumentet e tenderit. Kushtet për pjesëmarrje duhet të jenë jodiskriminuese, si dhe në përpjesëtim e të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim sigurimin e konkurrencës.

2. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kushteve për pjesëmarrje, të përcaktuara në pikën 1

të këtij neni, mund të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të caktuar, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet t'i provojë autoritetit ose entit kontraktues se do të ketë në dispozicion, gjatë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës, burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. Për sa i përket gjendjes financiare, autoriteti ose enti kontraktues mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe këto subjekte të jenë bashkërisht përgjegjës për zbatimin e kontratës.

3. Në të njëjtat kushte, grupi i operatorëve ekonomikë, të përmendur në nenin 30 të këtij ligji, mund të mbështetet në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup ose të subjekteve të tjera.

4. Çdo operator ekonomik, që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, shkualifikohet nga procedurat për dhënien e koncesioneve për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky shkualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) korrupsion, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

c) mashtrim, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

5. Detyrimi për të shkualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me vendim të formës së prerë është anëtar i organit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij operatori ekonomik ose ka kompetenca përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

6. Një operator ekonomik shkualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë konkurruese të



dhënies me koncesion kur ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose të kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve, kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese, me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese, me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore, duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara përfundimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

7. Autoritetet dhe entet kontraktuese mund të vendosin të mos e shkualifikojnë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikave 4, 5 e 6 të këtij neni, për arsye thelbësore që lidhen me interesin publik, si shëndeti publik ose mbrojtja e mjedisit.

8. Autoritetet dhe entet kontraktuese mund të shkualifikojnë nga pjesëmarrja në një procedurë të dhënies me koncesion çdo operator ekonomik nëse plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) kur mund të demonstrojë me çdo mjet të përshtatshëm çdo shkelje të detyrimeve të zbatueshme të përmendura në pikën 4, të nenit 31 të këtij ligji;

b) kur operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit ose mbylljes, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur është në marrëveshje me kreditorët, kur aktivitetet e tij të biznesit janë pezulluar ose është në çdo situatë analoge, që rrjedh nga një procedurë e ngjashme, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Autoriteti ose enti kontraktues mund të vendosë të mos shkualifikojë një operator ekonomik, i cili është në një nga situatat e mësipërme, kur krijon bindjen se operatori ekonomik në fjalë do të jetë në gjendje të realizojë kontratën, duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi dhe masat për vazhdimin e aktivitetit në rastin e këtyre situatave;

c) kur autoriteti kontraktues mund të demonstrojë me çdo mjet të përshtatshëm se operatori ekonomik është shpallur fajtor për një shkelje të rëndë profesionale, çka e vë në dyshim integritetin e tij;

ç) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, që nuk mund të korrigjohet në mënyrë të efektshme me ndonjë masë tjetër;

d) autoriteti ose enti kontraktues provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë, që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

dh) kur operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të konsiderueshme ose të vazhdueshme në përmbushjen e një kushti thelbësor në një kontratë të mëparshme publike me një autoritet ose ent kontraktues, siç përcaktohet në këtë ligj ose në ligjin e prokurimit publik, që ka çuar në përfundimin e parakohshëm të asaj kontrate të mëparshme, dëmshpërblime ose penalitete të tjera të ngjashme;

e) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për shkualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

ë) kur operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të padrejtë në procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose të entit kontraktues për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazhe të padrejta në procedurën e dhënies së koncesionit ose të japë nga pakujdesia informacione të gabuara, që mund të kenë një ndikim domethënës në vendimet në lidhje me përjashtimin, përzgjedhjen ose dhënien e kontratës së koncesionit;

f) operatori ekonomik nuk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

9. Autoritetet dhe entet kontraktuese shkualifikojnë një operator ekonomik në çdo kohë



gjatë zhvillimit të procedurës kur rezulton se operatori ekonomik në fjalë, për shkak të veprimeve të kryera ose të mosveprimeve përpara ose gjatë zhvillimit të procedurës, ndodhet në një nga situatat e parashikuara në pikat 4 dhe 6 të këtij neni.

10. Autoritetet dhe entet kontraktuese shkualifikojnë një operator ekonomik në çdo kohë gjatë zhvillimit të procedurës kur rezulton se operatori ekonomik në fjalë, për shkak të veprimeve të kryera ose të mosveprimeve përpara ose gjatë zhvillimit të procedurës, ndodhet në një nga situatat e parashikuara në pikën 8 të këtij neni.

11. Operatori ekonomik, që ndodhet në një nga kushtet e shkualifikimit të parashikuara në pikat 4 dhe 8 të këtij neni, mund të paraqesë prova për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për shkualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguarë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative edhe për personelin, të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

12. Operatori ekonomik i përjashtuar me vendim përfundimtar nga e drejta për të fituar kontratat e prokurimit publik, koncesionit dhe ankandit publik nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar në pikën 11 të këtij neni gjatë periudhës së përcaktuar të përjashtimit.

Neni 39

Afatet kohore për paraqitjen e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje

1. Gjatë përcaktimit të afateve kohore për pranimin e ofertave ose të kërkesave për pjesëmarrje, autoritetet ose entet kontraktuese marrin parasysh në veçanti kompleksitetin e kontratës dhe kohën e nevojshme për hartimin e

tyre, pa cenuar afatet minimale kohore të përcaktuara në këtë nen.

2. Kur kërkesat për pjesëmarrje ose ofertat mund të bëhen vetëm pas një vizite në kantier ose pas shqyrtimit në vend të dokumenteve që mbështesin dokumentet e tenderit, afatet kohore vendosen në mënyrë të tillë që të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar të mund të kenë marrë dijeni për të gjithë informacionin e nevojshëm për të përgatitur kërkesat për pjesëmarrje ose ofertat dhe, në çdo rast, afatet janë më të gjata se afatet minimale kohore të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni.

3. Afati minimal kohor për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, pavarësisht nëse përfshin ose jo dorëzimin e ofertës, është 30 (tridhjetë) ditë nga e nesërmja e datës në të cilën është publikuar njoftimi i kontratës së koncesionit ose ftesa për shprehje interesi.

4. Kur procedura zhvillohet në faza të njëpasnjëshme, afati minimal kohor për pranimin e ofertave fillestare është 22 (njëzet e dy) ditë nga e nesërmja e datës në të cilën është dërguar ftesa për ofertë.

5. Afati kohor për pranimin e ofertave mund të reduktohet me 5 ditë kur autoriteti ose enti kontraktues pranon që ofertat mund të dorëzohen me mjete elektronike.

Neni 40

Dhënia e informacionit për kandidatët dhe ofertuesit

1. Autoriteti ose enti kontraktues informon, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj, çdo kandidat e ofertues për vendimet e marra në lidhje me dhënien e një kontrate koncesioni, duke përfshirë emrin e ofertuesit të suksesshëm, arsyet për çdo vendim të refuzimit të kërkesës ose ofertës së tij dhe arsyet për çdo vendim për të mos dhënë një kontratë për të cilën ka pasur shpallje të njoftimit të kontratës së koncesionit.

2. Autoriteti ose enti kontraktues informon, me kërkesë të palës së interesuar, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e një kërkesë me shkrim, çdo ofertues që ka paraqitur një ofertë të vlefshme në raport me karakteristikat dhe avantazhet e lidhura me ofertën fituese.



Pa cenuar detyrimet që rrjedhin nga ky nen, autoritetet kontraktuese ose entet kontraktuese mund të mos bëjnë publike disa nga informacionet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, nëse një gjë e tillë do të pengonte zbatimin e ligjit, përndryshe do të ishte në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave ose cenon interesin publik apo interesat ligjore dhe ekonomike të palëve, ose pengon konkurrencën e drejtë. Nëse disa pjesë të ofertës së operatorëve ekonomikë deklarohen si konfidenciale, atëherë këto dokumente nuk do të vihen në dispozicion të kërkuarëve.

Neni 41

Kriteret e vlerësimit për dhënien e kontratës së koncesionit

1. Kriter vlerësimi për dhënien e kontratës së koncesionit është oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret të ndryshme, të lidhura me objektin e koncesionit në fjalë, që përfshijnë cilësinë, meritat teknike, karakteristikat estetike, funksionale dhe të mjedisit, kostot e drejtimit, kostot e efektivitetit, ofrimin e shërbimeve pas dorëzimit të produkteve dhe asistencën teknike, datën e dorëzimit dhe periudhën e dërgesës ose periudhën e përfundimit të punimeve, çmimin e shërbimit për përfituesit fundorë, shumën e tarifës së koncesionit.

2. Komisioni i dhënies së koncesionit specifikon në dokumentet e tenderit dhe/ose në njoftimin e kontratës koeficientët relativë, që ai i jep secilit prej kriterëve të zgjedhura për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme. Këta koeficientë mund të shprehen duke parashikuar një gamë me një shtrirje të përshtatshme maksimale. Kur kjo nuk është e mundur, për shkak të arsyeve të justifikuara, autoriteti kontraktues tregon në njoftimin e kontratës kriteret sipas rendit zbritës të rëndësisë.

3. Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë në kundërshtim me parimet e parashikuara në nenin 9 të këtij ligji, si dhe duhet të lidhen me objektin/lëndën e koncesioneve.

4. Në rast se autoriteti kontraktues ose enti kontraktues merr një ofertë që propozon një zgjidhje inovative të karakterizuar nga një nivel i jashtëzakonshëm i efikasitetit funksional, të cilën nuk mund ta parashikonte, përjashtimisht autoriteti kontraktues ose enti kontraktues mund të modifikojë renditjen e kriterëve për zgjedhjen e ofertës më të favorshme, duke mbajtur në

konsideratë parimin e mosdiskriminimit, në mënyrë që të merret parasysh zgjidhja inovative e propozuar.

5. Në rastin e modifikimeve të përmendura në pikën 4 të këtij neni, autoriteti kontraktues ose enti kontraktues do të informojë të gjithë ofertuesit për modifikimin në fjalë, sipas rendit të rëndësisë së kriterëve për zgjedhjen e ofertës më të favorshme dhe do të anulojë me vendim procedurën e dhënies së koncesionit dhe do të publikojë një njoftim të ri për koncesionin, në përputhje me afatet minimale kohore të përmendura në nenin 39 të këtij ligji.

Neni 42

Dorëzimi i ofertave/kërkesave për pjesëmarrje

1. Ofertat/kërkesat për pjesëmarrje duhet të dorëzohen në adresën e përcaktuar në dokumentet e tenderit brenda afatit kohor të përcaktuar në këto dokumente si afati i fundit për dorëzimin e tyre.

2. Në rastin e procedurave që zhvillohen në formë shkresore, çdo ofertë/kërkesë për pjesëmarrje e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në njoftimin e autoritetit kontraktues ose entit kontraktues nuk shqyrtohet nga komisioni i dhënies së koncesionit dhe i kthehet e pahapur ofertuesit.

Operatorët ekonomikë mund të jenë të pranishëm, nëse e kërkojnë, në procesin e hapjes së ofertave/kërkesave për pjesëmarrje.

3. Në ofertën/kërkesën për pjesëmarrje të përgatitur, ofertuesit dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Kur procedura zhvillohet në formë shkresore, ky dokumentacion duhet të paraqitet në një zarf të mbyllur me vulën e shoqërisë.

4. Në rastin e zhvillimit të procedurës konkurruese me mjete elektronike, dorëzimi i ofertave/kërkesave për pjesëmarrje nga ofertuesit/kandidatët kryhet në mënyrën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 43

Hapja e ofertave/kërkesave për pjesëmarrje

1. Autoriteti kontraktues ose enti kontraktues i hap të gjitha ofertat/kërkesat për pjesëmarrje në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e tenderit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose pas mbarimit të afatit përfundimtar të përcaktuar pas



zgjatjes së këtij afati, në përputhje me procedurat e specifikuar në dokumentet e tenderit.

2. Në rast se për arsye objektive, të shkaktuara nga një situatë e paparashikuar nga autoriteti kontraktues ose enti kontraktues në kohën e fillimit të procedurës, është e pamundur të respektohet afati i hapjes së ofertave/kërkesave për pjesëmarrje nga ana e autoritetit kontraktues ose entit kontraktues, duhet të dokumentohet arsyeja dhe të përcaktohet një datë e re për hapjen e tyre.

3. Ofertuesit/kandidatët ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, që kanë paraqitur oferta/kërkesa për pjesëmarrje, ftohen të marrin pjesë në hapjen e tyre, në rast se janë të interesuar. Mosparaqitja e tyre nuk e pengon hapjen e ofertave/kërkesave për pjesëmarrje.

4. Në momentin e hapjes së ofertave/kërkesave për pjesëmarrje, anëtarët e komisionit të dhënies së koncesionit nënshkruajnë një deklaratë nëpërmjet së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit/kandidatët pjesëmarrës.

Nëse evidentohet se një ose disa prej operatorëve ekonomikë ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose disa prej anëtarëve të komisionit të dhënies së koncesionit, atëherë duhet të zëvendësohet anëtari/anëtarët në fjalë dhe më pas të vazhdojë procedura e dhënies së kontratës.

5. Në rastin e zhvillimit të procedurës konkurruese me mjete elektronike, hapja e ofertave/kërkesave për pjesëmarrje bëhet si më poshtë:

a) autoriteti kontraktues ose enti kontraktues i hap të gjitha ofertat/kërkesat për pjesëmarrje në datën, vendin e në kohën e përcaktuar në dokumentet e tenderit, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave/kërkesave për pjesëmarrje ose pas mbarimit të afatit përfundimtar të përcaktuar pas zgjatjes së këtij afati, në përputhje me procedurat e specifikuar në dokumentet e tenderit;

b) dokumentacioni i paraqitur nga ofertuesit/kandidatët regjistrohet automatikisht në sistem dhe procesi i hapjes nuk ka nevojë të dokumentohet në rrugë shkresore.

6. Në rastet kur procedura zhvillohet në formë shkresore, autoriteti kontraktues ose enti kontraktues dokumenton procesin nëpërmjet mbajtjes së një procesverbal, i cili duhet të pasqyrojë emrin, adresën e ofertuesit/kandidatit, dokumenta-

cionin ligjor dhe çdo dokument të kërkuar nga autoriteti kontraktues ose enti kontraktues, si dhe çmimin e çdo oferte, të cilat lexohen me zë të lartë për ata persona që janë të pranishëm dhe regjistrohet në këtë procesverbal. Procesverbali, që pasqyron të gjitha dokumentet që shoqërojnë ofertën/kërkesën për pjesëmarrje, duhet t'i vihet në dispozicion, në bazë të kërkesës, çdo ofertuesi/kandidati, ndërsa ofertuesve/kandidatëve që nuk janë të pranishëm ose të përfaqësuar në hapjen e ofertave/kërkesave për pjesëmarrje duhet t'u dërgohet njoftim për zhvillimin e procedurës.

7. Dokumentet që shoqërojnë ofertën nuk u kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës.

Neni 44

Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave/kërkesave për pjesëmarrje

1. Kohëzgjatja e procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit nuk duhet të kalojë 30 (tridhjetë) ditë nga e nesërmeja e datës së hapjes të ofertave/kërkesave për pjesëmarrje.

Në rastin kur, për shkak të kompleksitetit të objektit të koncesionit, kohëzgjatja e procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit është më e madhe se 30 (tridhjetë) ditë, autoriteti ose enti kontraktues duhet ta argumentojë me procesverbal këtë fakt.

2. Autoriteti ose enti kontraktues, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve/kandidatëve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të tyre. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës/kërkesës për pjesëmarrje, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë/kërkesë për pjesëmarrje të pavlefshme në të vlefshme.

3. Autoriteti ose enti kontraktues, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 2 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktues njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të shkualifikohet.

4. Autoriteti ose enti kontraktues vlerëson një ofertë/kërkesë për pjesëmarrje si të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe



specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës së koncesionit dhe në dokumentet e tenderit.

5. Oferta/kërkesa për pjesëmarrje konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet, që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e dorëzimit të ofertës/kërkesës për pjesëmarrje.

Neni 45

Njoftimi paraprak i fituesit

1. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktues ose enti kontraktues bën klasifikimin dhe harton njoftimin paraprak të fituesit.

2. Menjëherë, por jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktues ose enti kontraktues publikon njoftimin paraprak të fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit, operatorëve ekonomikë u lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 66 të këtij ligji.

3. Në rastin e procedurave konkurruese, që zhvillohen në formë shkresore, autoriteti kontraktues ose enti kontraktues publikon njoftimin paraprak të fituesit. Me publikimin e njoftimit paraprak të fituesit, operatorëve ekonomikë u lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 66 të këtij ligji.

Neni 46

Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktues ose enti kontraktues anulon procedurën konkurruese të dhënies me koncesion në rastet kur:

a) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objekteve, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktues ose entit kontraktues kanë ndryshuar;

b) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

c) nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;

ç) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.

2. Kur procedura konkurruese anulohet në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 1 të këtij neni, autoriteti kontraktues ose enti kontraktues nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt dhe me të njëjtat të dhëna.

3. Autoriteti kontraktues ose enti kontraktues nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve/kandidatëve, që kanë paraqitur oferta/kërkesa për pjesëmarrje për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.

4. Autoriteti kontraktues ose enti kontraktues u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën konkurruese të dhënies me koncesion menjëherë, por jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga e nesërmja e datës së marrjes të vendimit. Me publikimin e këtij njoftimi, operatorëve ekonomikë u lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 66, të këtij ligji.

5. Autoriteti kontraktues ose enti kontraktues vijon me publikimin e vendimit përfundimtar për anulimin e procedurës së prokurimit, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga e nesërmja e datës së skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin, duke e publikuar njoftimin në të njëjtën mënyrë siç publikon njoftimin e kontratës.

Neni 47

Raporti përmbledhës për zhvillimin e procedurës konkurruese

1. Komisioni i dhënies së koncesionit pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave/kërkesave për pjesëmarrje dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit/entit kontraktues.

2. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë:

a) emrin dhe adresën e autoritetit ose të entit kontraktues, objektin dhe vlerën e përlogaritur të koncesionit;

b) përshkrimin e punëve/shërbimeve;

c) respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave/kërkesave për pjesëmarrje;

ç) çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës;

d) korrigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla);



dh) rezultatet e përzgjedhjes së ofertuesve dhe/ose të uljes së numrit të tyre, sipas parashikimeve në këtë ligj, përkatësisht:

i. të dhënat e ofertuesit fitues;

ii. emrat e ofertuesve të refuzuar dhe arsyet për refuzimin e tyre;

iii. të dhënat e ofertuesve të shkualifikuar, ofertën ekonomike dhe arsyet e shkualifikimit;

e) arsyet për refuzimin e ofertave anomalisht të ulëta;

ë) emrin e ofertuesit të suksesshëm dhe arsyet pse është zgjedhur oferta e tij dhe, kur dihet, përqindjen e kontratës që ofertuesi i suksesshëm planifikon të nënkontrakttojë te palë të treta, emrat e nënkontraktorëve të kontraktorit kryesor, nëse ka;

f) sipas rastit, konfliktet e interesit që janë zbuluar dhe masat që janë marrë në vijim;

g) sipas rastit, ofertat, të cilat janë vlerësuar me pikë të barabarta dhe hapat që janë ndjekur për procesin e hedhjes së shortit;

gj) informacion, nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër ose korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave/kërkesave për pjesëmarrje.

Neni 48

Njoftimi i fituesit

1. Menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas miratimit të raportit përmbledhës, nga titullari i autoritetit ose i entit kontraktues hartohet njoftimi i fituesit.

2. Njoftimi i fituesit duhet të përmbajë, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

a) emrin, numrin unik të identifikimit, adresën, duke përfshirë numrin e telefonit, *email*-in dhe adresën e internetit të autoritetit kontraktues ose të entit kontraktues;

b) llojin e autoritetit kontraktues ose të entit kontraktues;

c) kodet CPV;

ç) përshkrimin e koncesionit, natyrën dhe shtrirjen e punimeve, natyrën dhe shtrirjen e shërbimeve, kohëzgjatjen e kontratës. Kur koncesioni ndahet në lote, ky informacion jepet për çdo lot. Kur është e përshtatshme, përshkrimi i çdo opsioni;

d) përshkrimin e procedurës për përcaktimin e fituesit dhe, në rastin e dhënies së kontratës pa shpallje paraprake, justifikimin përkatës;

dh) kriteret e përcaktuara në nenin 41 të këtij ligji, të cilat janë përdorur për dhënien e kontratës së koncesionit;

e) datën e vendimit për dhënien e kontratës së koncesionit;

ë) numrin e ofertave të paraqitura, shoqëruar me vlerat përkatëse të ofertuara, duke përfshirë:

i. numrin e ofertave të marra nga operatorët ekonomikë, të cilët janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme;

ii. numrin e ofertave të marra nga operatorë ekonomikë të huaj;

iii. numrin e ofertave të marra në mënyrë elektronike;

f) emrin, adresën, numrin unik të identifikimit, duke përfshirë numrin e telefonit, *email*-in dhe adresën e internetit të ofertuesit të suksesshëm, duke përfshirë informacionin:

i. nëse ofertuesi i suksesshëm është ndërmarrje e vogël apo e mesme;

ii. nëse ofertuesi i suksesshëm është bashkim i përkohshëm operatorësh ekonomikë;

g) vlerën dhe kushtet kryesore financiare të koncesionit të dhënë, duke përfshirë:

i. çmimet e tarifave dhe gjokat, nëse ka;

ii. çmimet dhe pagesat, nëse ka;

gj) informacionin nëse koncesioni ka lidhje me një projekt dhe/ose program të financuar nga fondet e Bashkimit Evropian;

h) emrin dhe adresën e organit përgjegjës për shqyrtimin e ankesave dhe, kur është e përshtatshme, procedurat e ndërmjetësimit. Informacion të saktë në lidhje me afatin e fundit për procedurat e shqyrtimit ose, nëse është e nevojshme, emrin, adresën, numrin e telefonit dhe *email*-it të shërbimit nga i cili mund të merret ky informacion;

i) datën e shpërndarjes së këtij njoftimi;

j) metodën e përdorur për përlogaritjen e vlerës së koncesionit, nëse nuk është specifikuar në dokumentet e tenderit, sipas parashikimeve të nenit 25 të këtij ligji;

k) çdo informacion tjetër të nevojshëm.

3. Njoftimi i fituesit publikohet sipas një formulari standard, pjesë e dokumenteve të koncesionit.



KREU IV
PROCEDURAT STANDARDE DHE
RREGULLA TË APLIKUESHME PËR
DHËNIEN E PARTNERITETIT PUBLIK
PRIVAT

Neni 49

**Procedurat standarde të dhënies së
partneritetit publik privat**

Autoriteti ose enti kontraktues për dhënien e kontratave të partneritetit publik privat zbaton procedurat e mëposhtme:

- a) procedurën e hapur;
- b) procedurën e kufizuar;
- c) procedurën konkurruese me negociim, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave të sektorit klasik;
- ç) procedurën me negociim me shpallje paraprake të njoftimit, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave sektoriale.

Neni 50

**Rregulla të zbatueshme për procedurat e
partneritetit publik privat**

Për dhënien e kontratës së partneritetit publik privat, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 49 të këtij ligji, do të zbatohen rregullat e parashikuara në ligjin e prokurimit publik, për aq sa nuk bie në kundërshtim me këtë ligj.

KREU V
KONTRATA E KONCESIONIT/
PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

Neni 51

Lidhja e kontratës

1. Autoriteti ose enti kontraktues nuk mund të lidhë kontratën para përfundimit të periudhës së pritjes së ankesave, të përcaktuar në nenin 67 të këtij ligji.

2. Autoriteti ose enti kontraktues fton ofertuesin më të suksesshëm për lidhjen e kontratës, pas botimit të njoftimit të fituesit.

3. Pas negociimit të kontratës me operatorin e shpallur fitues dhe përpara nënshkrimit të saj, autoriteti ose enti kontraktues e dërgon projektkontratën për vlerësim përfundimtar, në

përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji, në ministrinë përgjegjëse për financat.

4. Kontrata hartohet me shkrim dhe nënshkruhet nga personi i autorizuar i autoritetit ose entit kontraktues dhe ofertuesi i zgjedhur si më i suksesshmi.

5. Kur ofertuesi i përzgjedhur si më i suksesshmi, në përputhje me dokumentet e tenderit, me vendimin për dhënien e kontratës fituese dhe me ofertën e zgjedhur, është i detyruar të krijojë një subjekt për qëllime të veçanta (SPV), të rregulluar sipas legjislacionit në fuqi, si një shoqëri me seli në Republikën e Shqipërisë me shënimin para emrit “Shoqëri koncesionare” dhe me objekt “Objektin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat”, dhe autoriteti ose enti kontraktues nënshkruan kontratën me personin e autorizuar të shoqërisë në fjalë.

6. Autoriteti ose enti kontraktues, me përfundimin e regjistrimit, sipas legjislacionit në fuqi, të shoqërisë koncesionare/partnerit privat, dërgon një kopje të kontratës e të ekstraktit të regjistrimit në ministrinë përgjegjëse për financat.

7. Nëse ofertuesi i zgjedhur si më i suksesshmi tërhiqet nga lidhja e kontratës ose nuk dorëzon në kohën e përcaktuar garancitë dhe instrumentet e përshkruara në nenin 53 të këtij ligji, atëherë autoriteti ose enti kontraktues mund të marrë një vendim të ri për dhënien e kontratës dhe t'i ofrojë nënshkrimin e kontratës ofertuesit të radhës, që është renditur si më i miri.

8. Për ministritë dhe institucionet publike në varësi ose nën përgjegjësinë e tyre, që financohen nga buxheti i shtetit, që lidhin kontrata partneriteti publik privat, që kanë mbështetje financiare dhe mbarin risqe fiskale, pas marrjes së dakordësisë nga ministri përgjegjës për financat, Këshilli i Ministrave miraton dhënien e mbështetjes financiare ose të risqeve fiskale. Llojet dhe natyra e mbështetjes financiare dhe/ose risqet fiskale të mundshme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 52

Përmbytja e kontratës

1. Kontrata përcakton të drejtat dhe detyrimet e autoritetit ose të entit kontraktues dhe koncesionarit/partnerit privat në përputhje me



dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

2. Çështjet e kontratës, që nuk rregullohen me këtë ligj, janë subjekt i dispozitave të Kodit Civil.

3. Kontrata duhet të hartohet në përputhje me dokumentet e tenderit, me studimin e fizibilitetit, me informacionet që gjenden në njoftimin e kontratës, me ofertën e zgjedhur dhe me njoftimin e fituesit.

4. Pa rënë ndesh me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor, përveç kontratës, autoriteti kontraktues ose enti kontraktues ka të drejtën, në përputhje me këtë ligj, me dokumentet e tenderit, me vendimin e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat dhe me ofertën e zgjedhur, të lidhë marrëveshje dhe/ose kontrata shtesë dhe/ose të kushtëzuara, rast, në të cilin autoriteti ose enti kontraktues kërkon miratimin paraprak nga ministria përgjegjëse për financat.

5. Marrëveshja dhe/ose kontratat shtesë dhe/ose të kushtëzuara, të përshkruara në pikën 4 të këtij neni, quhen në veçanti ato, të cilat janë të lidhura për të siguruar financimin e nevojshëm për zbatimin e kontratës.

6. Kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat rregullon, në përputhje me dokumentacionin e tenderit, me vendimin e dhënies së koncesionit dhe me ofertën e shpallur fituese, të gjitha çështjet që janë të lidhura me pronësinë e pasurive të paluajtshme dhe pasurive të tjera, që janë objekt i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat dhe pronësinë e pasurive të paluajtshme ose jo, që lindin në bazë të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat për kohëzgjatjen e saj apo pas përfundimit të saj.

Neni 53

Garancitë e realizimit të kontratës

1. Para nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktues ose enti kontraktues merr nga ofertuesi më i suksesshëm garancitë e kërkuara për realizimin e kontratës dhe instrumentet e sigurisë si kompensim për dëmin që mund të shkaktohet si pasojë e dështimit të koncesionarëve/partnerëve privatë për të përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë (premtim për pagesë, garanci bankare, garanci të korporatës, kambiale etj.).

2. Sigurimi i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat të shërbimeve publike do të jetë deri në 5% të vlerës së kontratës. Kjo masë

mund të reduktohet në mënyrë përpjesëtimore gjatë ekzekutimit të kontratës, por në asnjë rast gjatë kohëzgjatjes së saj nuk mund të jetë më e vogël se 25% e vlerës fillestare të sigurimit.

3. Sigurimi i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat të punëve publike do të jetë deri në 5% të vlerës së ndërtimit, ndërsa pas periudhës së ndërtimit do të jetë deri në 5% të vlerës së mbetur të kontratës.

4. Garancitë dhe instrumentet e sigurisë depozitohen pranë autoritetit ose entit kontraktues, i cili është i detyruar t'i ruajë ato gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

5. Autoriteti ose enti kontraktues verifikon rregullisht vlefshmërinë e instrumenteve të sigurisë.

6. Në bazë të pikës 3 të këtij neni dhe në rast se instrumenti i mbyllur i sigurisë nuk është i vlefshëm, autoriteti ose enti kontraktues i kërkon pa vonesë koncesionarit/partnerit privat të paraqesë një instrument të ri të sigurisë.

Neni 54

Tarifa e koncesionit

1. Nëse është përcaktuar në studimin e fizibilitetit, autoriteti/enti kontraktor do të përcaktojë në dokumentet e tenderit që koncesionari/partneri privat duhet të paguajë një kompensim monetar për koncesionin/partneritetin publik privat.

Shuma dhe mënyra e kompensimit monetar duhet të specifikohet konkretisht në dokumentet e tenderit dhe në kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat.

Tarifa e koncesionit nuk do të aplikohet për koncesionet/partneritetet publike private, që aplikohen në fushën e shëndetësisë dhe në fushën e sportit.

2. Tarifa koncesionare paguhet në përputhje me rregullat e caktuara nga ministri përgjegjës për financat, për arkëtimin e të ardhurave për llogari të buxhetit të shtetit.

3. Shuma dhe afatet e pagesës së tarifës së koncesionit/partneritetit publik privat përcaktohen në përpjesëtim me objektin e koncesionit/partneritetit publik privat, me vlerën e parashikuar të kontratës, me kohëzgjatjen e kontratës, me risqet dhe me kostot që koncesionari/partneri privat merr përsipër dhe me fitimin e pritshëm, si dhe me nivelin



e pajisjeve dhe me vlerën e pronës së dhënë sipas kontratës nga autoriteti ose enti kontraktues.

4. Kontrata e koncesionit mund të përcaktojë ndryshueshmërinë e shumës dhe/ose mënyrën e llogaritjes dhe të pagesës së tarifës së koncesionit brenda një periudhe kohore të caktuar, gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit, në përputhje me dokumentacionin e tenderit dhe me vendimin për dhënien e kontratës.

5. Tarifat e koncesionit janë pjesë e të ardhurave të buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose të buxheteve të organeve të qeverisjes vendore.

6. Kur tarifa koncesionare nuk paguhet në përputhje me përcaktimet e këtij neni, autoriteti ose enti kontraktues njofton ministrin përgjegjës për financat, urdhri i të cilit, për arkëtimin e tarifës, përbën titull ekzekutiv për bankat e nivelit të dytë, ku ndodhet llogaria bankare e shoqërisë koncesionare, që vihet në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor.

Neni 55

Afati i kontratës së koncesionit/ partneritetit publik privat

1. Kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat lidhet për një periudhë të caktuar. Autoriteti ose enti kontraktues duhet të vlerësojë kohëzgjatjen e kontratës në bazë të punëve ose shërbimeve të kërkuara.

2. Për koncesionet/partneritetet publike private që zgjasin më shumë se 5 (pesë) vjet, kohëzgjatja maksimale e kontratës nuk duhet të kalojë kohën e arsyeshme që një koncesionar/partner privat mund të pritët të marrë për të rikuperuar investimet e bëra në funksionimin e punëve ose shërbimeve, së bashku me një kthim mbi kapitalin e investuar, duke marrë parasysh investimet e nevojshme për të arritur objektivat specifike kontraktuale. Investimet e marra në konsideratë për qëllimet e llogaritjes përfshijnë si investimet fillestare, ashtu edhe investimet gjatë jetës së koncesionit/partneritetit publik privat.

3. Autoriteti/enti kontraktues përcakton në studimin e fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat afatin e kontratës, në mënyrë të tillë që kohëzgjatja e saj nuk e kufizon konkurrencën.

4. Afati kohor, për të cilin është dhënë koncesioni/partneriteti publik privat, fillon nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

5. Afati kohor i kontratës mund të zgjatet, nëse është e nevojshme, për shkak të ndryshimeve të kontratës, siç parashikohet në nenet 56 dhe 57 të këtij ligji.

Neni 56

Ndryshimi i kontratës së koncesionit/ partneritetit publik privat

1. Kontratat e parashikuara me këtë ligj mund të ndryshohen jo më herët se 2 (dy) vjet nga fillimi i zbatimit të kontratës, duke i shtuar kontratës një aneks, me kusht që kjo mundësi të parashikohet në njoftimin e kontratës dhe në kontratë. Ndryshimet në kontratë bëhen nga autoriteti ose enti kontraktues dhe koncesionari/partneri privat.

2. Ndryshimet në kontratë mund të bëhen me iniciativën e të dyja palëve kontraktuese, veçanërisht në rastet e mëposhtme:

a) kur rrezikohet siguria kombëtare dhe mbrojtja e vendit, rrezikohet mjedisi, natyra dhe shëndeti i njerëzve;

b) kur humbet objekti i kontratës ose kur ekziston një pamundësi objektive për përdorimin e tij, në rastin e forcës madhore;

c) gjatë ndryshimit të kuadrit ligjor;

ç) në raste të tjera që çojnë në ndryshimin e situatës reale ose ligjore për përdorimin e objektit apo ofrimin e shërbimeve ose në realizimin e kontratës.

3. Kontrata e koncesionit mund të ndryshohet pa procedurë të re të përcaktuar me këtë ligj, në rastet e mëposhtme:

a) kur ndryshimet, pavarësisht nga vlera e tyre monetare, parashikohen në dokumentet fillestare të projektit në dispozita të sakta dhe të qarta rishikimi, të cilat mund të përfshijnë dispozita ose opsione të rishikimit të vlerës. Dispozita të tilla tregojnë qëllimin dhe natyrën e ndryshimeve ose mundësive potenciale dhe kushtet në të cilat ato mund të përdoren. Ato nuk parashikojnë ndryshime ose mundësi, që do të ndryshonin natyrën e përgjithshme të projektit;

b) për punë ose shërbime shtesë nga koncesionari/partneri privat, që janë bërë të nevojshme dhe nuk përfshihen në projektin fillestar, kur ndryshimi i koncesionarit/partnerit privat:

i. nuk mund të bëhet për arsye ekonomike ose teknike, siç janë kërkesat që shkëmben ose ndërveprueshmëria me pajisjet, shërbimet ose



instalimet ekzistuese të prokuruar sipas projektit original;

ii. do të shkaktonte vështirësi të mëdha ose një rritje të konsiderueshme të kostove për autoritetin kontraktues ose entin kontraktues;

c) kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. nevoja për ndryshim ka lindur si rezultat i rrethanave të jashtme, që autoriteti kontraktues ose enti kontraktues nuk mund t'i parashikonte;

ii. ndryshimi nuk ndryshon natyrën e përgjithshme të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat;

iii. nuk kalon 50% të vlerës së kontratës fillestare për çdo modifikim;

ç) kur një koncesionar/partner i ri privat zëvendëson atë me të cilin autoriteti kontraktues ka lidhur fillimisht kontratën, si rezultat i:

i. një dispozite ose varianti të rishikimit të paverifikuar, në përputhje me shkronjën "a", të pikës 3 të këtij neni;

ii. pasardhësi i përgjithshëm ose i pjesshëm privat zëvendëson ortakun e mëparshëm privat pas ristrukturimit të shoqërisë, duke përfshirë blerjen, bashkimin ose falimentimin e një operatori tjetër ekonomik, që plotëson kriteret cilësore të përzgjedhjes, të përcaktuara fillimisht me kushtin për të mos sjellë ndryshime të tjera thelbësore në kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat dhe nuk synon të anashkalojë zbatimin e dispozitave të këtij ligji;

iii. në rast se autoriteti kontraktues ose enti kontraktues merr përsipër detyrimet kryesore të koncesionarit/partnerit privat ndaj nënkontraktuesve të tij, nëse kjo mundësi parashikohet sipas legjislacionit në fuqi;

d) kur ndryshimet, pavarësisht nga vlera e tyre, nuk janë thelbësore, në kuptim të pikës 8 të këtij neni.

4. Autoritetet kontraktuese ose entet kontraktuese, që kanë ndryshuar kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat, sipas shkronjave "b" dhe "c", të pikës 3 të këtij neni, publikojnë një njoftim për këtë qëllim, njoftim, i cili përmban minimalisht informacionin e mëposhtëm:

a) emrin, numrin e identifikimit (aty ku parashikohet në legjislacionin kombëtar), adresën, duke përfshirë numrin e telefonit, *email*-in dhe adresën e internetit të autoritetit ose entit kontraktues dhe, nëse është ndryshe, atë të shërbimit nga i cili mund të merret informacion shtesë;

b) kodet CPV;

c) përshkrimin e koncesionit/partneritetit publik privat, para dhe pas ndryshimit, natyrën dhe shtrirjen e punimeve, natyrën dhe shtrirjen e shërbimeve;

ç) kur është e mundur, modifikimin e vlerës së koncesionit/partneritetit publik privat, duke përfshirë rritjen e çmimeve ose tarifat e shkaktuara nga ndryshimi;

d) përshkrimin e rrethanave që kanë bërë të nevojshëm modifikimin;

dh) datën e vendimit për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat;

e) kur është e mundur, emrin, adresën, duke përfshirë numrin e telefonit, adresën e *email*-it dhe adresën e internetit të operatorit ose të operatorëve të rinj ekonomikë;

ë) informacionin nëse koncesioni/partneriteti publik privat lidhet me një projekt dhe/ose program të financuar nga fondet e Bashkimit Evropian;

f) emrin dhe adresën e organit përgjegjës për procedurat e shqyrtimit dhe, sipas rastit, të ndërmjetësimit. Informacionin e saktë në lidhje me afatin për procedurat e rishikimit ose, nëse është e nevojshme, emrin, adresën, numrin e telefonit dhe *email*-in e shërbimit, nga i cili mund të merret ky informacion;

g) datën e dërgimit të njoftimit;

gj) çdo informacion tjetër përkatës.

5. Njoftimi, sipas pikës 4 të këtij neni, publikohet sipas një formulari standard, pjesë e dokumenteve të koncesionit.

6. Përveç rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat mund të ndryshohet edhe nëse vlera e ndryshuar e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat është nën dy vlerat e mëposhtme, me kusht që natyra e përgjithshme e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat të mos ndryshojë:

a) nën pragu e përcaktuar në pikën 2 të nenit 24 të këtij ligji; dhe

b) të mos e kalojë vlerën prej 10% të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat.

7. Për qëllim të llogaritjes së vlerave të përcaktuara në pikat 3, shkronjat "b" e "c", dhe 8 të këtij neni, vlera e përditësuar përfaqëson vlerën e referencës kur kontrata e koncesionit përfshin një klauzolë indeksimi. Nëse kontrata e koncesionit nuk përfshin klauzolën e indeksimit, vlera e përditësuar



llogaritet duke marrë parasysh inflacionin mesatar në Republikën e Shqipërisë.

8. Një ndryshim në kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat do të konsiderohet thelbësor kur projekti ndryshon materialisht nga projekti fillestar. Ndryshimi do të konsiderohet thelbësor kur plotësohen një ose më shumë nga kushtet e mëposhtme:

a) ndryshimi i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat paraqet kushte të cilat, nëse do të kishin qenë pjesë e procedurës fillestare të dhënies së projektit të koncesionit/partneritetit publik privat, do të kishin lejuar pranimin e më shumë kërkesave të ndryshëm nga ata të përzgjedhur fillimisht ose pranimin e një oferte të ndryshme nga ajo që ata kanë pranuar fillimisht;

b) ndryshimi i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat ndryshon balancën ekonomike të projektit në favor të partnerit privat në një mënyrë që nuk ishte parashikuar në projektin fillestar të koncesionit/partneritetit publik privat;

c) ndryshimi i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat zgjeron ndjeshëm objektin e projektit;

ç) kur një partner i ri privat/koncesionar zëvendëson atë me të cilin autoriteti kontraktues ka lidhur fillimisht kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat në raste të tjera nga ato të parashikuara në nënndarjen “ii”, të shkronjës “ç”, të pikës 3 të këtij neni.

9. Ndryshimet e kushteve thelbësore të kontratës, që nuk parashikohen në dokumentacionin e tenderit dhe/ose në vetë kontratën kërkojnë zbatimin e një procedure të re të dhënies së kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat.

10. Për të gjitha ndryshimet e kontratës autoriteti ose enti kontraktues kërkon një miratim paraprak nga ministria përgjegjëse për financat, e cila i vlerëson në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 11 të këtij ligji.

Neni 57

Transferimi i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat

1. Në përputhje me dispozitat e këtij neni, me pëlqimin paraprak me shkrim nga autoriteti ose enti kontraktues, kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat mund të transferohet tek një subjekt i

tretë, në përputhje me nënndarjen “ii”, të shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 56 të këtij ligji, nëse subjekti i tretë përmbush kriteret e kualifikimit, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve kur këto kriteret u referohen kushteve që nuk janë më të nevojshme për përmbushjen e kontratës, për shkak të faktit se këto detyrime kontraktuale janë tashmë duke u përmbushur ose duke u realizuar nga koncesionari/partneri privat i mëparshëm.

2. Transferimi i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat nuk prish cilësinë dhe nuk përkeqëson vazhdimësinë e realizimit dhe të përmbushjes së kontratës. Kur koncesionari/partneri privat është një subjekt për qëllime të veçanta, atëherë ndryshimi i të drejtave të pronësisë apo i menaxhimit të subjektit për qëllime të veçanta (SPV), si rezultat i transferimit të kapitaleve ose të aksioneve të biznesit, nuk mund të zbatohet pa miratimin e autoritetit kontraktues dhe të ministrisë përgjegjëse për financat, përveçse nëse ky është rezultat i tregimit të rregullt të aksioneve në një treg të rregulluar të kapitalit.

3. Për të gjitha transferimet e kontratës autoriteti ose enti kontraktues kërkon një miratim paraprak nga ministria përgjegjëse për financat, e cila i vlerëson në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 11 të ligjit.

4. Çdo transferim i kontratës së partneritetit publik privat, i miratuar sipas pikës 8 të nenit 51 të këtij ligji, vetëm pas marrjes së miratimit paraprak nga ministria përgjegjëse për financat, në përputhje me pikën 3 të këtij neni, dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës, sipas sektorit të kontratës së partneritetit publik privat. Në rastet e kontratave të partneritetit publik privat, objekti i të cilave nuk është në fushë përgjegjësie të ministrive të linjës, propozimi bëhet nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Neni 58

Nënkontraktimi

1. Autoriteti ose enti kontraktues në dokumentet e tenderit mund t’u kërkojë ofertuesve të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e kontratës, që ata mendojnë të nënkontraktojnë te palët e treta, si dhe nënkontraktorin e propozuar.

2. Kjo përqindje e caktuar për nënkontraktim duhet të jetë në përpjesëtim me vlerën e kontratës



dhe nuk duhet të tejkalojë 50 për qind të vlerës së përgjithshme të kontratës.

3. Autoriteti ose enti kontraktues miraton nënkontraktorët e mundshëm përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, pa cenuar parimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.

4. Dispozitat e këtij neni nuk prekin përgjegjësitë kryesore të operatorit ekonomik ndaj autoritetit ose entit kontraktues, për të cilin nënkontraktorët mbeten palë e tretë, kundrejt marrëdhënies kontraktuale ndërmjet operatorit ekonomik dhe nënkontraktorëve të tij dhe duke e lënë operatorin ekonomik kryesor përgjegjës për zbatimin e të gjithë kontratës, pavarësisht se një pjesë e saj zbatohet nga nënkontraktorët.

5. Autoriteti ose enti kontraktues lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti te nënkontraktori për furnizimet, shërbimet ose punët që i ka ofruar kontraktorit kryesor. Në çdo rast, kontraktori kryesor duhet të vihet në dijeni dhe të japë miratimin me shkrim për këto pagesa. Rregullat që lidhen me këtë mënyrë pagese përcaktohen në dokumentet e tenderit.

6. Në rastin e koncesioneve për punë, sa u përket shërbimeve që do të ofrohen në objekt nën mbikëqyrjen e autoritetit ose entit kontraktues, pas dhënies së koncesionit dhe jo më vonë se momenti i fillimit të zbatimit të tij autoriteti ose enti kontraktues do t'i kërkojë koncesionarit që të bëjë të ditur emrin, të dhënat e kontaktit dhe të përfaqësuesit ligjor të nënkontraktorëve të tij, të përfshirë në këto punë dhe shërbime, për aq sa ky informacion është i disponueshëm në atë moment. Gjithashtu, koncesionari është i detyruar të njoftojë autoritetin ose entin kontraktues për çdo ndryshim në këtë informacion gjatë gjithë periudhës së koncesionit, si dhe për çdo nënkontraktor të ri që mund të përfshijë më vonë në këto punë ose shërbime.

Pavarësisht nga paragrafi i mësipërm, autoritetet ose entet kontraktuese mund të vendosin si detyrim që informacioni i kërkuar t'u dërgohet drejtpërdrejt nga koncesionari. Këto rregulla nuk zbatohen për furnizuesit.

Autoritetet ose entet kontraktuese mund të zgjerojnë detyrimet e mëposhtme:

a) për koncesionet e shërbimeve që nuk lidhen me shërbimet e ofruara në objektet nën mbikëqyrjen

e autoritetit ose të entit kontraktues apo me furnizuesit e përfshirë në koncesionet e punëve dhe shërbimeve;

b) për nënkontraktorët e nënkontraktorëve të koncesionarit ose për hallkat e mëtejshme në zinxhirin e nënkontraktimit.

7. Me qëllim shmangien e shkeljeve të detyrimeve të përcaktuara në pikën 4 të nenit 31 të këtij ligji, autoritetet ose entet kontraktuese mund të verifikojnë nëse ekzistojnë arsye për përjashtimin e nënkontraktorëve, në përputhje me pikat 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12, të nenit 38 të këtij ligji. Nëse verifikimi tregon se ka arsye të detyrueshme për përjashtim, autoriteti ose enti kontraktues i kërkon operatorit ekonomik fitues të zëvendësojë nënkontraktorin përkatës. Nëse verifikimi tregon arsye jo të detyrueshme për përjashtim, autoriteti ose enti kontraktues mund të kërkojë që operatori ekonomik ta zëvendësojë atë.

8. Dispozitat e këtij neni nuk prekin përgjegjësitë kryesore të operatorit ekonomik ndaj autoritetit ose entit kontraktues, për të cilin nënkontraktorët mbeten palë e tretë, kundrejt marrëdhënies kontraktuale ndërmjet operatorit ekonomik dhe nënkontraktorëve të tij dhe duke e lënë operatorin ekonomik kryesor përgjegjës për zbatimin e të gjithë kontratës, pavarësisht se një pjesë e saj zbatohet nga nënkontraktorët.

9. Rregulla më të hollësishme për nënkontraktimin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 59

Zgjidhja e kontratës së koncesionit/ partneritetit publik privat

1. Autoriteti ose enti kontraktues mund të ndërpresë kontratën kur plotësohet një ose më shumë nga kushtet e mëposhtme:

a) mund të provojë se koncesionari/partneri privat nuk mund të kryejë detyrimet e veta, për shkak të paafësisë paguese, shkeljeve serioze apo çështjeve të tjera, që pengojnë apo nuk lejojnë vazhdimin e kontratës, në përputhje me standardet teknike dhe me standardet e tjera të pranuar;

b) kërkohet një ndryshim i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, e cila do të kërkonte një procedurë të re të dhënies së kontratës, në përputhje me pikën 10 të nenit 56 të këtij ligji;



c) koncesionari/partneri privat ka qenë në momentin e zhvillimit të procedurës konkurruese të dhënies së kontratës në një nga situatat e përcaktuara në pikën 4 të nenit 38 të këtij ligji dhe për rrjedhojë duhet të ishte shkualifikuar nga kjo procedurë;

ç) koncesionari/partneri privat dështon në sigurimin e financimit të projektit brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve, përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në kontratë.

2. Secila palë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, ka të drejtë të zgjidhë kontratën kur:

a) përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur për shkak të rrethanave të secilës palë;

b) ka shkelje serioze nga pala tjetër dhe se kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

3. Palët kanë të drejtë, gjithashtu, të zgjidhin kontratën me pëlqim reciprok.

4. Para zgjidhjes së kontratës, në përputhje me këtë nen, autoriteti ose enti kontraktues informon ministrinë përgjegjëse për financat për të gjitha rrethanat e njohura, të cilat çojnë e krijojnë kushtet për zgjidhjen e kontratës, dhe kërkon mendimin e saj.

Neni 60

Njësia e zbatimit të kontratës

1. Njësia e zbatimit të kontratës (në vijim, NJZK) është njësia e përhershme e ngritur brenda autoritetit kontraktues, përgjegjëse për menaxhimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat. Menaxhimi i kontratës është procesi i administrimit dhe i mbikëqyrjes së ekzekutimit të kontratës nga hyrja në fuqi deri në përfundimin e saj. Ky proces siguron që të gjitha palët kontraktuese të përmbushin detyrimet e tyre në përputhje me kushtet, afatet dhe termat e përcaktuar në kontratë, duke adresuar çdo problematikë që mund të lindë gjatë zbatimit të saj. NJZK-ja monitoron zbatimin e parashikimeve të kontratës, kushteve dhe afateve të saj, duke adresuar tek titullari i autoritetit kontraktues çdo problematikë që mund të lindë gjatë zbatimit të saj.

2. Detyrat e NJZK-së përfshijnë hartimin e planit të detajuar të zbatimit të kontratës, monitorimin e performancës jofinanciare, monitorimin e performancës financiare, menaxhimin e rreziqeve/risqeve, raportimin dhe dokumentimin e zbatimit të

kontratës, vlerësimin përfundimtar ose zgjatjen e afatit të kontratës, trajtimin e kërkesave apo të pretendimeve, që koncesionari/partneri privat ka ndaj autoritetit kontraktues, në kuadër të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, si edhe problematika të tjera që mund të lindin gjatë periudhës së zbatimit të saj. Për përmbushjen e detyrave të renditura më sipër, kur është e nevojshme, NJZK-ja kërkon nga autoriteti kontraktues mbështetje me ekspertizë të specializuar. Kur autoritetit kontraktues i mungon ekspertiza e specializuar që kërkohet nga NJZK-ja, e siguron atë nëpërmjet ekspertëve/konsulentëve të jashtëm të pajtuar, në përputhje me procedurat e prokurimit publik.

3. NJZK-ja harton dhe i paraqet autoritetit kontraktues, të paktën, katër raporte periodike në vit për performancën financiare dhe jofinanciare të kontratave të koncesionit/partneritetit publik privat, si dhe një raport vjetor për ecurinë e zbatimit të kushteve dhe të afateve të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, i cili përfshin të dhëna mbi sasinë dhe cilësinë e punëve e të shërbimeve të realizuara, njoftimet që palët kontraktuese i kanë bërë njëra-tjetrës, si dhe identifikimin e çdo problematike të hasur gjatë periudhës së raportimit.

4. Përpara përfundimit të kontratës, NJZK-ja harton raportin përfundimtar për realizimin e kontratës, i cili përmban një vlerësim të plotë të zbatimit dhe realizimit të kontratës, mangësive apo problematikave të hasura në vite, si dhe mënyrën e zgjidhjes apo të tejkalimit të tyre.

5. Raporti vjetor dhe raporti përfundimtar, të përmendur përkatësisht në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, paraqiten edhe në institucionin përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat, i cili i publikon me kontratën përkatëse në regjistrin e koncesioneve/partneritetit publik privat. Mosparaqitja në kohë e këtyre raporteve përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë. Gjoba vendoset nga institucioni përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

6. NJZK-ja raporton në institucionin përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat, sa herë kërkohet dhe brenda afatit të përcaktuar nga ky i fundit, për çdo çështje të lidhur me kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat. Mosrapor-



timi i përsëritur brenda afatit përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë. Gjopa vendoset nga institucioni përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

7. Rregullat e hollësishme për mënyrën e ngritjes, funksionet, detyrat, marrëdhënien me institucionin përgjegjës për koncesionet dhe partneritetin publik privat, si dhe trajtimin financiar të punonjësve të NJZK-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VI ÇËSHTJET FINANCIARE DHE ÇËSHTJET E LIDHURA

Neni 61 Marrëdhëniet e pronësisë

1. Në rast se një kontratë koncesioni/partneriteti publik privat përfshin përdorimin e pasurisë në pronësi të një personi, që nuk është i përfshirë në procedurën për dhënie të kontratës, marrëdhëniet e pronësisë, që shoqërojnë një pasuri të tillë, duhet të zgjidhen sipas legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit gjatë periudhës së kontraktuar.

2. Nëse Republika e Shqipërisë është pronare e pasurisë së paluajtshme, të përfshirë në realizimin e një kontrate koncesioni/partneriteti publik privat, ose nëse koncesioni/partneriteti publik privat përfshin përdorimin e të mirave publike, atëherë autoriteti kontraktues zgjidh të gjitha marrëdhëniet e pronësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në një mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit gjatë periudhës së kontraktuar.

Neni 62 E drejta e pronësisë

1. Objektet e ndërtuara në bazë të një kontrate koncesioni/partneriteti publik privat, duke përfshirë shtesat dhe përmirësimet, janë në pronësi të autoritetit kontraktues, përveçse kur parashikohet ndryshe në kontratë.

2. Në dokumentacionin e tenderit autoriteti kontraktues duhet të parashikojë kushtet në bazë të të cilave rregullohen të drejtat e pronësisë, të përshkruara në pikën 1 të këtij neni.

3. Pas zgjidhjes së kontratës koncesionari/partneri privat është i detyruar të dorëzojë objektet e ndërtuara në bazë të kontratës, pavarësisht nëse ato janë ndërtuar, rindërtuar, ruajtur, pajisur ose përmirësuar, tërësisht ose pjesërisht, sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar në kontratë, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.

4. Të gjitha çështjet, duke përfshirë edhe kushtet që kanë të bëjnë me të drejtat e pronësisë, si dhe me standardet e kërkuara të cilësisë, janë objekt i analizës së studimit të fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat për atë kontratë dhe të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, si dhe në vetë kontratën.

Neni 63 Subjekti për qëllime të veçanta (SPV)

1. Autoriteti kontraktor, nëse e konsideron të nevojshme për zbatimin me sukses të kontratës, mund të kërkojë në dokumentacionin e tenderit që operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomikë, i shpallur fitues, të krijojë një person juridik, një subjekt për qëllime të veçanta (SPV), që do të jetë përgjegjës për zbatimin e projektit të koncesionit/partneritetit publik privat.

2. SPV-ja mund të marrë pjesë vetëm në zbatimin e një kontrate koncesioni/partneriteti publik privat, për të cilën është themeluar.

3. SPV-ja krijohet në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar, që rregullojnë themelimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare.

4. Në rastin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, dokumentet e tenderit duhet të specifikojnë format e personit juridik, shumën minimale të kapitalit, si dhe marrëdhëniet e tjera ndërmjet ofertuesit më të suksesshëm, subjektit për qëllime të veçanta dhe autoritetit kontraktues.

Neni 64 Interesat e sigurisë

1. Koncesionari/partneri privat mund sigurojë të drejtat e tij ndaj çdo pagese të çdo lloji të marrë ose që pritet të merret nga ai, në zbatim të një kontrate koncesioni/partneriteti publik privat ose në lidhje me të, pa cenuar të drejtën e tij ndaj çdo pjese tjetër të pasurisë së tij. Ky sigurim nuk mund të krijohet pa pëlqimin e autoritetit kontraktues dhe mund të bëhet vetëm në favor të institucioneve financiare për



të siguruar pretendimet e këtyre institucioneve mbi bazën e kontratës së kredisë.

2. Pretendimet e institucionit financiar, sipas pikës 1 të këtij neni, lidhen vetëm me instrumentet financiare të fituara për qëllime të ekzekutimit të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat dhe nuk përfshijnë asnjë nga pretendimet e tjera, që kanë institucionet financiare ndaj koncesionarit/partnerit privat për arsye të tjera.

Neni 65

Dispozita e stabilizimit

1. Në përputhje me pikën 2 të këtij neni, ministritë dhe institucionet publike në varësi ose nën përgjegjësinë e tyre, që financohen nga buxheti i shtetit, mund të hyjnë në një angazhim detyrues, në emër të shtetit, i cili mund të sjellë implikime të drejtpërdrejta ose të tërthorta financiare në buxhetin e shtetit dhe/ose që do të ketë efektin e sigurimit të garancive financiare të përshtatshme në favor të koncesionarit/partnerit privat, me të cilin do të mbrohet kundër pasojave financiare të legjislacionit, i cili hyn në fuqi pas fillimit të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, që u nënshtrohet kufizimeve të mëposhtme:

a) pasojat financiare duhet të përshkruhen në mënyrë të qartë dhe të saktë;

b) angazhimi përfundon me përfundimin e marrëveshjes së koncesionit/partneritetit publik privat;

c) duhet të përshkruhet natyra e legjislacionit.

2. Një angazhim i tillë detyrues mund të ndërmerret vetëm pas miratimit me vendim të Këshillit të Ministrave. Llojet dhe natyra e angazhimit detyrues përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VII

ANKIMI ADMINISTRATIV

Neni 66

E drejta e ankimimit

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë konkurruese dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktues, për të cilin pretendon se është marrë në kundërshtim me

ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

2. Ndaj vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik ankimuesi ka të drejtë të ankimojë në gjykatën përkatëse, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative. Ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurat konkurruese, lidhjen e kontratës apo ekzekutimin e detyrimeve ndërmjet palëve.

Neni 67

Afatet e ankimit

1. Në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës konkurruese operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankimojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të kontratës ose publikimit të ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.

2. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankimojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të fituesit ose publikimit të njoftimit të anulimit.

3. Në procedurat me fazë, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit të ofertave, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen, sipas përcaktimeve në pikën 2 të këtij neni.

Neni 68

Paraqitja e ankesës

1. Operatori ekonomik ankimues dërgon ankesën në Komisionin e Prokurimit Publik. Rregullat e posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore ku ankuesi pretendon për shkeljet, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar, që



vërteton pagesën e tarifës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni ose formulari i ankesës nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar mangësitë. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

Neni 69

Veprimet paraprake

1. Me regjistrimin e ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës konkurruese deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave të dhënat e mëposhtme:

- a) për ankimesin, adresën dhe NUIS-in;
- b) të dhëna të plota për procedurën konkurruese (objektin, numrin i referencës, fondin limit, datën e zhvillimit të procedurës).

3. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktues, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikon:

- a) ankesën e plotë, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit;
- b) arsyet e shkualifikimit, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;
- c) pretendimet për kualifikimin/shkualifikimin e ofertuesve të tjerë, duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.

Neni 70

Të drejtat e operatorëve ekonomikë të interesuar

1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose të entit kontraktues për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën

e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 (shtatë) ditë nga e nesërmja e datës së publikimit të ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik.

2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente, që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë.

Neni 71

Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik

1. Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga e nesërmja e datës së depozitimit të ankesës.

2. Komisioni i Prokurimit Publik në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktues, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën konkurruese, nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktues ose ofertuesit.

3. Përpara lidhjes së kontratës Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

- a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji;
- b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktues të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;
- c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktues të vazhdojë procedurën konkurruese, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;
- ç) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një anese tjetër, që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.



4. Pas lidhjes së kontratës Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktues është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

b) të urdhërojë autoritetin kontraktues për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj;

c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme, si rezultat i shkeljes së këtij ligji.

Neni 72

Pavlefshmëria e kontratave

1. Një kontratë konsiderohet absolutisht e pavlefshme në rastet e mëposhtme:

a) nëse një autoritet ose ent kontraktues ka nënshkruar një kontratë pa publikuar paraprakisht shpalljen e njoftimit të kontratës, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji;

b) kur nuk janë zbatuar parashikimet e këtij ligji në lidhje me zbatimin e procedurave të ankimit, duke privuar personat e interesuar për të ushtruar të drejtën e tyre për ankim;

c) kur kontrata është nënshkruar në kushtet e konfliktit të interesit;

ç) nëse një autoritet ose ent kontraktues ka nënshkruar një kontratë, duke mos respektuar vendimin e dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

2. Kontrata mund të mos shpallet absolutisht e pavlefshme edhe nëse ajo është lidhur në kushtet e pikës 1 të këtij neni, nëse Komisioni i Prokurimit Publik pas shqyrtimit të të gjitha aspekteve përkatëse çmon se shpallja e pavlefshme e kësaj kontrate mund të cenojë çështjet thelbësore të interesit të përgjithshëm. Interesat ekonomikë të lidhur drejtpërdrejt me kontratën në fjalë, si kostot për shkak të vonesave në zbatimin e kontratës, kostot për shkak të shpalljes së një procedure të re prokurimi, kostot për shkak të ndryshimit të operatorit ekonomik, që do të zbatojë kontratën, si dhe kostot për shkak të detyrimeve ligjore si pasojë e pavlefshmërisë, nuk konsiderohen çështje thelbësore të interesit të përgjithshëm.

3. Në rastin e konstatimit të situatave, sipas pikës 2 të këtij neni, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të aplikojë zbatimin e masave të tjera administrative, si:

a) dënimin me gjobë të autoritetit ose entit kontraktues për shkeljet e konstatuara;

b) urdhërimin e autoritetit kontraktues për shkurtimin e afatit të zbatimit të kontratës për të minimizuar dëmin e shkaktuar.

4. Gjoha duhet të vendoset në raport me vlerën e kontratës së nënshkruar, por në çdo rast jo më shumë se 10% e kësaj vlere.

5. Rregullat e posaçme për këtë proces përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 73

Detyrimi për bashkëpunim

Refuzimi i nëpunësit civil, i funksionarit ose autoritetit/entit kontraktues për të dhënë informacion apo për të paraqitur dokumentacionin, që ka lidhje me procedurën nën hetim administrativ, përbën shkak që Komisioni i Prokurimit Publik ose ministria përgjegjëse për financat të kërkojnë marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Neni 74

Kundërvajtjet administrative

1. Ministri përgjegjës për financat, kur është rasti, mund t'i propozojë drejtuesit të autoritetit kontraktues marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

2. Përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë titullari i autoritetit kontraktues ose entit kontraktues për mosparaqitjen e raporteve periodike të përmbledhura të monitorimit të kontratave të koncesionit/partneritetit publik privat te ministria përgjegjëse për financat, në zbatim të nenit 11 të këtij ligji.

Neni 75

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat rregullohet nga ligjet e Republikës së Shqipërisë.



2. Koncesionari/partneri privat, aksionarët e tij dhe ortakët e tjerë të biznesit janë të lirë të zgjedhin ligjin, që rregullon marrëdhëniet e ndërsjella të tyre të biznesit.

3. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit/partnerit privat zgjidhet nëpërmjet mekanizmave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të pranuar nga palët në kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat, duke përfshirë edhe procedurat e arbitrazhit ndërkombëtar. Koncesionari/partneri privat, aksionarët e tij dhe ortakët e tjerë të biznesit janë të lirë të zgjedhin mekanizmat e duhur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

KREU VIII DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 76 Dispozita kalimtare

1. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për veprimet dhe procedurat për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private të filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Ky ligj nuk zbatohet për kontratat e koncesionit të nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç:

a) dispozitave që rregullojnë regjistrin e koncesioneve/partneriteteve publike private;

b) nenit 60 të këtij ligji, pa përfshirë kontratat, për të cilat ndjekja e zbatimit të tyre është rregulluar me akte ligjore e nënligjore të posaçme, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Ndryshimet në kontratat e nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji do t'i nënshtrohen këtij ligji.

4. Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, mbeten në fuqi dhe do të zbatohen deri në miratimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 77 Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Këshilli i Ministrave brenda një afati prej 9 muajsh nga botimi i këtij ligji miraton aktet nënligjore në zbatim të neneve 11, pika 8; 13, pika 4;

17, pika 3; 20, pika 4; 24, pika 2; 26, pika 2; 27, pika 2; 29, pika 2; 30, pika 5; 31, pika 5; 32, pika 2; 35, pika 2; 42, pika 4; 51, pika 8; 58, pika 9; 60, pika 7; 68, pika 1, dhe 72, pika 5, të këtij ligji.

2. Ministri përgjegjës për financat brenda një afati prej 3 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji miraton udhëzimin në zbatim të pikës 4, të nenit 11 të këtij ligji.

Neni 78 Shfuqizime

Ligji nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 79 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 9 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të pikës 1, të nenit 77 të këtij ligji, që hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 7, datë 8.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET Nr. 7, datë 8.1.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 88/2025, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



LIGJ
Nr. 92/2025

**PËR KUJDESHIN ALTERNATIV NË
FAMILJE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti i ligjit**

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për kujdesin alternativ në familje për fëmijët pa kujdes prindëror ose në rrezik për të humbur këtë kujdes, si një nga format e përkujdesjes alternative ndaj fëmijëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në Republikën e Shqipërisë.

2. Ky ligj përcakton rregulla për:

- a) shërbimin e kujdesit alternativ në familje;
- b) subjektet e përfshira në sistemin e kujdesit alternativ në familje;
- c) kushtet, standardet dhe procedurat e ofrimit të kujdesit alternativ në familje;
- ç) strukturat përgjegjëse publike dhe jopublike për kujdesin alternativ në familje;
- d) të drejtat e fëmijëve që përfitojnë kujdes alternativ në familje;
- dh) të drejtat e detyrimit e familjeve dhe të strukturave përgjegjëse për organizimin, zbatimin, monitorimin e inspektimin e kujdesit alternativ në familje.

**Neni 2
Qëllimi i ligjit**

1. Qëllimi i këtij ligji është garantimi i ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje në një

mjedis të përshtatshëm familjar për fëmijët në nevojë për përkujdesje e mbrojtje.

2. Ligji synon ruajtjen dhe garantimin e zhvillimit dhe mirëqenien e fëmijës në një mjedis të sigurt, mbështetës e përfshirës familjar, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, duke marrë parasysh nevojat individuale dhe duke promovuar zhvillimin harmonik e të shëndetshëm të tij/saj.

**Neni 3
Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet për çdo fëmijë pa kujdes prindëror ose në rrezik për të humbur këtë kujdes dhe/ose në nevojë për mbrojtje.

2. Kategoritë e fëmijëve që përfitojnë nga shërbimi i kujdesit alternativ në familje përfshijnë, por nuk kufizohen në, si më poshtë:

a) fëmijë pa kujdes prindëror kur asnjë nga prindërit nuk është i pranishëm ose nuk është në gjendje të ofrojë kujdes të përshtatshëm, përfshirë rastet kur njëri prind është fizikisht i munguar dhe tjetri është në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore;

b) fëmijë të braktisur;

c) fëmijë me të dy prindërit e vendosur në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, të cilët nuk kanë kujdestar ligjor dhe mbeten pa kujdesin e përshtatshëm familjar;

ç) fëmijë të prindërve me aftësi të kufizuara të rënda mendore ose fizike, të cilët, pavarësisht mbështetjes sociale, nuk janë në gjendje të ofrojnë kujdes të përshtatshëm;

d) fëmijë në rrezik për të humbur kujdesin prindëror dhe/ose në nevojë për mbrojtje, përfshirë ata që përballen me dhunë, abuzim, trafikim, neglizhim, shfrytëzim, apo në rrethana të verifikuara, që përbëjnë rrezik serioz për jetën, sigurinë apo zhvillimin e tyre;

dh) fëmijë shqiptarë, pa shtetësi apo me shtetësi të huaj, të identifikuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, fëmijë të pashoqëruar, të ndarë nga të dy prindërit ose të afërmit e tjerë të familjes dhe për të cilët nuk kujdeset ndonjë person madhor;

e) fëmijë me aftësi të kufizuara për të cilët prindërit nuk janë në gjendje të ofrojnë kujdes, përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, për shkak të kushteve të vështira social-ekonomike, problemeve të rënda të shëndetit mendor ose faktorëve të ngjashëm;



e) fëmijë të ndarë nga familjet e tyre për shkak të konflikteve të armatosura, emergjencave humanitare, kërkesave për azil, emigrimit të detyruar ose fatkeqësive natyrore;

f) fëmijë, prindërve të të cilëve u është hequr ose u ka humbur përgjegjësia prindërore sipas Kodit të Familjes dhe nuk kanë asnjë person tjetër të ngarkuar me përgjegjësinë ligjore për t'u përkujdesur për ta;

g) fëmijë të lindur nga nëna të mitura në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore, në rastet kur mungon rrjeti mbështetës në familje.

3. Kategoritë që nuk përfitojnë nga shërbimet e kujdesit alternativ në familje janë si më poshtë:

a) të mitur në konflikt me ligjin për të cilët është dhënë një masë që kufizon lirinë personale, me vendim të formës së prerë;

b) fëmijë në kujdesin e përkohshëm të një institucioni shëndetësor për qëllime mjekësore afatshkurtra dhe që prindërit kanë ruajtur përgjegjësinë prindërore.

Neni 4 Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Familje kujdestare” është familja që merr përgjegjësinë për të strehuar dhe për t'u përkujdesur për një ose më shumë fëmijë pa kujdes prindëror, me qëllim ofrimin e një mjedisi familjar e të kushteve për mirërritje, përmbushjen e nevojave dhe mbështetjen emocionale, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

b) “Fëmijë” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;

c) “Fëmijë i pashoqëruar” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;

ç) “Fëmijë në nevojë për mbrojtje” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimeve të legjislacionit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, me përjashtim të kategorive të fëmijëve që nuk përfitojnë nga shërbimet e kujdesit alternativ në familje në kuptim të këtij ligji;

d) “Fëmijë pa kujdes prindëror” është fëmija që për shkak të rrethanave të ndryshme nuk ndodhet nën kujdesin efektiv të asnjërit prej prindërve dhe ka nevojë për mbrojtje dhe kujdes alternativ në familje;

dh) “Familje kujdestare profesionale e certifikuar” është familja që ka kryer trajnimin e detyrueshëm të certifikuar nga autoriteti përgjegjës për sigurimin e cilësisë së shërbimit shoqëror;

e) “Inspektim” është procesi i strukturuar dhe i vazhdueshëm, i kryer nga inspektorati përgjegjës, me qëllim identifikimin e rasteve të shkeljeve të rregullave për kujdesin alternativ në familje, garantimin e cilësisë së shërbimit të kujdesit alternativ në familje dhe mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje;

e) “Kujdes alternativ në familje” është një formë e shërbimit të përkujdesjes alternative në familje që i ofrohet një fëmije në përputhje me rregullat e këtij ligji, të/së cilit/cilës i është njohur e drejta për kujdes alternativ në familje dhe që është i/e regjistruar në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje në Shqipëri;

f) “Kujdes alternativ profesional” është formë e specializuar e shërbimit të kujdesit alternativ në familje, e ofruar nga familje të trajnuara dhe të certifikuara në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

g) “Kujdes alternativ vullnetar” është formë e përkujdesjes alternative në mjedis familjar, që ofrohet në mënyrë vullnetare nga familje të të afërmeve të fëmijëve ose familje që nuk kanë lidhje familjare me fëmijën dhe që shfaqin vullnetin e tyre për të ofruar vullnetarisht shërbimin e kujdesit alternativ sipas nenit 10 të këtij ligji;

gj) “Mbështetje gjatë dhe pas kujdesit alternativ në familje” nënkupton ofrimin e një mbështetje të vazhdueshme përmes një pakete të shërbimeve dhe ndërhyrjeve të ofruara fëmijës dhe familjes kujdestare gjatë dhe pas përfundimit të periudhës së kujdestarisë për të lehtësuar tranzicionin në familjen e mëparshme të fëmijës, në familjen birësuese ose në një tjetër familje, që ofron shërbimin e kujdesit alternativ në familje, për të ruajtur sigurinë emocionale dhe për të nxitur zhvillimin harmonik e të qëndrueshëm e të pavarur të fëmijës;

h) “Monitorimi” është procesi i ndjekjes dhe i vlerësimit të përgjithshëm dhe periodik të zbatimit të rregullave në fuqi për kujdesin alternativ në familje, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjit për kujdesin alternativ në familje, vënien në pah të mangësive dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ, procesi i vëzhgimit në terren, i mbledhjes së të dhënave dhe i vlerësimit të kushteve të kujdesit



alternativ në familje, si dhe të zbatimit të planit individual të kujdesit për sigurimin e cilësisë së shërbimit dhe mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje;

i) “Ofrues i shërbimit” është familja e përzgjedhur sipas kriterëve të këtij ligji dhe që monitorohet për ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ;

j) “Plani individual i kujdesit” është dokumenti i personalizuar që përshkruan dhe adreson nevojat specifike të fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje dhe veprimet konkrete që ndërmerren për të garantuar mirëqenien, zhvillimin dhe mbrojtjen e fëmijës në mjedisin e kujdesit alternativ në familje;

k) “Riintegrim në familje” është procesi i kthimit të fëmijës nga kujdesi alternativ në familjen biologjike/aktuale ose në familjen birësuese, i cili realizohet në mënyrë të planifikuar e të mbështetur nëpërmjet ndërhyrjeve profesionale, për të garantuar qëndrueshmërinë dhe mirëqenien afatgjatë të fëmijës në familje.

Neni 5

Parimet e ofrimit të kujdesit alternativ në familje

Kujdesi alternativ në familje udhëhiqet nga këto parime themelore:

a) Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.

Ky parim përfshin të drejtën e fëmijës për t'u rritur në një mjedis familjar të sigurt, të qëndrueshëm dhe mbështetës, që garanton vazhdimësinë e kujdesit e të lidhjeve të tij/saj personale;

b) Parandalimi i ndarjes nga familja biologjike/aktuale, që nënkupton se vendosja në kujdes alternativ është masa e fundit, e cila ndërmerret vetëm pas shterimit të të gjitha formave të ndërhyrjes mbështetëse dhe parandalimit për forcimin e kapaciteteve prindërore e familjare. Sipas këtij parimi, strukturat përgjegjëse janë të detyruara të ofrojnë programe këshillimi, shërbime mbështetëse në banesë dhe përfshirjen e rrjetit të zgjeruar familjar përpara marrjes së çdo vendimi për vendosje të fëmijës në kujdes alternativ në familje;

c) Nevoja dhe përshtatshmëria, sipas të cilës fëmija vendoset në kujdes alternativ në familje vetëm kur është e domosdoshme dhe në atë formë që u përgjigjet më mirë nevojave të tij/saj individuale. Çdo vendim merret mbi bazën e një vlerësimi gjithëpërfshirës të historikut të fëmijës, të gjendjes shëndetësore, edukative dhe emocionale, si dhe të kapaciteteve të familjes biologjike dhe të asaj pritëse për të ofruar kujdes të përshtatshëm;

ç) Pjesëmarrja aktive, sipas të cilës fëmija ka të drejtë të informohet, të dëgjohet dhe të shprehë mendimin e tij/saj për çdo vendim, që prek jetën dhe zhvillimin e tij/saj. Ky parim zbatohet nëpërmjet sigurimit të informacionit të qartë dhe të kuptueshëm për moshën e zhvillimin e fëmijës, përfshirjes së tij/saj në proceset e vlerësimit dhe dokumentimit të mendimit të tij/saj në prani të profesionistëve të trajnuar për komunikimin me fëmijët;

d) Barazia dhe mosdiskriminimi, sipas të cilit çdo fëmijë në kujdes alternativ gëzon të drejtën e një trajtimi të drejtë dhe të barabartë me fëmijët e tjerë, pa dallim gjinie, etnie, origjine, statusi shoqëror, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar apo çdo karakteristike tjetër personale. Familja që ofron kujdes alternativ është e detyruar të sigurojë trajtim të barabartë dhe respektim të plotë për të drejtat e fëmijës;

dh) Qëndrueshmëria e marrëdhënieve shoqërore dhe familjare, sipas të cilës vendimet për vendosjen e fëmijës marrin në konsideratë afërsinë gjeografike dhe sociale për të ruajtur lidhjet ekzistuese me familjen, komunitetin dhe shoqërinë. Fëmijët vëllezër e motra nuk ndahen, përveçse kur kjo është në kundërshtim të qartë me interesin më të lartë të tyre. Në raste ndarjeje, merren masa që fëmijët të ruajnë kontaktet dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre;

e) Ruajtja e identitetit, sipas të cilit ofrimi i kujdesit alternativ në familje respekton edhe identitetin kulturor, etnik, fetar dhe gjuhësor të fëmijës.

Neni 6

Bashkëpunimi ndërinstitucional

1. Strukturat vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës dhe strukturat përgjegjëse të shërbimeve shoqërore, institucionet arsimore, shëndetësore, organet e rendit dhe të drejtësisë dhe organizatat e shoqërisë civile bashkëpunojnë ngushtë me qëllim



hartimin e zbatimin e planit individual të kujdesit dhe mbështetjen e fëmijës gjatë dhe pas kujdesit alternativ në familje.

2. Bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet strukturave përgjegjëse për kujdesin alternativ në familje bazohet në parimin e interesit më të lartë të fëmijës, ruajtjen dhe respektimin e dinjitetit të fëmijës, privatësisë së tij/saj dhe respekton çdo parim sipas këtij ligji.

Neni 7

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të fëmijës në nevojë për vendosje apo të vendosur në kujdes alternativ në familje, si dhe të familjes që ofron shërbimin e kujdestarisë familjare përpunohen nga punonjës apo organe të autorizuar dhe për qëllime të ligjshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Familja kujdestare dhe organet kompetente marrin të gjitha masat për ruajtjen dhe mospublikimin e të dhënave të fëmijëve, me përjashtim të rasteve të përcaktuara me ligj ose kur kërkohet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

3. Shkelja e dispozitave që mbrojnë të dhënat personale të fëmijës përbën shkelje të rëndë ligjore dhe u nënshtrohet masave administrative dhe/ose penale, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU II

LLOJET, KRITERET DHE PROCEDURA E SHËRBIMIT TË KUJDESIT ALTERNATIV NË FAMILJE

Neni 8

Llojet e kujdesit alternativ në familje

1. Kujdesi alternativ në familje ofrohet si kujdes alternativ profesional ose si kujdes alternativ vullnetar.

2. Lloji i kujdesit alternativ në familje përcaktohet në përputhje me vlerësimin individual të nevojave të fëmijës dhe interesin më të lartë të tij/saj.

3. Kur fëmija është në rrezik të menjëhershëm dhe nuk mund të qëndrojë në mjedisin aktual familjar, njësi/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe njësi e vlerësimit të nevojave dhe referimit në

nivel vendor marrin masa urgjente për vendosjen në kujdes alternativ, sipas këtij ligji.

4. Kur kushtet e ofrimit të kujdesit alternativ nga familja kujdestare ndryshojnë, njësi/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe njësi e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor marrin menjëherë masat e përshtatshme për garantimin e vazhdimësisë së kujdesit alternativ në familje, përfshirë edhe ndryshimin e familjes kujdestare ose të llojit të kujdesit alternativ.

5. Rregullat për përcaktimin e llojit të kujdesit alternativ, kushtet dhe procedurat për fillimin, ushtrimin dhe përfundimin e ofrimit të shërbimit, si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Kujdesi alternativ profesional në familje

1. Kujdesi alternativ profesional në familje ofrohet si kujdestari e specializuar dhe nga familje të certifikuara.

2. Kujdesi alternativ profesional në familje ofrohet si kujdestari e specializuar emergjence për raste të nevojës urgjente ose si kujdestari e specializuar për kategori të caktuara fëmijësh.

Neni 10

Kujdesi alternativ vullnetar në familje

1. Kujdesi alternativ vullnetar në familje ofrohet bazuar në vlerësimin e strukturave përgjegjëse sipas kreut III të këtij ligji dhe në interesin më të lartë të fëmijës nga:

a) familje të të afërmeve të fëmijës, si: gjyshi, gjyshja, motra ose vëllai i rritur, ungji, emta, nipi apo mbesa, të të afërmeve të tjerë të fëmijës dhe të rrethit të ngushtë miqësor të familjes të njohur nga fëmija;

b) familje që nuk kanë lidhje familjare me fëmijën dhe që shfaqin vullnetin e tyre për të ofruar vullnetarisht shërbimin e kujdesit alternativ.

2. Ofrimi i shërbimit të kujdesit alternativ vullnetar në familje i nënshtrohet detyrimit për monitorim dhe inspektim sipas vlerësimit të strukturave përgjegjëse të këtij ligji.



Neni 11

Masa parandaluese dhe ndërgjegjësuere

1. Bashkitë marrin masa të vazhdueshme me vëmendje nga familja për forcimin e prindërimit në interesin më të lartë të fëmijës, trajtimit në kohë të situatave dhe të shkaqeve, që çojnë drejt cenimit të interesit më të lartë të fëmijës, parandalimin e ndarjes së fëmijës nga familja biologjike dhe ajo aktuale dhe vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ në familje, identifikimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në juridiksionin e tyre.

2. Bashkitë marrin masa të vazhdueshme për ndërgjegjësimin e familjeve për angazhimin si familje kujdestare.

Neni 12

Kriteret dhe procedura e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje

1. Kujdesi alternativ në familje ofrohet nga familja që plotëson kriteret e mëposhtme:

a) prindi aplikues është në moshë madhore dhe gëzon zotësi të plotë për të vepruar;

b) prindi aplikues ka shtetësi shqiptare ose leje të rregullt qëndrimi në Republikën e Shqipërisë.

c) prindi aplikues ka vendbanim të përhershëm dhe jeton në Republikën e Shqipërisë;

ç) prindi aplikues nuk është në moshë pensioni sipas legjislacionit në fuqi në vend, me përjashtim të rasteve të kujdesit alternativ vullnetar në familje nga të afërmi;

d) ka kushte të përshtatshme banimi dhe familja siguron mjete të mjaftueshme të jetesës;

dh) nuk ka asnjë anëtar të familjes të dënuar për një vepër penale me vendim të formës së prerë;

e) nuk ka asnjë anëtar të familjes që rezultoi i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale, sipas ligjit nr. 62/2022, “Për Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale”;

ë) ofron mjedis të përshtatshëm e të qëndrueshëm familjar;

f) anëtarët e familjes janë në gjendje shëndetësore fizike ose mendore, që nuk rrezikojnë shëndetin, mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës;

g) nuk është përjashtuar më parë nga ofrimi i kujdesit alternativ në familje;

gj) ka pëlqimin me shkrim të të gjithë anëtarëve në moshë madhore të familjes, sipas certifikatës familjare për të kryer kujdestarinë;

h) ka përfunduar trajnimin për ofrimin e kujdesit alternativ në familje, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Kërkesa paraqitet me shkrim përmes portalit “e-Albania”.

3. Strukturat përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashkëpunim me njësinë/punonjësin për mbrojtjen e fëmijëve dhe njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor kryejnë vlerësimin paraprak dhe të thelluar të familjeve të interesuara. Vendimi për përzgjedhjen e familjeve jepet nga komisioni shumëdisiplinar në bashki dhe regjistrohet në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.

4. Komisioni shumëdisiplinar në bashki përbëhet nga 8 anëtarë si më poshtë:

a) drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;

b) drejtuesi i njësisë për mbrojtjen e fëmijës pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki;

c) drejtuesi i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë apo njësisë administrative;

ç) punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijës dhe njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit;

d) juristi;

dh) psikologu;

e) specialisti për çështjet e arsimit;

ë) specialisti për çështjet e shëndetësisë;

f) përfaqësuesi në nivel vendor nga Policia e Shtetit.

5. Familjet e regjistruara ndjekin trajnimin e strukturuar dhe të detyrueshëm për pajisjen me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme, sipas llojit të kujdesit alternativ. Modulet e trajnimit hartohen nga Shërbimi Social Shtetëror, miratohen nga autoriteti përgjegjës për sigurimin e cilësisë së shërbimeve, sipas legjislacionit në fuqi. Trajnimet ofrohen nga strukturat e shërbimit social vendor dhe/ose në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

6. Me përfundimin e kujdesit alternativ në familje, njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit marrin masa të menjëhershme për vendosjen e fëmijës në familjen biologjike, kur kjo është e mundur, vijimin e kujdesit alternativ në të njëjtën



familje apo në një familje të re kujdestare ose birësimin e fëmijës sipas rastit.

7. Rregullat për zbatimin e kriterëve dhe procedurën e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje, përfshirë shqyrtimin e kërkesës, regjistrimin, trajnimin dhe përfundimin e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ, si dhe për funksionimin e komisionit shumëdisiplinar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Regjistri Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje

1. Regjistri Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje përfshin të dhëna për familjet kujdestare dhe fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në nivel bashkie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Regjistri përmban të dhëna edhe për llojin dhe kohëzgjatjen e kujdesit alternativ, raportet e monitorimit dhe vlerësimit dhe çdo vendim të marrë nga strukturat përkatëse sipas këtij ligji. Regjistri Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje organizohet si pjesë e sistemit elektronik të shërbimeve sociale dhe në përputhje me standardet teknike të sigurisë dhe privatësisë, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Bashkia përditëson regjistrin me të dhëna për familjet e certifikuara për kujdesin alternativ në familje, familjet që ofrojnë shërbimin e kujdesit alternativ, si dhe për fëmijët e vendosur në kujdestari alternative në familje në juridiksionin e saj. Shërbimi Social Shtetëror administron dhe konsolidon të dhënat elektronike për kujdesin alternativ në familje në nivel kombëtar.

3. Të dhënat e Regjistrit Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje janë konfidenciale dhe trajtohen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Rregullat për organizimin, funksionimin dhe akses në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III

PROCEDURA E OFRIMIT TË KUJDESTIT ALTERNATIV NË FAMILJE

Neni 14

Identifikimi, referimi dhe menaxhimi i rasteve në nevojë për kujdes alternativ në familje

1. Identifikimi, referimi dhe menaxhimi i rasteve në nevojë për kujdes alternativ në familje realizohet nga njësia/punonjësit e mbrojtjes së fëmijës në bashkëpunim me njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor.

2. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit vlerësojnë nevojën e fëmijës për kujdes alternativ, ndërmarrin masat dhe kryejnë veprimet për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje.

3. Procedurat e referimit dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për kujdes alternativ në familje përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Informimi dhe marrja e mendimit të fëmijës

1. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës informon familjen biologjike/aktuale të fëmijës, si dhe fëmijën për mundësinë e vendosjes në një familje që ofron kujdes alternativ.

2. Fëmijës i merret mendim në kushte miqësore dhe të përshtatshme për moshën dhe kapacitetin zhvillimor për preferencat për vendosjen në kujdes alternativ në familje. Mendimi i fëmijës merret në prani të një psikologu, verbalisht për fëmijët e moshës 6–10 vjeç dhe/ose me shkrim për fëmijët e moshës mbi 10 vjeç dhe dokumentohet në çdo rast.

Neni 16

Vendimi për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje

1. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor krijon dosjen e menaxhimit të rastit në nevojë për kujdes alternativ, të cilën e përcjell për vendimmarrje pranë komisionit shumëdisiplinar në bashki.

2. Komisioni shumëdisiplinar në bashki merr vendim të arsyetuar bazuar në përshtatjen sa më të

mirë të nevojave të fëmijës me familjen kujdestare. Vendimi për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje përmban llojin dhe kohëzgjatjen e kujdesit alternativ, përgjegjësitë e organeve kompetente, masat paraprake për njohjen graduale të fëmijës me familjen kujdestare, masat mbështetëse për fëmijën, familjen kujdestare dhe, sipas rastit, familjen biologjike të fëmijës.

3. Rregullat për vlerësimin, procedurën dhe marrjen e vendimit për vendosjen në kujdes alternativ në familje përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17

Numri maksimal i fëmijëve në kujdes alternativ në familje dhe përjashtimet

1. Një familje ofron shërbimin e kujdesit alternativ në familje deri në tre fëmijë njëkohësisht, përfshirë edhe fëmijët biologjikë, të birësuar ose në kujdestari të saj. Përjashtimisht, më shumë se tre fëmijë vendosen në të njëjtën familje kujdestare në rastet kur kjo është në interesin më të lartë të fëmijëve dhe nuk cenon cilësinë e kujdesit, në bazë të vlerësimit të kryer nga njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor.

2. Përparësi për vendosjen në të njëjtën familje që ofron shërbimin e kujdesit alternativ u jepet fëmijëve që janë motra dhe vëllezër me njëri-tjetrin.

Neni 18

Shqyrtimi në gjykatë i kërkesës për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje

1. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës menjëherë me marrjen e vendimit të arsyetuar nga komisioni shumëdisiplinar për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje e paraqet kërkesën në gjykatë për vendosjen e fëmijës në familjen e përcaktuar, në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes.

2. Në rastet kur fëmija është në masë emergjente mbrojtjeje, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, vendoset menjëherë në familje që ofron shërbimin e kujdesit alternativ profesional emergjent deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

3. Dosja e përgatitur për rastin dhe vendimet administrative për përzgjedhjen e familjes që ofron

kujdes alternativ i bashkëlidhen kërkesës. Bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, gjykata regjistron dhe shqyrton me përparësi kërkesat për vendosjen e fëmijës në familje kujdestare, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes.

4. Vendimi i gjykatës i njoftohet menjëherë njësisë/punonjësit për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor, që ka ndjekur procedurën në gjykatë.

Neni 19

Procedura pas marrjes së vendimit në gjykatë

1. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës e regjistron menjëherë vendimin e gjykatës për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje dhe njofton për vendimin e marrë të gjitha strukturat e shërbimeve shoqërore në bashki.

2. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës merr masa për pasqyrimin në aktin e lindjes së fëmijës për kujdestarinë në përputhje me Kodin e Familjes dhe për përgatitjen paraprake.

Neni 20

Përgatitja e fëmijës për vendosje në kujdes alternativ në familje

1. Masat paraprake për vendosjen e fëmijës në familjen e caktuar për kujdes alternativ përfshijnë:

a) hartimin e planit individual të kujdesit për vendosjen në familjen që ofron kujdes alternativ;

b) informimin dhe përgatitjen psiko-sociale të fëmijës në përputhje me kapacitetin zhvillimor dhe moshën;

c) përshtatjen graduale të fëmijës me familjen kujdestare.

2. Përgatitja e fëmijës për vendosje në familjen që ofron shërbimin e kujdesit alternativ, sipas këtij neni, është e detyrueshme në të gjitha rastet dhe përfshin një sërë masash në planin individual të kujdesit për fëmijën, familjen kujdestare, në përputhje me ritmin individual të përshtatjes së çdo fëmije, si dhe masa për mbështetjen e fuqizimin e familjes së mëparshme, kur rikthimi i fëmijës është i mundur.

3. Rregullat për përgatitjen e fëmijës për vendosje në kujdes alternativ në familje miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.



Neni 21

Standardet e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje

1. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor, në bashkëpunim me fëmijën, familjen kujdestare, prindërit biologjikë/familjen e mëparshme, nëse është e mundur, hartojnë një plan individual të kujdesit alternativ në familje për fëmijën e vendosur në kujdes alternativ në familje. Plan individual i kujdesit rishikohet rregullisht në bazë të vlerësimit të nevojave të fëmijës.

2. Familja kujdestare ofron shërbimin e kujdesit alternativ në familje në përputhje me standardet e ofrimit të këtij shërbimi. Familja kujdestare është e detyruar të njoftojë njësinë/punonjësin për mbrojtjen e fëmijës dhe njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit për çdo ndryshim në rrethanat e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje.

3. Standardet e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

Neni 22

Vlerësimi periodik i situatës së fëmijës

1. Çdo rast kujdesi alternativ në familje vlerësohet periodikisht nga strukturat përgjegjëse monitoruese dhe inspektuese. Vlerësimi përfshin:

- a) gjendjen fizike, mendore dhe emocionale të fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje;
- b) zhvillimin social dhe të edukimit të fëmijës;
- c) cilësinë e marrëdhënies së fëmijës me familjen kujdestare dhe familjen biologjike/aktuale, sipas rastit;

ç) vijimësinë ose ndryshimin e vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ në familje.

2. Vlerësimi kryhet nga njësia/punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor në bashkëpunim me një ekip shumëdisiplinar dhe, kur është e mundur, me organizatat e shoqërisë civile kontribuuese në shërbimin e kujdesit alternativ sipas këtij ligji.

3. Raporti i vlerësimit periodik i njoftohet familjes kujdestare, fëmijës së vendosur në kujdes alternativ, familjes biologjike/aktuale, komisionit multidisiplinar në bashki, strukturave të shërbimeve

shoqërore në bashki dhe drejtorive rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

4. Kur raporti i vlerësimit rekomandon ndryshim të situatës së kujdesit alternativ në familje, njësia/punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit marrin masat për ndryshimet përkatëse sipas këtij ligji.

5. Kriteret, procedurat dhe instrumentet për vlerësimin periodik të situatës së fëmijës vendosur në shërbimin e kujdesit alternativ në familje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

Raportimi për keqtrajtimin e fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje

1. Çdo rast i dyshuar për abuzim, neglizhim, shfrytëzim ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës gjatë ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ raportohet pranë:

- a) njësisë/punonjësit të mbrojtjes së fëmijës ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor;
- b) strukturave të policisë ku ka vendbanimin familja kujdestare;
- c) linjës së këshillimit për fëmijë dhe të rinj.

2. Raportimi kryhet nga çdo individ apo institucion, publik ose jopublik, që ka dyshime të arsyeshme për abuzim, neglizhencë apo shkelje të të drejtave të fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje. Raportimi bëhet edhe në mënyrë anonime. Strukturat e shërbimeve shoqërore, ato të policisë ose linja e këshillimit për fëmijë dhe të rinj informojnë menjëherë për rastin njësinë/punonjësin për mbrojtjen e fëmijës dhe njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit në bashki.

3. Njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit, ose, sipas rastit, strukturat e shërbimeve shoqërore në bashki shqyrtojnë dhe marrin vendim të menjëhershëm për rastin. Vendimet përfshijnë masat e nevojshme, si ndërprerjen e menjëhershme të vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ dhe/ose, kur është e nevojshme, njoftimin e organeve ligjzbatuese.

4. Çdo rast i konfirmuar abuzimi, neglizhence apo shkeljeje të rëndë regjistrohet në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.



Neni 24

Monitorimi i ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje

1. Njësia/punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor monitorojnë kushtet e ofrimit të kujdesit alternativ në familje. Plani i monitorimit hartohet në përputhje me standardet e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje. Monitorimi realizohet çdo dy javë gjatë tre muajve të parë të vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ dhe, më pas, çdo muaj nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse, që përfshin vëzhgim në terren të mjedisit të jetesës së fëmijës, vlerësim psikologjik, vlerësim të situatës arsimore, sociale e shëndetësore të fëmijës dhe intervista me fëmijën e familjen kujdestare, si dhe konsultime me shkollën, institucionet shëndetësore dhe aktorë të tjerë të përfshirë.

2. Shërbimi Social Shtetëror, në nivel qendror e rajonal, monitoron zbatimin e standardeve të shërbimit të kujdesit alternativ në familje në të gjithë territorin e vendit. Monitorimi realizohet nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit dhe çdo katër muaj nëpërmjet vizitave në familje kujdestare me përzgjedhje rastësore.

3. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe Shërbimi Social Shtetëror sigurojnë zbatimin e rregullave të këtij ligji me qëllim harmonizimin e praktikave, mbledhjen e raportimit e të dhënave dhe ofrojnë mbështetje teknike për strukturat përgjegjëse përkatëse lidhur me kujdesin alternativ.

4. Shërbimi Social Shtetëror nëse gjatë monitorimit konstaton ose vlerëson se fëmija i vendosur në kujdes alternativ në familje ndodhet në situatë emergjente abuzimi, neglizhimi ose mungese kujdesi nga familja kujdestare, e referon rastin menjëherë pranë njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe punonjësit/njësisë për mbrojtjen e fëmijës. Procedurat zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë, si dhe me këtë ligj.

5. Për çdo vizitë monitorimi mbahet procesverbal, i cili regjistrohet në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.

6. Strukturat monitoruese të ofrimit të kujdesit alternativ në familje, sipas këtij neni, bashkëpunojnë me qëllim harmonizimin e planeve të monitorimit

dhe garantimin e realizimit të tyre në përputhje me standardet ligjore dhe profesionale.

7. Rregullat dhe procedura e monitorimit të situatës së fëmijës të vendosur në kujdes alternativ në familje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 25

Inspektimi

1. Inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale inspekton shërbimin e kujdesit alternativ në familje në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin, legjislacionin për shërbimet e kujdesit shoqëror, si dhe me këtë ligj. Inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale bashkëpunon me strukturat monitoruese të ofrimit të kujdesit alternativ në familje sipas këtij ligji, me qëllim harmonizimin e planeve të inspektimit dhe monitorimin për garantimin e realizimit të tyre në përputhje me standardet ligjore dhe profesionale.

2. Nëse gjatë inspektimit merret dijeni ose vlerësohet se një fëmijë i vendosur në kujdes alternativ në familje ndodhet në situatë emergjente abuzimi, neglizhimi ose dhune, apo mungese kujdesi nga familja kujdestare, inspektorati e referon menjëherë rastin pranë njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe njësisë/punonjësit për mbrojtjen e fëmijës në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë.

3. Për çdo vizitë inspektuese mbahet procesverbal, i cili së bashku me vendimin e inspektimit regjistrohen në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.

4. Rregullat e procedurat për organizimin dhe zbatimin e monitorimit e të inspektimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 26

Pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë

1. Organizatat e shoqërisë civile me përvojë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe ofrimit të shërbimeve shoqërore, të licencuara sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse, ofrojnë:



a) mbështetje në bashkëpunim me bashkitë për fëmijën dhe familjet që ofrojnë kujdes alternativ gjatë dhe pas kujdesit alternativ në familje;

b) trajnim, mbështetje dhe këshillim profesional në bashkëpunim me bashkitë për familjet kujdestare;

c) mbështetje për forcimin e kapaciteteve të bashkive për shërbimin e kujdesit alternativ në familje.

2. Bashkitë promovojnë bashkëpunimin dhe kontributin e organizatave të shoqërisë civile si pjesë e sistemit kombëtar të kujdesit alternativ në familje.

3. Kriteret dhe procedurat e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve të kujdesit alternativ në familje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV TË DREJTAT DHE DETYRIMET

Neni 27

Të drejtat e fëmijës në kujdes alternativ në familje

1. Gjatë qëndrimit në kujdes alternativ në familje, fëmija gëzon të gjitha të drejtat që rrjedhin nga legjislacioni vendas dhe ndërkombëtar për të drejtat e fëmijës, përfshirë të drejtën për:

a) mbrojtje nga situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose nga forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës;

b) arsim, përkujdesje shëndetësore, përkujdesje emocionale dhe psikologjike, përfshirje sociale dhe zhvillim të gjithanshëm për të garantuar zhvillimin e plotë të potencialeve të fëmijës;

c) pjesëmarrje në vendimmarrje që e prek drejtpërdrejt, sipas moshës, kapacitetit zhvillimor dhe pjekurisë së tij/saj;

ç) privatësi dhe dinjitet;

d) të ruajtur lidhjet me familjen biologjike/aktuale, përveç rasteve kur kjo cenon interesin e tij më të mirë.

2. Fëmija ka të drejtë të informohet dhe të japë pëlqimin, në përputhje me moshën, për të gjitha proceset që lidhen me vendosjen, vlerësimin, monitorimin e përfundimin e kujdesit alternativ në familje. Njësia/punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit marrin masa që fëmijët e vendosur në kujdes alternativ të informohen për linjat kombëtare të telefonit për

fëmijë dhe kontaktet në bashki, si dhe të drejtën e tyre për të kontaktuar lirisht me to.

Neni 28

Detyrimet e familjes kujdestare

1. Familja kujdestare ka për detyrë:

a) të sigurojë mjedis të sigurt, të shëndetshëm dhe përfshirës për zhvillimin e fëmijës;

b) të respektojë të drejtat e fëmijës dhe të promovojë pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje;

c) të ndjekë procesin e bashkëpunimit me strukturat shtetërore dhe të raportojë rregullisht për ecurinë e fëmijës;

ç) të garantojë ruajtjen e marrëdhënieve të fëmijës së vendosur në kujdes alternativ me familjen biologjike/e mëparshme;

d) të pranojë monitorimin, vlerësimin dhe inspektimin nga autoritetet përgjegjëse;

dh) të njoftojë menjëherë njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe njësinë/punonjësin e mbrojtjes së fëmijës për çdo situatë që cenon mirëqenien e fëmijës.

2. Familja kujdestare gëzon të drejtën ta shoqërojë fëmijën e vendosur në kujdes alternativ jashtë vendit me kushtin që të informojë njësinë/punonjësin e mbrojtjes së fëmijës në bashki dhe autoritetin shtetëror përgjegjës.

3. Familja kujdestare ka detyrimin të informojë menjëherë njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe njësinë/punonjësin e mbrojtjes së fëmijës për çdo ndryshim të rëndësishëm në gjendjen e familjes kujdestare.

Neni 29

Të drejtat e familjes biologjike/aktuale

1. Familja biologjike/e mëparshme e fëmijës, përveç rasteve të përjashtuara me vendim gjyqësor, ka të drejtë:

a) të informohet për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje, si dhe të informohet periodikisht për gjendjen e fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje;

b) të ruajë kontakte me fëmijën në mënyrë të sigurt dhe të mbështetur nga njësia/punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në bashki;

c) të përfshihet në programet e prindërimit dhe ato për riintegrimin e fëmijës në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës;



ç) të angazhohet aktivisht në tejkalimin e situatës përmes një pakete të plotë mbështetëse për fëmijën e vendosur në kujdes alternativ.

2. Marrëdhëniet ndërmjet familjes biologjike/aktuale dhe familjes që ofron shërbimin e kujdesit alternativ përcaktohen nga njësia/punonjësi i mbrojtjes së fëmijës dhe njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit në nivel vendor dhe janë pjesë e planit individual të kujdesit alternativ në familje.

KREU V FINANCIMI I SHËRBIMIT TË KUJDESTIT ALTERNATIV NË FAMILJE

Neni 30 **Burimet e financimit**

1. Shërbimi i kujdesit alternativ në familje financohet nga buxheti i shtetit, buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe burime të tjera të ligjshme.

2. Financimi i shërbimit të kujdesit alternativ bazohet në:

- a) llojin e kujdesit alternativ në familje;
- b) kohëzgjatjen e kujdesit alternativ në familje;
- c) nevojat e veçanta të fëmijës;
- ç) numrin e fëmijëve të vendosur në kujdes alternativ në të njëjtën familje.

3. Financimi përfshin financimin për shpenzimet për fëmijën e vendosur në kujdes alternativ në familje, si dhe për familjen kujdestare, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Neni 31 **Mbështetja financiare për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje dhe familjen kujdestare**

1. Familja që ofron shërbimin e kujdesit alternativ përfiton mbështetje financiare mujore dhe vjetore për të përballuar shpenzimet e kujdesit për fëmijën/t në kujdes alternativ.

2. Familja që ofron shërbimin e kujdesit alternativ profesional, përveç mbështetjes financiare sipas pikës 1 të këtij neni, përfiton pagë mujore për ofrimin e shërbimit të kujdesit alternativ profesional në familje. Prindi aplikues i familjes që ofron shërbimin e kujdesit alternativ profesional

regjistrohet si i punësuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

3. Masa e pagesës, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Rregullat dhe procedurat e përfitimit të mbështetjes financiare sipas këtij neni miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

KREU VI MASAT DHE E DREJTA E ANKIMIT

Neni 32 **Masat për familjet që ofrojnë kujdes alternativ në familje**

1. Familjet që ofrojnë kujdes alternativ në familje, që shkelin detyrimet e përcaktuara në këtë ligj, u nënshtrohen masave të mëposhtme:

- a) paralajmërim zyrtar për heqjen e përkohshme ose përfundimtare të statusit si familje kujdestare;
- b) heqje e përkohshme ose përfundimtare e statusit si familje kujdestare.

2. Masat sipas pikës 1 të këtij neni jepen në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Në rast se shkelja përsëritet ose në raste flagrante të keqtrajtimit të fëmijës, familja humbet përgjithmonë të drejtën për të ofruar kujdes alternativ në familje. Nëse shkeljet e identifikuara përbëjnë vepër penale, njësia/ punonjësi i mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor paraqet kallëzim penal në përputhje me Kodin Penal.

3. Vendimi për heqjen e kujdestarisë jepet nga komisioni shumëdisiplinar për kujdesin alternativ në familje në bashki me propozimin e njësive/punonjësit të mbrojtjes së fëmijës. Ky vendim është i ankimueshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi. Deri në marrjen e vendimit në formë të prerë, familja kujdestare pezullohet nga e drejta e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje. Në raste të tilla, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës, fëmija i vendosur në kujdes alternativ në familje transferohet në një familje që ofron kujdes alternativ profesional emergjent sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Vendimi për përfundimin e kujdesit alternativ në familje jepet nga gjykata.



Neni 33

Masat për punonjësit përgjegjës për kujdesin alternativ në familje

1. Punonjësit e ngarkuar me detyra dhe përgjegjësi në bazë të këtij ligji, që shkelin rregullat e këtij ligji, u nënshtrohen masave disiplinore sipas ligjit përkatës, i cili rregullon marrëdhënien e tyre të punës. Organet eprore të këtyre punonjësve, me nismën e tyre ose me kërkesë të cilitdo në dijeni të këtyre shkeljeve, janë të detyruar të fillojnë procedimin disiplinor. Mosfillimi i procedimit disiplinor përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor ndaj organit epror apo fillimin e ndjekjes penale sipas rastit, kur ka elemente të veprës penale.

2. Rastet e dyshuara të korrupsionit, shpërdorimit të detyrës ose mosveprimit nga ana e punonjësve të ngarkuar me detyra dhe përgjegjësi në bazë të këtij ligji dhe që sjellin pasoja për fëmijën u referohen organeve kompetente për hetim penal.

KREU VII

MJETET LIGJORE MBROJTËSE ADMINISTRATIVE

Neni 34

E drejta e ankimit

1. Çdo subjekt i përfshirë në procesin e kujdesit alternativ në familje ka të drejtë të paraqesë ankim administrativ kundër çdo vendimi përgjatë procesit të aplikimit dhe përzgjedhjes si familje që ofron kujdes alternativ në familje, ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje apo përfundimit të këtij shërbimi, përfshirë edhe vendimet:

a) për refuzimin e përzgjedhjes si familje kujdestare;

b) për ndërprerjen ose heqjen e së drejtës për ofrimin e kujdesit alternativ në familje;

c) që lidhen me përzgjedhjen e familjes, që ofron kujdes alternativ në familje;

ç) për masat ndaj familjes kujdestare.

2. Fëmija i vendosur në kujdes alternativ në familje ka të drejtë të paraqesë ankesa për procesin e vendosjes në kujdes alternativ në familje dhe trajtimin në familjen kujdestare. Ankesa paraqitet nga vetë fëmija ose përmes një përfaqësuesi ligjor, punonjësi social, psikologu, mësuesi të fëmijës ose nga një përfaqësues i organizatave të shoqërisë civile.

Neni 35

Shqyrtimi i ankesave

1. Pranë çdo bashkie ngrihet komisioni për shqyrtimin e ankesave për procesin e vendosjes në kujdes alternativ në familje dhe trajtimin në familjen që ofron kujdes alternativ në familje.

2. Ankesat regjistrohen në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje dhe shqyrtohen brenda 15 ditëve nga data e regjistrimit. Në rast të mosdhënies së përgjigjes brenda këtij afati, ankuesi ka të drejtë të ndjekë rrugën gjyqësore të shqyrtimit të ankesës.

3. Komisioni për shqyrtimin e ankesave në bashki merr vendim të arsyetuar me shkrim, të qartë dhe të kuptueshëm, duke marrë parasysh moshën dhe zhvillimin e fëmijës. Vendimi përmban edhe mjetet ligjore mbrojtëse, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative në fuqi. Vendimi i njoftohet menjëherë ankuesit.

4. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në bashki dhe për procedurën e shqyrtimit të ankesave, sipas këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 36

Akte nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore sipas neneve 8, pika 5; 12, pika 7; 13, pika 4; 14, pika 3; 16, pika 3; 22, pika 5; 24, pika 7; 25, pika 4; 26, pika 3; 31, pika 3 dhe 35, pika 4, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet sociale që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë udhëzimet sipas neneve 20, pika 3; 21, pika 3 dhe 31, pika 4, të këtij ligji.

Neni 37

Dispozitë kalimtare

1. Pikat 3, 4, 5 dhe 6, të nenit 24, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me dispozitat e



këtij ligji dhe deri në miratimin e akteve nënligjore përkatëse në zbatim të këtij ligji.

2. Vendimi nr. 149, datë 13.3.2018, i Këshillit të Ministrave “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare” zbatohet për aq sa nuk bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe deri në miratimin e akteve nënligjore përkatëse në zbatim të këtij ligji.

Neni 38
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 8, datë 8.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 8, datë 8.1.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 92/2025, “Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM

Nr. 845, datë 30.12.2025

PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE “OPERATORI I SHËRBIMEVE TË INTEGRUARA TË STERILIZIMIT” SHA (OSHS sh.a.) PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË INTEGRUARA TË PROCESIT TË STERILIZIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e shoqërisë aksionare “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sh.a., (OSHS sh.a.) me kapital 100% shtetëror, për ofrimin e shërbimeve të integruara të procesit të sterilizimit.

2. Shoqëria aksionare OSHS sh.a. ofron, kundrejt pagesës, shërbimet e mëposhtme:

a) ofrimin e seteve të personalizuara të instrumenteve kirurgjikale sterile;

b) furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale;

c) trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale;

ç) menaxhimin dhe administrimin e Stacionit Qendror të Sterilizimit në QSUT;

d) ofrimin e instrumenteve kirurgjikale sipas tipologjisë së ndërhyrjes, të paketuara në set individual për çdo pacient;

dh) menaxhimin e cikleve për ripërpunimin dhe sterilizimin e instrumenteve dhe të materialeve të tjera të ripërdorshme;

e) ripërpunimin e sterilizimin me avull dhe temperatura të ulëta;

ë) furnizimin me veshje sterile salle dhe materiale të ngjashme njëpërdorimshme;

f) trajtimin e mbetjeve spitalore me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e ambienteve;

g) digjitalizimin e menaxhimit, të ndjekjes dhe të raportimit të shërbimeve të integruara të sterilizimit.



3. Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë aksionare OSHIS sh.a. është 200 000 000 (dyqind milionë) lekë.

4. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare OSHIS sh.a., është Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

5. Shoqëria aksionare OSHIS sh.a. ofron shërbimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, kundrejt të gjitha spitaleve publike universitare, rajonale dhe bashkiake në Republikën e Shqipërisë.

6. Shoqëria aksionare OSHIS sh.a. mund të ofrojë shërbime të tjera shtesë për subjekte publike dhe private, në përputhje me statutin e shoqërisë e legjislacionin në fuqi.

7. Të gjitha tarifat e shërbimeve, sipas pikës 2 të këtij vendimi, do të arkëtohen nga shoqëria aksionare OSHIS sh.a.

8. Shoqëria aksionare OSHIS sh.a. financohet nga të ardhurat e gjeneruara nga ofrimi i shërbimeve publike të integruara të sterilizimit, si dhe nga burime të tjera të ligjshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të ardhurat përdoren vetëm për ushtrimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së saj, duke ruajtur karakterin e shërbimit publik.

9. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme për:

a) themelimin e miratimit të statutit të shoqërisë aksionare OSHIS sh.a.;

b) regjistrimin e shoqërisë aksionare në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

10. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i siguron shoqërisë aksionare OSHIS sh.a., mjediset e punës, të nevojshme për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë.

11. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i kalon pa pagesë shoqërisë aksionare asetet dhe të drejtat, që i kalojnë shtetit pas përfundimit të kontratës së koncesionit me nr. 1440/40, datë 10.12.2015, “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e kontratës së koncesionit e të legjislacionit në fuqi.

12. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërisë janë në vlerën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë dhe përballohen nga fondet e miratuara të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vitin buxhetor 2026, në artikullin 231 (shpenzime kapitale) të programit 07330 “Shërbime të kujdesit dytësor”. Injektimi i kapitalit fillestar do të kryhet menjëherë pas regjistrimit të shoqërisë aksionare në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

13. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 1425, datë 30.12.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E SPANJËS**

29.	Wielkopolskie	Kalisz	Szczytniki*
30.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminiek*
31.	Lubuskie	Zagań	Małomice*
32.	Lubuskie	Gorzów	Bogdaniec*
33.	Lubelskie	Parczew	Siemien*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 1429, datë 30.12.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR

Nr. 4, datë 5.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E FRANCËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Hauts-de-France	Pas-de-Calais	Calais*
2.	Pays de la Loire	Maine-et-Loire	Cholet*
3.	Pays de la Loire	Loire-Atlantique	Châteaubriant*
4.	Pays de la Loire	Vendée	Fontenay-le-Comte*
5.	Nouvelle-Aquitaine	Lot-et-Garonne	Nérac*
6.	Grand Est	Haute-Marne	Saint-Dizier*
7.	Centre-Val de Loire	Cher	Bourges*
8.	Auvergne-Rhône-Alpes	Allier	Moulins*
9.	Auvergne-Rhône-Alpes	Loire	Montbrison*
10.	Bourgogne-Franche-Comté	Côte-d'Or	Beaune*
11.	Bourgogne-Franche-Comté	Côte-d'Or	Dijon*
12.	Grand Est	Mame	Vitry-le-François*
13.	Pays de la Loire	Loire-Atlantique	Nantes*
14.	Pays de la Loire	Vendée	Les Sables-d'Olonne*
15.	Pays de la Loire	Vendée	La Roche-sur-Yon*
16.	Nouvelle-Aquitaine	Deux-Sèvres	Bressuire*
17.	Nouvelle-Aquitaine	Deux-Sèvres	Parthenay*
18.	Nouvelle-Aquitaine	Dordogne	Périgueux*
19.	Auvergne-Rhône-Alpes	Ain	Bourg-en-Bresse*
20.	Pays de la Loire	Loire-Atlantique	Saint-Nazaire*
21.	Nouvelle-Aquitaine	Haute-Vienne	Bellac*
22.	Île-de-France	Yvelines	Rambouillet*
23.	Nouvelle-Aquitaine	Dordogne	Bergerac*
24.	Hauts-de-France	Somme	Abbeville*
25.	Centre-Val de Loire	Loir-et-Cher	Romorantin-Lanthenay*
26.	Nouvelle-Aquitaine	Landes	Dax*



27.	Bretagne	Finistère	Morlaix*
28.	Normandie	Calvados	Bayeux*
29.	Bretagne	Côtes-d'Armor	Saint-Brieuc*
30.	Hauts-de-France	Nord	Dunkerque*
31.	Drôme*	-	-

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 1374, datë 17.12.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR

Nr. 5, datë 5.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Neuhardenberg*
2.	Bayern	Dingolfing-Landau	Simbach*
3.	Schleswig-Holstein	Steinburg	Krempelmarsch*
4.	Schleswig-Holstein	Steinburg	Schenefeld*
5.	Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*
6.	Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Ludwigslust-Land*
7.	Nordrhein-Westfalen	Paderborn	Delbrück*
8.	Nordrhein-Westfalen	Recklinghausen	Dorsten*
9.	Thüringen	Greiz	Zeulenroda-Triebes*
10.	Schleswig-Holstein	Plön	Lütjenburg*
11.	Niedersachsen	Cloppenburg	Garrel*
12.	Niedersachsen	Diepholz	Stuhr*
13.	Brandenburg	Potsdam-Mittelmark	Beetzsee*
14.	Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Röbel-Müritze*
15.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Torgelow-Ferdinandshof*
16.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Bergen auf Rügen*
17.	Brandenburg	Oberhavel	Kremmen*
18.	Baden-Württemberg	Alb-Donau-Kreis	Langenau*
19.	Niedersachsen	Cloppenburg	Bösel*
20.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Geldern*
21.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Goch*
22.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Rees*
23.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kevelaer*
24.	Niedersachsen	Vechta	Vechta*
25.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Barnim-Oderbruch*
26.	Brandenburg	Pignitz	Plattenburg*
27.	Niedersachsen	Diepholz	Barnstorf*
28.	Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Föhr-Amrum*
29.	Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Sylt*
30.	Niedersachsen	Emsland	Geeste*
31.	Niedersachsen	Stade	Fredenbeck*
32.	Niedersachsen	Harburg	Tostedt*
33.	Niedersachsen	Oldenburg	Ganderkesee*



34.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Peenetal/Loitz*
35.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Letschin*
36.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Wriezen*
37.	Hessen	Wetteraukreis	Rockenberg*
38.	Niedersachsen	Cloppenburg	Friesoythe*
39.	Brandenburg	Uckermark	Lychen*
40.	Nordrhein-Westfalen	Wesel	Kamp-Lintfort*
41.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Selsingen*
42.	Niedersachsen	Vechta	Goldenstedt*
43.	Thüringen	Northausen	Ellrich*
44.	Sachsen-Anhalt	Mansfeld-Südharz	Goldene Aue*
45.	Niedersachsen	Emsland	Lengerich*
46.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Bremervörde*
47.	Niedersachsen	Stade	Oldendorf-Himmelpforten*
48.	Niedersachsen	Oldenburg	Harstedt*
49.	Niedersachsen	Diepholz	Altes Amt Lemförde*
50.	Niedersachsen	Diepholz	Rehden*
51.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Miltzow*
52.	Sachsen	Meißen	Ebersbach*
53.	Bayern	Straubing-Bogen	Geschlöring*
54.	Nordrhein-Westfalen	Rhein-Erft-Kreis	Hürth*
55.	Niedersachsen	Verdun	Thedinghausen*
56.	Niedersachsen	Oldenburg	Großknäven*
57.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Rietberg*
58.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Verl*
59.	Schleswig-Holstein	Segeberg	Trave-Land*
60.	Niedersachsen	Grafschaft Bentheim	Wietmarschen*
61.	Nordrhein-Westfalen	Coesfeld	Lüdinghausen*
62.	Nordrhein-Westfalen	Kleve	Kleve*
63.	Schleswig-Holstein	Segeberg	Leczen*
64.	Niedersachsen	Oldenburg	Dötlingen*
65.	Sachsen-Anhalt	Anhalt-Bitterfeld	Zerbst/Anhalt*
66.	Nordrhein-Westfalen	Gütersloh	Versmold*
67.	Schleswig-Holstein	Ostholstein	Fehmarn*
68.	Niedersachsen	Aurich	Dornum*
69.	Nordrhein-Westfalen	Viersen	Kempen*
70.	Niedersachsen	Cloppenburg	Saterland*
71.	Niedersachsen	Osnabrück	Osterappeln*
72.	Sachsen	Leipzig	Grimma*
73.	Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Recknitz-Trebeltal*
74.	Sachsen-Anhalt	Altmarkkreis Salzwedel	Gardelegen*
75.	Niedersachsen	Emsland	Haselünne*
76.	Brandenburg	Havelland	Ketzin/Havel*
77.	Baden-Württemberg	Schwarzwald-Baar-Kreis	Donauaueschingen*
78.	Sachsen	Nordsachsen	Wernsdorf*
79.	Nordrhein-Westfalen	Hamm	Hamm*
80.	Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Sottrum*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve

të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht. që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 1421, datë 29.12.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 6, datë 5.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të



shfaqur në shtetin e Italisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Friuli-Venezia Giulia	Udine	Povoletto*
2.	Veneto	Verona	Oppeano*
3.	Veneto	Verona	Isola Della Scala*
4.	Piemonte	Alessandria	Occimiano*
5.	Emilia-Romagna	Bologna	Minerbio*
6.	Emilia-Romagna	Forlì - Cesena	Forlì*
7.	Emilia-Romagna	Parma	Sorbolo*
8.	Lombardia	Lodi	Zelo Buon Persico*
9.	Lombardia	Cremona	Casale Cremasco-Vidolascio*
10.	Emilia-Romagna	Bologna	San Giovanni In Persiceto*
11.	Emilia-Romagna	Modena	Solera*
12.	Emilia-Romagna	Ferrara	Voghiera*
13.	Emilia-Romagna	Modena	Modena*
14.	Lombardia	Brescia	Seniga*
15.	Piemonte	Novara	Novara*
16.	Lombardia	Mantua	Guidizzolo*
17.	Lombardia	Varese	Olgiate Olona*
18.	Lombardia	Mantua	Ceresara*
19.	Veneto	Venezia	Mira*
20.	Lombardia	Mantua	Goito*
21.	Lombardia	Mantua	Mamirolo*
22.	Lombardia	Mantua	Roverbella*
23.	Verona	Verona	Nogarole Rocca*
24.	Emilia-Romagna	Ferrara	Argenta*
25.	Piemonte	Torino	Front*
26.	Toscana	Pistoia	Agliana*
27.	Veneto	Treviso	Fonte*
28.	Emilia-Romagna	Ravenna	Lugo*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5 Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 1409, datë 24.12.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 7, datë 5.1.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E LETONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinës, ushqimit të thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
Kurzemes	Tukuma	Džukstes*
Kurzemes	Talsu	Gibulu*
Latgales	Augšdaugavas	Liksnas*



Vidzemes	Madonas	Cesvaines*
Vidzemes	Madonas	Kalsnavas*
Vidzemes	Ogres	Lauberes*
Vidzemes	Valkas	Ērgemes*
Zemgales	Bauskas	Iecavas*
Zemgales	Dobeles	Tērvetes*
Zemgales	Jelgavas	Glūdas*
Zemgales	Bauskas	Dāviņu*
Rīgas	Mārupes	Babītes*
Rīgas	Mārupes	Salas*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Letonisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se



nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të

mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 867, datë 9.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Letonisë”, shfuqizohet.



4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derri, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derri, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 8, datë 5.1.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e guhës blu të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Dolnośląskie	Dzierżonów	Niemcza*
Dolnośląskie	Kamienna Góra	Lubawka*
Dolnośląskie	Lubin	Lubin (rural)*
Dolnośląskie	Wolów	Wińsko*
Dolnośląskie	Ząbkowice Śląskie	Kamieniec Ząbkowicki*
Dolnośląskie	Zgorzelec	Sulików*
Dolnośląskie	Zgorzelec	Węgliniec*
Opolskie	Kędzierzyn-Koźle	Polska Cerekiew*
Warmińsko-Mazurskie	Gołdap	Banie Mazurskie*
Warmińsko-Mazurskie	Gołdap	Gołdap*
Warmińsko-Mazurskie	Lidzbark	Ometa*
Wielkopolskie	Czarnków-Trzcianka	Krzyż Wielkopolski*
Wielkopolskie	Kościan	Śmigiel*
Wielkopolskie	Konin	Kazimierz Biskupi*
Wielkopolskie	Międzychód	Kwilec*
Wielkopolskie	Poznań	Czerwonak*
Wielkopolskie	Złotów	Zakrzewo*
Wielkopolskie	Wolsztyn	Siedlec*
Zachodniopomorskie	Drawsko	Czaplinek*
Zachodniopomorskie	Drawsko	Ostrowice*
Zachodniopomorskie	Gryfino	Stare Czarnowo*
Zachodniopomorskie	Goleniów	Osina*
Zachodniopomorskie	Kołobrzeg	Dygowo*
Zachodniopomorskie	Kołobrzeg	Kołobrzeg (rural)*
Zachodniopomorskie	Pyrzyce	Lipiany*
Zachodniopomorskie	Pyrzyce	Pyrzyce*
Zachodniopomorskie	Świdwin	Poleczyn-Zdrój*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të guhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga



vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitruapat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitruapa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitruapave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo

28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitruapat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinarë shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3, të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe



embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 1351, datë 12.12.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 16, datë 7.1.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”; të VKM-së nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, si dhe të nenit 26, të “Rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të DSIK-së”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave që lidhen me procedurat e verifikimit të sigurisë së individëve, që aplikojnë për Certifikatë Sigurie të Personelit (CSP) dhe operatorëve ekonomikë, që aplikojnë për Certifikatë të Sigurisë Industriale (CSI), z. Mark Ndreca me detyrë drejtor i Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurisë Industriale.

2. Autorizoj z. Mark Ndreca, të kryejë veprimet si më poshtë:

a) të firmosë shkresat drejtuar autoriteteve verifikuese, për verifikimin e sigurisë;

b) të firmosë shkresat me të dhënat e operatorëve ekonomikë të certifikuar përshtatshmërisht, drejtuar

autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë;

c) të firmosë shkresat, për përditësimin e rekordeve të operatorëve ekonomikë të certifikuar përshtatshmërisht, drejtuar autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë;

d) të firmosë shkresat përcjellëse, për dërgimin e CSP-së tek institucionet shtetërore.

3. Z. Mark Ndreca nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

4. Ky urdhër do të jetë në fuqi deri më datë 31.12.2026.

5. Ngarkohet z. Mark Ndreca dhe Drejtoria e Vetting-ut dhe Sigurisë Industriale për zbatimin e këtij urdhri.

6. Ky urdhër hartohet në 2 (dy) kopje të njëjta, një kopje për Protokoll/Arkivin dhe një kopje për drejtorin e Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurisë Industriale.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Altin Jani

NJOFTIM
Nr. 230, datë 7.1.2026

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

“Marrëveshja e dhurimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë”, nënshkruar në Ankara, më 4.11.2025, ka hyrë në fuqi më 25 dhjetor 2025.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

NJOFTIM
Nr. 294, datë 8.1.2026

MBI DENONCIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

“Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit Hanns-Seidel të Republikës



Federale të Gjermanisë”, nënshkruar në Tiranë, më 2.4.2007 dhe përfunduar më 1 janar 2026.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM
Nr. 337, datë 18.12.2025

**MBI VLERËSIMIN E RAPORTIT
VJETOR TË PAJTUESHMËRISË TË
OPERATORIT TË SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT (OST) SHA,
PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të neneve 16, 54 dhe 58, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; vendimit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 103, datë 30.4.2018, “Mbi miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a.”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Pajtueshmërisë dhe Vlerësimit të Impaktit Rregullator me nr. 3089 prot., datë 17.12.2025, “Mbi analizën dhe vlerësimin e Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ‘OST’ sh.a., për vitin 2024”, konstatoi se:

1. Parashtrimi dhe shqyrtimi i Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë për vitin 2024

- Në zbatim të neneve 54 dhe 58 të ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar, dhe të Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a., Zyrtari i Pajtueshmërisë ka detyrimin të raportojë periodikisht dhe çdo vit pranë ERE mbi monitorimin e zbatimit të Programit të Pajtueshmërisë, me qëllim garantimin e ndarjes funksionale, organizative dhe vendimmarrëse, mbrojtjen e informacionit konfidencial dhe zbatimin e parimit të mosdiskriminimit.

- ERE, në ushtrim të funksionit mbikëqyrës, vlerëson raportin vjetor të pajtueshmërisë dhe përcakton rekomandime për përmirësimin e zbatimit të Programit të Pajtueshmërisë dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm.

2. Dorëzimi dhe shqyrtimi i raportit për vitin 2024

- Në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 252, datë 25.11.2024 (pika 2), deri në përfundimin e procesit të miratimit të kontratës dhe emërimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë nga ERE, detyrat dhe funksionet përkatëse janë kryer nga Zyrtari aktual i Pajtueshmërisë, i miratuar me vendimin nr. 50/2021 të Bordit të ERE-s.

- Zyrtari i Pajtueshmërisë i OST sh.a. ka depozituar pranë ERE Raportin Vjetor të Pajtueshmërisë së OST sh.a. për vitin 2024, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1140/3 prot.

- Nga shqyrtimi i materialit rezulton se raportimi i Zyrtarit ka si periudhë monitorimi vitin kalendarik janar–dhjetor 2024, ndërkohë që në hyrje është reflektuar periudha “31 mars–31 dhjetor 2024”, e cila vlerësohet si lapsus material.

3. Përmbushja e detyrimeve nga Zyrtari i Pajtueshmërisë për vitin 2024

- Nga analiza e raportit dhe verifikimet e kryera nga ERE, rezulton se OST sh.a. ka ruajtur ndarjen dhe pavarësinë institucionale, financiare dhe operacionale dhe nuk janë evidentuar shkelje të Programit të Pajtueshmërisë për vitin 2024.

- Është konstatuar përmbushja e detyrimeve të lidhura me pavarësinë e audituesit financiar dhe transparencën e njoftimit për përzgjedhjen e audituesve, në funksion të kushteve të certifikimit të OST sh.a. si operator i pavarur.

- Në aspektin e sigurisë së informacionit dhe sigurisë kibernetike, raportimi pasqyron masa të qëndrueshme kontrolli dhe mbrojtjeje, si dhe përpunshmëri me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

4. Nevoja për përmirësim dhe rekomandime për periudhën pasardhëse

- Nga vlerësimi i raportit vjetor të pajtueshmërisë për vitin 2024, rezulton se disa elemente kërkojnë përmirësim dhe raportim të plotësuar, konkretisht:

a) Raportim më i qartë dhe i përditësuar mbi strukturën organizative të OST sh.a. dhe ndryshimet eventuale, në përputhje me detyrimet raportuese të Programit të Pajtueshmërisë, si dhe rekomandimi që ky raportim të kryhet brenda dy muajve të parë të vitit pasardhës.

b) Përmbushja e plotë e detyrimeve të Programit, lidhur me të dhënat dhe platformat e informacionit, përfshirë rishikimin dhe përditësimin të paktën një



herë në vit të listës së autorizimeve për aksesin në informacionin tregtar të ndjeshëm.

c) Përmbushja e detyrimeve të Programit për informacionin publik, përfshirë raportimi mbi arkivimin e informacionit konfidencial.

d) Depozitimi pranë ERE-s i informacionit të detajuar mbi përdorimin e të ardhurave nga rrjeti OPGW, duke përfshirë analizën e kryer nga Drejtoria Teknike dhe vlerësimin e pavarur të Zyrtarit të Pajtushmërisë mbi ndikimin në pavarësinë financiare të OST sh.a., në përputhje me kërkesat e Programit dhe Vendimin nr. 194/2019.

e) Forcimi i mekanizmave të dokumentimit dhe gjurmueshmërisë për **shkeljet e Programit**, trajnimin/udhëzimin e stafit dhe konsultimet e dhëna, me qëllim rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë së plotë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin pjesërisht të Raportit Vjetor të Zyrtarit të Pajtushmërisë së shoqërisë “OST” sh.a., për vitin 2024 të hartuar nga Zyrtari (bashkëlidhur).

2. Miratimin e Vlerësimeve dhe Rekomandimeve të ERE-s për vitin 2024, mbi Raportin Vjetor të Zyrtarit të Pajtushmërisë (bashkëlidhur).

3. Zyrtari duhet të raportojë periodikisht çdo muaj të vitit pasardhës për plotësimin e rekomandimeve të lëna në këtë raportim.

4. Drejtoria e Pajtushmërisë dhe Vlerësimit të Impaktit Rregullator të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “Operatorin e Sistemit të Transmetimit” sh.a., Zyrtarin e Pajtushmërisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

RAPORTI I PAJTUESHMËRISË PËR VITIN 2024

MBI MASAT E NDËRMARRA PËR
IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË
PAJTUESHMËRISË PËR PERIUDHËN 1
JANAR–31 DHJETOR 2024 NË SHOQËRINË
OPERATORI I SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT OST SHA

Tiranë, prill 2025

Brunilda Veizi

zyrtariipajtushmërisë@ost.al

Tabela e përmbajtjes

KAPITULLI I

1. Hyrje

2. Shoqëria

3. Programi i Pajtushmërisë – Metodologjia e kontrollit

4. Parimet kryesore që drejtojnë veprimtarinë e OST

4.1 Trajtimi i barabartë i përdoruesve të rrjetit

4.1.1 Sistemet e informacionit të OST-së

4.1.2 Investimet në rrjetin e transmetimit

4.1.2.1 Përdorimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i rrjetit të fibrave optike (OPGW) si pjesë e rrjetit të transmetimit, për qëllime komerciale

4.1.3 Aksesit i Palëve të Treta në sistemin e transmetimit

4.1.4 Pajtushmëria e përdoruesve të rrjetit me Kodin e Transmetimit

4.1.5 Tregu Balancues i Energjisë Elektrike

4.1.5.1 Pjesëmarrësit e tregut të energjisë

4.1.5.2 Prokurimi i energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit

4.1.5.3 Ankandet mbi alokimin e kapaciteteve

4.1.5.4 Palët përgjegjëse për balancim

4.2 Konfidencialiteti i të dhënave dhe i informacionit të ndjeshëm tregtar

4.2.1 Sistemet e Teknologjisë së Informacionit

4.2.2 Siguria e sistemeve të informacionit

4.2.3 Të dhënat e platformave

4.2.3.1 Të dhënat që hidhen nga përdoruesit e sistemeve

4.2.3.2 Informacioni që palët e treta marrin nëpërmjet platformave

4.3 Pavarësia e shoqërisë

4.3.1 Certifikimi i OST-së si operator i pavarur i transmetimit

4.3.2 Pavarësia e Menaxhimit

4.3.2.1 Këshilli Mbikëqyrës



- 4.3.2.2 Administratori
- 4.3.2.3 Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës
- 4.3.2.4 Drejtuesit e OST-së
- 4.3.3 Pavarësia financiare
- 4.3.3.1 Programi ekonomik
- 4.3.3.3 Audituesit ligjorë
- 4.3.4 Pavarësia operationale

KAPITULLI II

5. Zbatimi i rekomandimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë për një implementim sa më eficient të Programit të Pajtueshmërisë

5.1 Njoftimi zyrtar dhe pjesëmarrja e ZP në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

5.2 Trajnimet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave/ sekretit tregtar

5.3 Informimi i ZP mbi vënien në dispozicion të të tretëve të rrjetit të fibrave optive (OPGW) që OST zotëron

5.4 Rishikimi dhe përditësimi i Programit të Pajtueshmërisë

6. Rekomandimet e Zyrtarit të Pajtueshmërisë për një implementim sa më eficient të Programit të Pajtueshmërisë

6.1 Njoftimi zyrtar dhe pjesëmarrja e ZP-së në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

6.2 Trajnimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave/informacionit të ndjeshëm tregtar

6.3 Informimi i ZP-së mbi vënien në dispozicion të të tretëve të rrjetit të fibrave optive (OPGW) që OST zotëron

6.4 Rishikimi dhe përditësimi i Programit të Pajtueshmërisë

KAPITULLI III

7. Konkluzione

KAPITULLI I

1. Hyrje

Ky raport hartohet në bazë të nenit 21 të direktivës 2009/72/EC e datës 13 korrik 2009, “Mbi rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të energjisë që shfuqizon direktivën 2003/54/EC”, vendimit të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.”, si dhe Programit të Pajtueshmërisë për OST sh.a.

Ky raport është përgatitur nga znj. Brunilda Veizi (këtu e më poshtë referuar si Zyrtari i Pajtueshmërisë).

Zyrtar i Pajtueshmërisë është caktuar me vendim nr. 20 datë 30.5.2017, të Këshillit Mbikëqyrës të

OST, i cili është miratuar më pas me vendim të Bordit të ERE-s, nr. 147, datë 28.9.2017.

Me vendim nr. 21, datë 28.11.2020, Këshilli Mbikëqyrës i OST-së ka riemëruar Zyrtarin e Pajtueshmërisë, si dhe Kontratën e ofrimit të shërbimeve të ZP-së, miratuar me vendim nr. 50, datë 17.2.2021 të Bordit të ERE-s, vendime të bazë të të cilave është lidhur kontrata, “Për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë” ndërmjet ZP dhe OST, me afat deri në datë 4 mars 2024.

Me vendim nr. 252, datë 25.11.2024, ERE ka vendosur fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë dhe miratimin e emërimit të Zyrtarit të pajtueshmërisë të propozuar nga OST, ku ndër të tjera ka vendosur: “...Deri në përfundim të procesit të miratimit të kontratës dhe emërimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë nga ERE, detyrat dhe funksionet përkatëse do të vazhdojnë të kryhen nga zyrtari aktual, i miratuar nga ERE me vendimin nr. 50/2021.”

Në bazë të vendimit të lartpërmendur më datë 12.12.2024, është nënshkruar kontrata për ofrimin e shërbimeve ndërmjet ZP dhe OST.

Ky raport vjetor hartohet në bazë të detyrave të Zyrtarit të Pajtueshmërisë, në lidhje me Programin e Pajtueshmërisë, i miratuar me vendim të Bordit të ERE-s, nr. 103, datë 30.4.2018, “Për miratimin e Programit të Pajtueshmërisë të OST sh.a.

Në bazë të pikës C.62 të Programit të Pajtueshmërisë, çdo vit jo më vonë se data 31 mars, Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet të përgatisë dhe dorëzojë në ERE një raport për përputhshmërinë e OST me këtë Program.

Me anë të shkresës nr. 1130/2 prot., datë 12.3.2025, nga ana e Zyrtarit të Pajtueshmërisë, është kërkuar shtyrja e afatit të dorëzimit të raportit për vitin 2024, për shkaqe të arsyeshme, e cila është miratuar nga ERE me anë të shkresës nr. 1140/2 prot., datë 1.4.2025.

Raporti i përgatitur për vitin 2024 përshkruan masat e ndërmarra për implementimin e Programit të Pajtueshmërisë për periudhën 31 mars–31 dhjetor 2024, me qëllim sigurimin e shmangies së sjelljeve diskriminuese të OST ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të energjisë elektrike dhe përdoruesve të rrjetit, pavarësisë e OST, konfidencialitetit të të gjithë informacionit të menaxhuar nga OST, si dhe transparencës së procedurave të ndjekura prej saj.

Informacioni i nevojshëm në përgatitjen e këtij raporti, ashtu si çdo vit, është siguruar nga strukturat



përkatëse të OST-së sipas funksioneve që ata kryejnë, siç janë Drejtoria e Drejtimit Operativ të Sistemit, Drejtoria e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Planifikim Zhvillim të Rrjetit të Transmetimit, Departamenti i Operimit të Sistemit, Drejtoria e Shërbimeve të Tregut, Drejtoria e Operimit të Tregut, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Çështjeve Korporative, Drejtoria e Shërbimeve të Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Projekteve të Huaja.

2. Shoqëria

Operatori i Sistemit të Transmetimit – OST sh.a. është krijuar dhe funksionon në formën e shoqërisë aksionare në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, regjistruar si person juridik me vendimin nr. 31935, datë 17.4.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OST sh.a. është e organizuar në formën e shoqërisë aksionare me kapital 100% shtetëror me aksionar të vetëm Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 3, datë 17.1.2024, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”, si përfaqësuese të shtetit si pronar të aksioneve të OST sh.a.

Në bazë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, OST-ja është personi juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

3. Programi i Pajtueshmërisë – Metodologjia e kontrollit

OST-ja si shoqëri ka miratuar dhe implementon një Program Pajtueshmërie, duke përcaktuar masat që duhen ndërmarrë, për të siguruar pavarësinë e saj, të parandalojë çdo formë trajtimi diskriminues dhe të aplikojë procedurat e duhura për të monitoruar pajtueshmërinë e Stafit Drejtues dhe punonjësve të shoqërisë, me Programin e Pajtueshmërisë.

Më specifikisht, Programi i Pajtueshmërisë përcakton çështjet kyçe që duhen monitoruar, në lidhje me:

- Shmangien e sjelljeve diskriminuese në aktivitetet e OST-së;
- Pavarësinë e OST-së.

Monitorimi i përmbushjes së këtyre detyrimeve është kryer duke aplikuar metodologjinë si më poshtë:

- Mbledhje informacioni dhe dokumentacioni nga strukturat përkatëse të shoqërisë;
- Intervista me stafin përgjegjës të përfshirë në këto struktura;
- Hulumtim i dokumentacionit të vënë në dispozicion (të tilla si vendime, kontrata, rregullore, relacione etj.).

Shqyrtimi, trajtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion janë trajtuar nga Zyrtari i Pajtueshmërisë në respektim të detyrimeve të marra përsipër me anë të kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë, si dhe bazuar në:

- Sjelljen etike (besim, integritet, profesionalizëm dhe diskrecion);
- Në një prezantim të drejtë: detyrimi për të raportuar në mënyrë të kujdesshme, me vërtetësi dhe paanshmëri); si dhe
- Kujdesin e duhur profesional.

Monitorimi është kryer në ambientet e OST dhe ka konsistuar në:

- Komunikim nëpërmjet *email*-it për mbledhjen e informacionit të nevojshëm;
- Intervista;
- Shqyrtim dokumentacioni.

Shtyllat kryesore që sigurojnë parimet themelore të veprimtarisë së OST-së dhe që janë konsideruar si pika kyçe të këtij Raporti, janë si më poshtë:

- Pavarësia e OST-së nga kompanitë vertikalisht të integruara që kryejnë ose janë të angazhuara në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror;

- Konfidencialiteti i të dhënave dhe i informacionit të ndjeshëm tregtar: përcaktimi, klasifikimi dhe ruajtja e konfidencialitetit të informacionit të ndjeshëm tregtar, përfshirë atë që u përket përdoruesve të sistemit, si dhe ato që u përkasin aktiviteteve të OST-së;

- Trajtim i barabartë i përdoruesve të sistemit: Detyrimi i OST-së që të trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë përdoruesit e sistemit dhe shmangien e praktikave diskriminuese dhe të njëanshme, si dhe të çdo praktike që shtrembëron konkurrencën.



4. Parimet kryesore që drejtojnë veprimtarinë e OST-së

OST-ja është tashmë anëtare e ENTSO-E, Rrjetit Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike, krijimi i së cilës mbështetet në parashikimet e bëra në Paketën e Tretë Legjislative të BE-së për Tregun e Brendshëm të Energjisë, e cila synon liberalizimin e mëtejshëm të tregjeve të energjisë elektrike dhe gazit në Bashkimin Evropian.

Për shkak të procesit të hapjes dhe të liberalizimit të tregut të energjisë, OST-të kanë marrë një rol të rëndësishëm bashkëveprues dhe janë bërë një pikë takimi për të gjithë pjesëmarrësit në treg. Paketa e Tretë e Energjisë, e cila përbëhet nga dy direktiva dhe tri rregullore evropiane dhe në veçanti direktiva (EC) 714/2009, “Mbi kushtet e hyrjes në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike”, nga e cila e ka burimin, krijimi i ENTSO-E, përcakton përgjegjësitë e ENTSO-E në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet OST-ve në të gjithë BE-në për të ndihmuar në zhvillimin e një rrjeti të transmetimit të energjisë elektrike panevropian, në përputhje me qëllimet e politikës energjetike të saj.

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të marra përsipër si anëtare e ENTSO-E, OST-ja është tashmë nënshkruese dhe palë në shumë kontrata të lidhura ndërmjet ENTSO-E nga njëra anë dhe OST-ve anëtare të Evropës Kontinentale.

Për sa i përket Shqipërisë, kjo paketë është pjesë e *Acquis communautaire* të Komunitetit të Energjisë në të cilin Shteti Shqiptar është palë si rezultat i nënshkrimit dhe ratifikimit të “Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë të vendeve të Evropës Juglindore” miratuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, “Për ratifikimin e traktatit të komunitetit të energjisë”, traktat në bazë të të cilit shtetet nënshkruese marrin përsipër implementimin e legjislacionit kyç të energjisë elektrike në BE, brenda një afati kohor të përcaktuar.

Në kuadër të zbatimit të parashikimeve të Paketës së Tretë të Energjisë, si dhe të kuadrit ligjor e rregullator të brendshëm, OST-ja duhet të jetë plotësisht e pavarur nga kompanitë vertikalisht të integruara që kryejnë ose janë të angazhuara në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, të zhvillojë veprimtarinë e saj në mënyrë të paanshme dhe transparente.

Këto kërkesa rregullatore duhet të konsiderohen prioritare për OST-në. Për të realizuar pajtueshmërinë me këto kërkesa, është e detyrueshme që çdo strukturë e OST-së të kërkojë dhe të sigurojë pajtueshmërinë me këto kritere.

Një pjesë e akteve legjislative të lartpërmendura kanë pësuar ndryshime pas votimit të suksesshëm të Këshillit në datë 18 janar, si dhe të Parlamentit Evropian më 26 mars 2019, pjesë e paketës “Energji e pastër për të gjithë evropianët”. Më datë 14 qershor 2019, aktet legjislative të “Paketës për Energji të Pastër (CEP), u botuan në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, e konkretisht:

- Direktiva e Energjisë (direktiva 2019/944, e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 5 qershor mbi rregullat e përbashkëta të tregut të brendshëm të energjisë që amendon direktivën 2012/27/EU);

- Rregullorja e Energjisë (rregullore 2019/943, e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 5 qershor 2019, mbi tregun e brendshëm të energjisë);

- Rregullorja e ACER-it (rregullore 2019/942, e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 5 qershor, për krijimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunim të Rregullatorëve të Energjisë);

- Rregullorja e Parandalimit të Riskut (rregullore 2019/941 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 5 qershor mbi parandalimin e riskut dhe që ndryshon direktivën 2005/89/EC.

Ky kuadër i ri ligjor ka një impakt domethënës mbi OST-të dhe ENTSO-E, e cila në fillim të vitit 2019 ka lançuar një projekt mbi impaktin e Paketës për Energji të Pastër te vetë organizata dhe OST-të, si dhe për vetë OST-ja në një të ardhme jo shumë të largët.

Një zhvillim i mëtejshëm i rëndësishëm që luan një rol vendimtar në përafrimin e legjislacionit të brendshëm të vendeve anëtare të Komunitetit të Energjisë me atë të Bashkimit Evropian në kuadër të tregut të brendshëm të energjisë, është dhe vendimi D/2022/03/MC-EnC i Këshillit Ministerial të Komunitetit të Energjisë i datës 15 dhjetor 2022, “Mbi inkorporimin e rregullores (BE) 2019/942, rregullorja (BE) 2019/943, rregullores (BE) 2015/1222, rregullores (BE) 2016/1719, rregullores (BE) 2017/2195, rregullores BE 2017/2196, rregullores BE 2017/1485 në *Acquis* të Komunitetit të Energjisë, që ndryshon aneksin I të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe mbi



ndryshimet e vendimeve të Këshillit Ministror nr. 2021/13/MC-EnC dhe nr. 2011/02/MC-EnC.

4.1 Trajtimi i barabartë i përdoruesve të rrjetit

Në pikën 38 të Programit të Pajtushmërisë përcaktohet se, në përputhje me kërkesat e transparencës së kompanisë OST, duhet të sigurohet që të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit të trajtohen në mënyrë jodiskriminuese dhe me kushte të njëjta kur ofrohet informacioni funksional dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me aktivitetet e OST-së. Nëse ndonjë informacion i ndjeshëm tregtar duhet të shpërndahet, duhet të sigurohet që ky informacion është shpërndarë për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit, duke e publikuar atë në faqen e internetit të OST-së. Në lidhje me këtë detyrim, është bërë monitorimi i informacionit të publikuar në *website*-in e OST.

4.1.1 Sistemet e informacionit të OST-së

OST-ja ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të siguruar transparencë dhe akses të barabartë për të gjithë përdoruesit, në informacionin që shoqëria është e detyruar të publikojë në faqen e saj zyrtare, në bazë të kuadrit rregullator që drejton veprimtarinë e saj.

Në bazë të:

- Rregullores së Parlamentit Evropian dhe Këshillit nr. 714/2009, “Mbi kushtet për akses në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë”;
- Rregullores së Komisionit nr. 543/2013, datë 14 qershor 2013, “Mbi paraqitjen dhe publikimin e të dhënave në tregjet e energjisë”;
- Memorandumit të mirëkuptimit në lidhje me vënien në dispozicion të të dhënave nga anëtarët e ENTSO_E për Platformën e Transparencës, nënshkruar ndërmjet OST-ve anëtare të ENTSO-E dhe ENTSO_E

- Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe
- Vendimit të Bordit të ERE-se nr. 118, datë 27.7.2017, “Rregullat për publikimin e të dhënave baze të tregut të energjisë elektrike”,

OST-ja ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar implementimin e duhur, nëpërmjet publikimit të informacionit publik në *website*-in zyrtar të saj, duke siguruar një përshkrim të shoqërisë, të veprimtarisë së saj, kuadrit ligjor rregullator, si dhe të shërbimeve që ofron, me transparencë, paanshmëri dhe pa diskriminim, për të gjithë përdoruesit e rrjetit.

Në referim të pikës 42 të Programit të Pajtushmërisë, informacioni që publikohet në *website*-in zyrtar të OST, konsiston në:

- Informacion të plotë mbi kuadrin ligjor dhe rregullator, si dhe dokumentacion e nevojshëm udhëzues mbi aplikimin dhe dokumentet për aplikimin për lidhje të re/modifikimin të lidhjes ekzistuese në sistemin e transmetimit;
- Informacion mbi tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike miratuar me vendimet përkatëse të Bordit të ERE-s;
- Informacion mbi alokimin e kapaciteteve të transmetimit, të dhëna për pjesëmarrësit e ankandeve, rregullat për alokimin e kapaciteteve;
- Informacion mbi kapacitetet e lira të përdorura;
- Informacion mbi procedurat e prokurimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe rezultatet e këtyre procedurave, rregullat për mekanizmin balancues, lista e pjesëmarrësve të tregut balancues;
- Lista e pjesëmarrësve të regjistruar në tregun balancues të energjisë elektrike, formularët për regjistrimin e tyre, kontrata tip për shërbimin e transmetimit e miratuar nga ERE.

Nga monitorimi i herëpashershëm i *website*-it zyrtar të OST-së, si dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e ERE-s, vërehet se ai është riorganizuar duke përmirësuar mënyrën e dhënies dhe organizimit të informacionit të duhur sipas fushave të caktuara, duke bërë një prezantim më të mirë, menaxhimin e duhur të informacionit të rëndësishëm, si dhe pajtushmërinë me standardet e sigurisë që aplikohen për sistemet e informacionit, të tilla si:

- Zbatimi i Protokolleve të Sigurisë: përdorimi HTTPS për të siguruar një lidhje të koduar mes serverit të *website*-it dhe përdoruesit, që mbron të dhënat e transmetuara.

- Përditësimet e *Software*-it: *website* mbahet i përditësuar për të shmangur ekspozimin ndaj dobësive të sigurisë.

- Auditimet e sigurisë: kryen në përgjithësi auditime të rregullta të sigurisë për të identifikuar dhe adresuar çdo çështje të mundshme të sigurisë që mund të ndikojë në integritetin e *website*-it.

OST-ja kujdeset në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar që informacioni i publikuar të jetë gjithmonë i saktë, i sigurt dhe përmbush nevojat e kompanisë dhe përdoruesve. Përmbajtja e faqes është gjithmonë e përditësuar dhe reflekton ndryshimet më të fundit në politikat, procedurat dhe



lajmet e shoqërisë. Në mënyrë të vazhdueshme kryhet verifikimi i saktësisë së informacionit të publikuar për të shmangur çdo keqinformim të mundshëm të përdoruesve ose palëve të interesuara.

Në respektim të akteve të lartpërmendura, OST-ja publikon rregullisht në faqen *online* të saj, të dhënat si më poshtë:

Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga Departamenti i Operimit:

- Në rubrikën “Operimi” – “Të dhëna”, janë të publikuara: *Parashikimi D-1 i ngarkesës totale për BZ dhe parashikimi W-1 i ngarkesës totale për BZ* (<https://ost.al/te-dhena/>), për periudhën janar–dhjetor 2024.

Gjithashtu, rezultojnë të publikuara të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve të Tregut, si vijon:

Sipas rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 118, datë 27.7.2017:

- Rregullat e balancimit: <https://ost.al/balancimi/tregu-shqiptar-i-balancimit/legjislacioni/>;

- Sasia e rezervës balancuese sipas kontratës: <https://ost.al/balancimi/tregu-shqiptar-i-balancimit/kapaciteti-rezerve-dhe-energja-balancuese/kapaciteti-rezerve/>;

- Çmimet e kapacitetit rezervë të rezervave balancuese: <https://ost.al/balancimi/tregu-shqiptar-i-balancimit/kapaciteti-rezerve-dhe-energja-balancuese/kapaciteti-rezerve/>;

- Sasia e ofertave të pranuar: <https://ost.al/balancimi/tregu-shqiptar-i-balancimit/kapaciteti-rezerve-dhe-energja-balancuese/kapaciteti-rezerve/>;

- Sasia e rezervave të balancimit të aktivizuara: <https://ost.al/balancimi/tregu-shqiptar-i-balancimit/kapaciteti-rezerve-dhe-energja-balancuese/energja-balancuese/>;

- Çmimi i rezervave të balancimit të aktivizuara: <https://ost.al/balancimi/tregu-shqiptar-i-balancimit/kapaciteti-rezerve-dhe-energja-balancuese/energja-balancuese/>;

- Çmimet e disbalancave: <https://ost.al/balancimi/disbalancat/>;

- Sasia totale e disbalancave: <https://ost.al/balancimi/disbalancat/>.

Sa u përket të dhënave që publikohen në bazë të Rregullores së Komisionit Evropian nr. 543/2013, datë 14 qershor 2013 dhe Memorandumit të Mirëkuptimit, në lidhje me vënien në dispozicion të

të dhënave nga anëtarët e ENTSO_E për Platformën e Transparencës, OST-ja momentalisht ka arritur të publikojë mesatarisht rreth 77.2% të të dhënave të konfiguruar në platformën e Transparencës, kjo referuar raporteve që përcillen nga ENTSO-E. Një pjesë e konsiderueshme të dhënash referuar tregut balancues, shërbimeve ndihmëse (rezervave, kapacitetit, çmimet) vazhdojnë të publikohen manualisht në platformën TP si të dhëna historike pasi, në vitin 2024 OST është njohur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 148, datë 25.7.2024, “Mbi implementimin e intervalit kohor prej 15 minutash në operimin e proceseve në tregun e balancimit deri më 11.6.2025”, që solli ndryshim në konfigurime për sa i përket rezolucionit të këtyre të dhënave. Si rrjedhojë ofruesi i shërbimit po konfigurua platformën që këto të dhëna të publikohen automatikisht dhe në kohë reale, gjë që do të rrisë akoma më shumë përqindjen e të dhënave të publikuara në kohë reale nga ana e OST-së në Platformën e Transparencës (TP) të ENTSO-E.

4.1.2 Zhvillimi i sistemit të transmetimit

Nga ana e Zyrtarit të Pajtuështësisë i është kërkuar strukturave përkatëse (Drejtoria e Planifikimit Zhvillim të Rrjetit të Transmetimit, Drejtoria e Prokurimeve dhe Drejtoria Ekonomike), për të siguruar informacionin e duhur mbi implementimin e projekteve sipas planit 10-vjeçar të zhvillimit të shoqërisë.

Aktualisht, në zbatim mbetet ende Programi 10-vjeçar i Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2015–2025 i miratuar nga ERE me vendim nr. 186, datë 10.11.2017.

Përditësimi i Planit 10-vjeçar 2015–2025 konsiston në vitin e komisionimit për objektet, të cilat janë në proces apo parashikohen të përfshihen në investime nga dokumenti i miratuar nga ERE. Nga lista i vetmi tregues i ndryshuar është viti i komisionimit për ato objekte të cilat janë në proces apo parashikohen të përfshihen në investime. Kjo edhe si pasojë e faktorëve të ndryshëm ku mund të listohen të tillë si procedurat e prokurimit, shpronësimet etj.

Në tabelën e mëposhtme jepet lista e përditësuar e këtij plani e cila përmban të ndryshuar vitin e komisionimit për ato projekte të cilat janë në proces apo përfshihen në investime.

Tabela më poshtë pasqyron planin e paraqitur në ERE:

Plani dhjetëvjeçar 2015–2025 i zhvillimit të rrjetit të transmetimit²

	Objektet	Tipi i përcjellësit (mm ²)	Gjatësia (km)	Fuqia (MVA)	Viti i komisionimit	Vlera (euro)
1	Linja 110 kV Uznovë - Çorovodë dhe dalje 110 kV Uznovë	ACSR 240/40	33	122	2015	3,320,000
2	Linja 110 kV Lapaj - Peshkopi dhe dy dalje 110 kV	ACSR 240/40	32	122	2015	3,500,000
3	Blerja e dy AT 220/110/10 kV Burrel	2x 60 MVA	-	120	2015	1,600,000
4	Blerja e një AT 220/110/35 kV Elbasan	1x120 MVA	-	120	2015	1,200,000
	Blerja e një AT 220/110/35 kV Elbasan	1x120 MVA	-	120	2017	1,200,000
5	Linja 110 kV me dy qarqe Burrel- Bulqizë dhe dy dalje linje 110 kV	2xACSR 240/40	30	122	2022	4,000,000
6	Linje e re 110 kV, Rrëshbull-Golem-Kavajë	2xACSR 240/40	18	-	2016	1,700,000
7	Linja me dy qarqe Ulëz- Shkopet - Skuraj;	2xACSR 240/40	10.5	-	2016	1,800,000
8	Linja me një qark Skuraj - Laç-1	ACSR 240/40	12.7	-	2019	1,800,000
9	Linja me një qark Skuraj - Laç-2	ACSR 240/40	10.1	-		
10	Linja me dy qarqe Laç 2 – Laç 1	2xACSR 240/40	2.7	-		
11	Përforcim Linjë 110 kV, Lezhë-Laçi 2	ACSR 240/40	19.5	-	2023	1,700,000
12	Përforcim Linjë 110 kV, Ulëz-Kurbesh	ACSR 240/40	23.0	-	2025	2,000,000
13	Linje e re 110 kV, Lapaj-Lure, 2 dalje linje 110 kV	ACSR 240/40	19.0	-	2023	1,600,000
14	Linjë e re 110 kV, Sukth-Gj.Lalzit, 2 dalje linje 110 kV	ACSR 240/40	18.0	-	2020	1,900,000
15	Linjë e re 110 kV, Bulqizë-Termovë-Gjoricë	ACSR 240/40	20.0	-	2025	1,900,000
16	220/110 kV Fierzë, 1 dalje transformatori 220 kV, 1 dalje transformatori 110 kV	-	-	2 x 60	2020	2,000,000
17	Linjë e re 110 kV, Kukës-Prizren, 1 Dalje linje 110 kV, Nst. Kukës	ACSR 240/40	13.0	-	2025	1,500,000
18	Përforcim linje 110 kV, Elbasan1-Fiber, Fiber-Librazhd	2 x ACSR 240/40	30.0	-	2025	3,000,000
19	Përforcim linje 110 kV, Elbasan1-GSA-Cërrik-Kajan	ACSR 240/40	24.0	-	2023	2,040,000
20	Përforcim linje 110 kV, Kajan-Kuçovë-Marinëz-Fier	ACSR 240/40	59.0	-	2023	5,015,000
21	Linjë e re 110 kV, Fier-Lushnjë	ACSR 240/40	30.0	-	2024	2,400,000
22	Plotësim i qarkut të dytë të linjës 220 kV Fier-Babicë-TEC Vlorë	ACSR 490/65	35.0	-	2025	1,000,000
23	Linjë e re 110 kV, Ballsh-Memaliaj	ACSR 240/40	48.0	-	2025	7,080,000
24	Plotësimi i qarkut të dytë të linjës 110 kV, Kuçovë-Uznovë-Çorovodë	ACSR 240/40	58.0	-	2025	1,000,000
25	Linje e re 110 kV, Tiranë1-Qendër (Kabllorë), 1 dalje linje 110 kV.	XPLE-AL1000	2.3	-	2025	1,500,000
26	Linjë e re 110 kV, Koplik-Shkodra1	ACSR 240/40	20	-	2025	1,700,000
27	Linjë e re 110 kV, Kosmaç-Velipojë	ACSR 240/40	28	-	2025	2,380,000
TOTALI						59,835,000

Rreth 82% e projekteve të paraqitura më sipër pritet të përfundojnë brenda vitit 2024. Pjesa tjetër e mbetur pritet të realizohen brenda vitit 2025. Realizimi në masë të madhe i këtij programi 10-vjeçar të investimeve, përveç aspekteve të tjera ka sjellë nevojën e kryerjes së studimit të Master Planit të Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit 2018–2033 dhe hartimin e Programit të Ri të Zhvillimit 2026–2036.

Sa i përket “Programit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit 2026–2036”, si dhe ecursisë së tij gjatë vitit 2024:

Me anë të shkresës nr. 4948 prot., datë 9.8.2022, OST-ja ka dërguar në ERE për shqyrtim raportin përmbledhës të Programit të ri dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit për periudhën 2026–2036. Pjesa e mbetur e investimeve do të përfshihen në planin e ri dhjetëvjeçar si vazhdim i planit aktual 2015–2025 dhe të objektivave/strategjive të reja në sektorin e energjisë elektrike duke reflektuar përgjigjen ndaj sfidave të reja për zhvillimin e qëndrueshëm dhe optimal të rrjetit të transmetimit në vend.

Në këtë kuadër, në datën 21.2.2023 në ERE është realizuar një seancë dëgjimore me përfaqësues të OST sh.a. për paraqitjen e vlerësimeve mbi këtë plan.

Me anë të shkresës nr. 502/4 prot., datë 16.3.2023 ERE ka paraqitur disa rekomandime që duhen plotësuar nga OST, ku përmendim: i. saktësimi i periudhës së parashikuar të komisionimit të investimeve për periudhën 10-vjeçare: 1.1.2026–1.1.2036; dhe ii. evidentimi se cilat investime të përfshira në planin aktual 10-vjeçar 2015–2025, do të përfshihen në planin e ri 2026–2036, duke dhënë dhe argumentet përkatëse.

4.1.2 Investimet në rrjetin e transmetimit

Investimet në rrjetin e transmetimit ndahen në 2 grupe kryesore:

1. Investime me financime nga institucione financiare ndërkombëtare;

2. Investime me fondet e OST-së.

1. Sa u përket investimeve me financime nga institucionet financiare ndërkombëtare:

Nuk ka projekte të reja të filluara në vitin 2024.

² Informacion i marrë nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim të Rrjetit të Transmetimit



Sa i përket ecurisë së projekteve në proces implementimi, statusi i tyre rezulton si vijon:³

Ndërtimi i linjës së interkoneksionit 400 kV Elbasan2 (Shqipëri) – Bitola (Maqedoni e Veriut) dhe Elbasan 2 – Fier, si dhe zgjerimi i nënstacioneve Elbasan 2 dhe Fier:

- Kontrata e lotit 1 është lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe kontraktorit “JV Mitas Energy and Metal Construction Inc-DOKO sh.p.k” (Turqi & Shqipëri):

Ecuria gjatë vitit 2024

Kontraktori fillimisht ka kryer punimet në segmentin e linjës ajrore Fier–Elbasan, duke kryer punimet civile që lidhen me rrugët hyrëse dhe punime të tjera për ndërtimin e themeleve të shtyllave. Punimet e ngritjes së shtyllave janë realizuar në masën 89% të shtyllave të planifikuara për këtë segment.

Gjithashtu, vazhdojnë punimet për segmentin e linjës ajrore Elbasan–Qafëthhanë sa u takon punimeve civile që lidhen me rrugët hyrëse dhe punime të tjera për ndërtimin e themeleve të shtyllave. Ndërsa punimet e ngritjes së shtyllave janë në masën 53% të shtyllave të planifikuara për këtë segment.

- Kontrata e lotit 2 është lidhur midis OST sh.a. dhe Kontraktorit “Mytilineos S.A.” – Greqi:

Për nënstacionin Elbasan 3 kanë nisur punimet civile, në lidhje me rrugët e kalimit (punime civile për bazamentin e portalit të linjës 400 kV (vendosje hekuri, betonim, punime germim dheu, punime mbushje).

Ndërsa për nënstacionin Fier kanë nisur punimet civile për murin mbajtës, portatin, germime për rrugët e brendshme etj.

Data e përfundimit të projektit për të dyja lotet është dhjetor 2025.

Projekti “Programi i eficiencës së Energjisë të Sektorit të Transmetimit” – Ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tiranë – Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës”:

- Kontrata e loteve 1 me 2 seksione, është lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe kontraktorit “EFACEC Engenharia e Sistemas S.A.” – Portugali.

- Kontrata e lotit 2, me 2 seksione, është lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe kontraktorit

“ENERGOINVEST, d.d-Sarajevo” – Bosnjë dhe Hercegovina.

Si rezultat i vonësve të konsiderueshme në implementimin e projektit dhe kërkesave të përsëritura nga kontraktorët për kohë dhe/ose kosto shtesë (si rezultat i Forcës Madhore: pandemi, lufta Rusi–Ukrainë), palët pjesë e projektit si enti financues KfW, Konsulentit Fichtner dhe OST kanë organizuar disa mbledhje menaxheriale për të diskutuar dhe vendosur ecurinë e projektit, duke vendosur:

Për lotin 1: OST-ja ka nënshkruar amendimin nr. 3, datë 21.12.2023 me kontraktorin EFACEC me kohëzgjatje mars 2024–gusht 2025 për implementimin e këtij projekti.

Për lotin 2: është amenduar kontrata e zbatimit për shtyrje të afatit kontraktual të përfundimit deri në korrik 2024 dhe kontraktori është duke vijuar me punimet civile dhe montim shtyllash sipas grafikut kohor – pjesë e Amendimit OST&Energoinvest.

Sa i përket ecurisë gjatë vitit 2024

Loti 1

Për seksionin 1: Punimet e parashikuara në nënstacionin e Rrashbullit pothuajse kanë përfunduar, tashmë të dy autotransformatorët janë kolauduar dhe vënë në operim. Me marrjen e njoftimit nga kontraktori për përfundimin e të gjithë punimeve të parashikuara sipas objektit të kontratës, respektivisht për të dyja nënstacionet Rrashbull dhe Tiranë 2, do të vijohet me procesin e kolaudimit dhe lëshimin e certifikimeve të marrjes në dorëzim për të dyja nënstacionet.

Për seksionin 2: Për këtë seksion kontraktori është duke vijuar punimet.

Loti 2:

Për seksionin 1 – Punimet janë duke vijuar dhe parashikohen të përfundojnë në fund të muajit prill 2025, kohë në të cilën do të bëhet energjizimi i linjës.

Për seksionin 2 – Për këtë seksion kontraktori është duke vijuar punimet.

2. Sa u përket investimeve kryesore në rrjetin e OST me fondet e saj, në tabelën më poshtë paraqiten investimet e filluara gjatë vitit 2024 dhe përditësimi i statusit të atyre të filluara në vitet e mëparshme:

³ Informacion i marrë nga Drejtoria e Projekteve të Huaja/Sektorit i Projekteve PIU.



Nr.	Objekti i kontratës	Data e lidhjes së kontratës	Statusi	Realizimi (%)
1	Ndërtimi i linjës së re me dy qarqe 110 kV Burrel - Bulqizë dhe rehabilitimi i nënstacioneve 110 kV, Burrel dhe Bulqizë	2.9.2020	Proces	76%
2	Rikonstruksioni i linjës 110 kV Librazhd-Përrenjas	12.1.2021	Përfunduar	100%
3	Ndërtimi i linjës 110 kV dopio qark nënstacioni Elbasan – nënstacioni Fibër	18.1.2021	Proces	83%
4	Ndërtimi i linjës së re 110 kV, dopio qark, Elbasan – Cërrik	15.2.2021	Proces	60%
5	Ndërtimi i linjës së re 110 kV, me një qark, Lushnjë – Fier	25.2.2021	Proces	95%
6	Upgrade, mirëmbajtje dhe trajnim për sistemin qendror SCADA/EMS	19.4.2021	Proces	80%
7	Zgjerimi i kapaciteteve transportuese në pajisjet MPLS (Dizenjimi upgrade dhe konfigurimi i rrjetit)	5.1.2023	Proces	100%
8	Zhvendosja e linjës 6 kV të fiderit “Tharëse” që del nga N/ST 35/6 kV Fieri 1	18.1.2023	Përfunduar	100%
9	Punime për demontimin e tubacioneve nëntokësore të linjave të gazit që kalojnë në territorin ku do ndërtohet nënstacioni 400/220 kV Fier	25.1.2023	Përfunduar	100%
10	Platforma për menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe eventeve dhe mbrojtja perimetrale	26.1.2023	Përfunduar	100%
11	Rikonstruksion i disa shtyllave të linjës L.110-40 Fier-Selenicë	31.1.2023	Përfunduar	100%
12	Ndërtimi i linjës së re 220 kV dopio qark Fier–Hoxharë, si dhe ndërtimi i nënstacionit të ri 220/110/20 kV Hoxharë, bashkë me dy dalje linje 220 kV	7.2.2023	Proces	97%
13	Furnizim, vendosje e qarkut të dytë të linjës 220 kV Babicë – TEC Fier	7.2.2023	Proces	38%
14	Punime civile për rikonstruksionin e NStacionit 110 kV Guri i Kuq, si dhe nënstacionit 110 kV Kukës	13.2.2023	Përfunduar	100%
15	Zhvillimi i skemës dhe rikonstruksioni i nënstacionit 220/110/35/20 kV Sharrë	16.2.2023	Proces	27%
16	Blerje mjete teknologjike për mirëmbajtjen e linjave dhe nënstacioneve	14.6.2023	Përfunduar	100%
17	Riparimi i linjës kabllore 110 kV N/St. Kombinat – N/St. Selitë	3.7.2023	Përfunduar	100%
18	Plotësimi i skemës primare të Nënstacionit Golem	18.8.2023	Përfunduar	100%
19	Rikonstruksion i shtyllave metalike të linjave të tensionit të lartë 400 kV	24.8.2023	Proces	68%
20	Spostimi i dy linjave kabllore 35 kV, të cilat ndodhen brenda territorit të nënstacionit të ri 220/110/20 kV Hoxharë	24.8.2023	Përfunduar	100%
21	Rehabilitimi i sistemit kontrollues të matjes së energjisë elektrike i OST sh.a.	13.10.2023	Përfunduar	100%
22	Shtim trakti tretë në nënstacionin Kombinat	23.10.2023	Proces	27%
23	Riparimi i linjës kabllore 110 kV NSt. Kombinat – NSt. Selitë, faza e dytë	10.11.2023	Përfunduar	100%
24	Zgjerim i infrastrukturës së rrjetit informatik ekzistues dhe komunikimi me ENTSO-E	10.11.2023	Përfunduar	100%
25	Rikonstruksion i segmentit të parë të linjës 110 kV Ballsh - Memaliaj	16.11.2023	Proces	20%
26	Upgrade Hardware-Software i sistemit të kontrollit të nënstacionit 220 kV Burrel	16.11.2023	Përfunduar	100%
27	Upgrade Hardware-Software i sistemit të kontrollit të nënstacionit 220 kV Elbasan 1	20.11.2023	Përfunduar	100%
28	Upgrade Hardware-Software i sistemit të kontrollit të nënstacionit 220 kV Tirana 1	20.11.2023	Përfunduar	100%
29	Upgrade Hardware-Software i sistemit të kontrollit të nënstacionit 220 kV Babicë	20.11.2023	Përfunduar	100%
41	Rikonstruksion i segmentit të parë të linjës 110 kV Ballsh – Marinëz dhe i linjës Ballsh–Drenovë	23.11.2023	Proces	65%
42	Zgjerimi i sistemit të monitorimit OPGW në linjat 400 kV, 220 kV dhe 110 kV	18.12.2023	Përfunduar	100%
43	Spostimi i linjave që preken nga gjurma e aksit rrugor Thumanë–Vorë–Kashar dhe instalimi i shtyllave të demontuara në linjën Fier - Rrashbull	12.1.2024	Proces	2%
44	Përmirësimi i infrastrukturës së Telekomunikacionit të N/ST-ve kryesore (Bateri, ODF, Kondicioner, pajisje etj.)	16.1.2024	Përfunduar	100%
45	Ndërtim i linjës së re 110 kV Gjiri i Lalëzit – Fushë Kuqe	14.2.2024	Proces	20%



4.1.2.1 Përdorimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i rrjetit të fibrave optike (OPGW) si pjesë e rrjetit të transmetimit, për qëllime komerciale

Sistemi i transmetimit të OST ka në përbërje të tij fibër optike (OPGW). Përdorimi i kësaj teknologjie në zhvillimin e sistemit të transmetimit është bërë sipas standardeve dhe rekomandimeve ndërkombëtare me dy qëllime kryesore:

- Të shërbejë për të bërë mbrojtjen e rrjetit të transmetimit ndaj shkarkesave atmosferike;
- Të mundësojë rrugë transporti dhe komunikimi të sigurt dhe të mjaftueshme për vetë OST.

Ky rrjet i fibrave optike (OPGW), është përdorur vetëm për nevojat të OST si më lart përmendur, por, performanca shumë e mirë e bën atë të aftë të ofrojë shërbime komunikimi edhe për operatorët tjerë potencialë të informacionit, në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Ofrimi nga OST, i rrjetit apo shërbimeve të komunikimeve elektronike, nuk rrezikon sigurinë e funksionimit të rrjetit aktual të transmetimit pasi rrjeti i ri është konceptuar i veçantë për *routine private/switching*⁴, ku në çdo rast privatësia është e integruar me arkitekturën e sistemit sipas protokollit.

Ky aktivitet është planifikuar të shtrihet fillimisht, vetëm në pjesë të caktuara të shtrirjes së infrastrukturës dhe/ose me sasi të limituar të kapaciteteve brenda vendit. Të ardhurat që do të krijohen nga ky aktivitet do të shërbejnë për zhvillimin e mëtejshëm të rrjetit të komunikimeve elektronike, për të cilat është krijuar një llogari financiare të ardhurash më vete sipas kërkesave të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (neni 23) dhe ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” (neni 35).

Në mbështetje të pikës 4, nenit 55 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, OST i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 5005 prot., datë 24.7.2019, për dhënie opinionit lidhur me përdorimin e infrastrukturës së fibrës optike.

Në përgjigje të saj, ERE me shkresën nr 490/5 prot., datë 3.12.2019, ka përcjellë vendimin me nr. 194, datë 3.12.2019, “Mbi opinionin e ERE-s për kërkesën e OST për dhënie në përdorimin të një pjese të infrastrukturës së fibrës optike”, në të cilin Bordi është shkrehur për një opinion pozitiv për

dhënie të infrastrukturës së fibrës optike për palët e treta, duke pasur në konsideratë si vijon:

- Moscenimin e veprimtarisë së OST lidhur me sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjetik përfshirë sigurinë kibernetike;
- Kostot për realizimin e këtij aktiviteti të mbulohen nga të ardhurat e realizuara nga kjo duke mos ndikuar në tarifën e transmetimit të energjisë elektrike, si dhe në kostot e lidhura me këtë shërbim ndaj klientëve fundorë;
- Përcjelljen në ERE të studimit të fizibilitetit përfshirë planin e biznesit përfundimtar.

MFE (sot MEKI) në cilësinë e aksionarit të vetëm, me vendim nr. 119, datë 6.12.2019, ka miratuar ndryshimet në statutin e OST, duke shtuar në objektin e saj të veprimtarisë: “Zhvillimi dhe funksionimi e shërbimeve të komunikimeve elektronike me shumicë të parashikuara në legjislacionin në fuqi për shërbimet e komunikimeve elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe në përputhje me përcaktimet e autorizimeve që jepen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ku përfshihen: “*Shërbim për ofrimin e transmetimit të të dhënave, të disponueshme për publikun.*”

Për të garantuar ecurinë e këtij projekti të rëndësishëm, OST-ja ka bërë pjesë të strukturës organizative Drejtorinë e Shërbimeve të Telekomunikacionit, e cila më parë ka qenë e organizuar si sektor.

Për ofrimin e këtij shërbimi nga OST, janë marrë miratimet e nevojshme, si më poshtë:

- OST-ja është pajisur me autorizimin e përgjithshëm nga AKEP-i sipas Certifikatës së Konfirmimit të Njoftimit nr. 2020_AP-001051/datë 3.3.2020;

- Me vendimin të Këshillit Mbikëqyrës të OST dhe MF, janë miratuar çmimet e shërbimeve kombëtare që OST-ja do të ofrojë, në fushën e komunikimeve elektronike.

- OST-ja ka krijuar një llogari financiare të ardhurash më vete, sipas kërkesave të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 23, për ndarjen e llogarive.

Me vendim nr. 5, datë 20.4.2023, të Këshillit Mbikëqyrës të OST-së dhe me vendimin nr. 31, datë

⁴ Material i siguruar nga Drejtoria e Shërbimeve të Telekomunikacionit.



2.6.2023, të Asamblesë së Aksionarit të OST sh.a., janë miratuar çmimet e reja të shërbimeve që ofron OST në fushën e komunikimeve elektronike, të cilat janë reflektuar dhe në kontratat e lidhura në vijim.

Sa i përket ecurisë gjatë vitit 2024

Në muajin korrik 2024, në zbatim të vendimit të ERE-s nr. 194, datë 3.12.2019, OST-ja ka informuar ERE-n mbi ecurinë e dhënies në përdorim të një pjese të infrastrukturës së fibrës optike, me anë të shkresës nr. 4210 prot., datë 31.7.2024.

Në vijim të shkresës nr. 861/2 prot., datë 9.10.2024 të ERE, ku ndër të tjera, është lënë si rekomandim për ZP-në, që: *“në kuadër të garantimit të pavarësisë financiare të OST sh.a. të kërkojë nga OST sh.a. për të përfshirë një analizë më të plotë të zbatimit të vendimit të ERE-s nr. 194, datë 3.12.2019, ku të evidentohet mënyra e përdorimit të të ardhurave të gjeneruara nga përdorimi i infrastrukturës së fibrës optike nga palët e treta”*, u është kërkuar drejtorive përkatëse, kryerja e një analize të tillë, e cila i është vënë në dispozicion Zyrtarit të Pajtueshmërisë.

Përgjatë vitit 2024, OST-ja ka kontrata të lidhura për ofrimin e shërbimit “LAN 2 LAN” me 6 subjekte, të tilla si: KESH sh.a., Kurum, shoqërinë Voltalia Albanie sh.p.k., OPTIXCOM sh.p.k., Abissnet, dhe ATU.

Aktualisht, OST-ja ka ende kapacitete të lira për t’u shfrytëzuar, të cilat do të vazhdojnë të jepen me qira nga OST, në funksion të planit të biznesit të krijuar për këtë qëllim.

Në lidhje me masat e marra mbi sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjetik, përfshirë sigurinë kibernetike, në çdo rast të vënies në dispozicion të kapaciteteve transmetuese të rrjetit të të dhënave me fibër optike për të tretët, zhvillimi i një kuadri dhe mekanizmash për të parandaluar dhe për të reaguar ndaj sulmeve kibernetike, ka qenë një nga detyrat kryesore të Drejtorisë së Shërbimeve të Telekomunikacionit, e mbështetur nga sektori për sigurinë kibernetike në OST.

Ndër masat e konsideruara, përmendim si vijon:

- Zbatimi rigoroz i rregullave të menaxhimit të aksesit bazuar në nevojën për të hyrë në sistem;
- Minimizimi i aksesit fizik në komponentët kritikë për OST-në;
- Vendosja e nivelit shtesë aksesit për elementet thelbësore të rrjetit;
- Mbyllja e shërbimeve dhe protokolleve të papërdorura;

- Përditësimi i versionit më të fundit në elementet të rrjetit, bazuar në rekomandimin e prodhuesit;

- Vendosja e regjistrimit të sinjalizimeve në mënyrë që regjistrat të jenë të sigurt;

- Ndërtimi i sistemeve të menaxhimit dhe monitorimit për rrjetin TLC;

- Zbatimi i Procedurave për menaxhimin e incidenteve, duke përfshirë llojin e incidentit, objektivat, rolin dhe përgjegjësitë dhe përshkallëzimi sipas niveleve organizative në OST, bazuar në politikën (POL-INFOSEC-001 Politika për sigurinë e sistemeve informatike të OST v2 0);

- Vendosja e sistemeve të aksesit kontrollit dhe sistemit të survejimit me kamera në ambientet teknologjike, ku ndodhen pajisjet e SCADA apo sistemi Mini SCADA, bazuar në politikën (POL-INFOSEC-005 Politika e sigurisë së dhomës së serverave);

- Krijimin e ekipit përgjegjës ndaj incidenteve të sigurisë kompjuterike (CSIRT) dhe vënien në dijeni e autoritetit (AKCESK) për çdo incident nga marrja e këtij raporti. Ekipi CSIRT është pjesë e strukturës së Departamentit të Operimit të Sistemit (SCADA).

- Përdorimi i mekanizmave të veçanta të autentikimit dhe kredenciale për përdoruesit e rrjetit në sistemet industriale dhe rrjetit të korporatës, bazuar në ISO 27001 *Information Security Management System*.

Gjatë vitit 2024 nuk është shënuar asnjë incident ose prishje e Indikatorëve kyç të performancës (KPI) për shërbimet e brendshme të sistemit energjetik, pavarësisht ngarkesës së lartë të sulmeve kibernetike në portalet qeveritare dhe institucionet e tjera.

4.1.3 Aksesit i palëve të treta në sistemin e transmetimit

OST duhet të sigurojë akses të barabartë në sistemin e transmetimit për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit, në përputhje me kërkesat e vendosura të ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aktet e tjera ligjore në fuqi, si dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit. Në këtë mënyrë realizohet pajtueshmëria me një ndër shtyllat kryesore të Programit të Pajtueshmërisë, që është pikërisht shmangia e sjelljeve diskriminuese.

Për të parë respektimin e këtij detyrimi nga OST-ja, janë monitoruar procedurat e aplikimit për lidhje të reja në rrjetin e transmetimit.

Për sa u takon procedurave për lidhje të reja në rrjetin e transmetimit, si dhe statusit të këtyre



aplikimeve për periudhën janar–dhjetor 2024, ka pasur një sërë aplikimesh për mundësinë e lidhjes së centraleve prodhuese të energjisë elektrike në zona të ndryshme të sistemit elektroenergetik, të paraqitura në tabelën si vijon⁵:

- Centrale të tipit “Gjenerues Hidrik”, 4 aplikime, fuqia totale e kërkuar 46 mw, realizuar 3 marrëveshje lidhjeje;

- Centrale të tipit “Gjenerues Solar”, 69 aplikime, fuqia totale e kërkuar 3793.97 mwp, realizuar 4 marrëveshje lidhjeje;

- Centrale të tipit “Gjenerues Eolik”, 23 aplikime, fuqia totale e kërkuar 2618.4 mw, nuk është realizuar asnjë marrëveshje lidhjeje;

Të gjitha aplikimet për këtë kategori kanë qenë për ndërtimin e tyre në tokë;

- Centrale të tipit “Gjenerues Termik” nuk ka pasur aplikime dhe nuk është realizuar asnjë marrëveshje lidhjeje.

- Centrale të tipit “Gjenerues Hidrik me sistem rezerve pompimi” 1 aplikim, fuqia totale e kërkuar 1620 mw, nuk është realizuar asnjë marrëveshje lidhjeje.

Për periudhën janar–dhjetor 2024 janë vënë në operim tri burime gjeneruese, të tipit solar të lidhur në rrjetin e transmetimit me tension 110 kV dhe janë nënshkruar marrëveshje lidhjeje në sistemin e transmetimit 15 centrale.

Sa i përket trajtimit të kërkesave brenda afateve të parashikuara në “Rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, marrëveshjes së operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST dhe përdoruesit, si dhe marrëveshjes së lidhjes në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a dhe përdoruesit”, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018, nga informacioni i vënë në dispozicion, rezulton, se:

Në rastet e kërkesave për lidhje që janë trajtuar sipas VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar me VKM-në nr. 718, datë 12.10.2016, OST-ja është shprehur nëpërmjet një opinionioni paraprak sikundër parashikon pika 2.a e nenit 10 të VKM-së.

Gjithashtu, janë trajtuar dhe kërkesat për lidhje me rrjetin e transmetimit, të centraleve eolike në kuadër të procedurës konkurruese për përzgjedhjen e projekteve, për “*Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e disa impianteve fotovoltaike, secili me një kapacitet të instaluar ndërmjet 10 mw dhe 100 mw (përfshirë), të cilët do të përfitojnë nga masat mbështetëse, me vendndodhje të zgjedhur nga ofertuesi në Republikën e Shqipërisë*”, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të finalizuar në muajin korrik 2024 si vijon:

- Shoqëria Voltalia s.a. ka marrë miratimin në parim për lidhjen me rrjetin e transmetimit të Centralit Eolik South Wind Park, me fuqi të instaluar 75 mw.

- Konsortiumi Guris Insaat Ve MUhendislik A.S, “Morgan Energji Yatırım Holding A.S” dhe “Brd Energy” sh.p.k ka marrë rimiratimin në parim për lidhjen me rrjetin e transmetimit të Parkut Eolik Kryevidh, me fuqi të instaluar 74.4 mw.

- Shoqëria Verbund Green Power Albania SH.P.K. ka marrë rimiratimin në parim për lidhjen me rrjetin e transmetimit të Parkut Eolik Kryevidh, me fuqi të instaluar 72.6 mw.

Tarifat e lidhjes në rrjetin e transmetimit janë tarifa fikse siç përcaktohen në “Rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit” e miratuar nga Bordi i ERE-s, ku përfshihet edhe metodologjia e llogaritjes së kostove dhe marrëveshja standarde e lidhjes, të cilat janë transparente dhe eficiente për të siguruar lidhjen në mënyrë jodiskriminuese të çdo përdoruesi në rrjetin e transmetimit.

4.1.4 Pajtueshmëria e përdoruesve të rrjetit me Kodin e Transmetimit

Në zbatim të rekomandimeve të ERE-s lënë për Zyrтарin e Pajtueshmërisë, përcjellë me shkresën nr. 861/2 prot., datë 9.10.2024, në këtë kapitull do të trajtohet pajtueshmëria e përdoruesve me Kodin e Transmetimit, në kuadër të transparencës dhe trajtimit jodiskriminues të përdoruesve të rrjetit të transmetimit.

Kodi i Transmetimit, miratuar me vendim të ERE-s nr. 63, datë 11.4.2022, përcakton në mënyrë të hollësishme normat që shërbejnë për të siguruar mbarëvajtjen e operimit dhe zhvillimit të sistemit të

⁵ Informacion i marrë nga Drejtoria e Planifikim Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit.



transmetimit, si dhe përcakton kushtet e shërbimit që ofrohen nga OST ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit. Të drejtat dhe detyrimet reciproke për OST dhe përdoruesit, përcaktohen në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, Kodin e Transmetimit, marrëveshjet dyshumëpalëshe, si dhe vendimet e rregulloret e tjera të miratuara nga Bordi i ERE-s.

Kodi i Transmetimit parashikon metodat dhe kriteret për planifikimin dhe zhvillimin e sistemit, kushtet dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin për akses në sistemin e transmetimit, si dhe detajon specifikimet minimale teknike dhe funksionale për dhënien e aksesit dhe lidhjen me sistemin e transmetimit të centraleve prodhuese, tek Operatorit të Shpërndarjes dhe të konsumatorëve të rëndësishëm.

Në zbatim të dispozitave të Kodit të Transmetimit, neni 6, pika 3, OST-ja monitoron zbatimin e Kodit të Transmetimit nëpërmjet kryerjes së inspektimeve, testimit të sistemeve dhe proceseve apo mbledhjes së informacionit të nevojshëm nga përdoruesit e sistemit të transmetimit, për të mbikëqyrur zbatimin e Kodit të Transmetimit nga këta përdorues.

Në çdo rast papajtueshmërie, OST-ja njofton përdoruesin dhe informon ERE-n, për:

- a) papajtueshmërisë së konstatuar;
- b) informacionin/shpjegimin e përdoruesit në lidhje me papajtueshmërinë e konstatuar (nëse ka);
- c) afatet kohore të nevojshme për zbatimin e detyrimeve nga përdoruesi, të domosdoshme për të zgjidhur situatën e papajtueshmërisë me dispozitat e kodit.

Gjatë monitorimeve *on-site*, OST-ja vlerëson kërkesat të cilat lidhen kryesisht me operimin në kohë reale të sistemit, kërkesa të cilat janë të lidhura ngushtësisht me zbatimin e kërkesave në pikën e lidhjes.

Sipas informacionit të marrë pranë Sektorit të Zbatimit të Kodeve/Drejtoria e Drejtimit Operativ të Sistemit, gjatë vitit 2024, janë monitoruar kategoritë e përdoruesve të rrjetit si vijon:

- i. Gjeneruesit (HEC), gjithsej 17 subjekte të monitoruara;
- ii. Konsumatorët e lidhur në rrjetin e transmetimit, gjithsej 4 subjekte të monitoruara;
- iii. Përdorues të lidhur në rrjetin e OSSH-së me tri kategori të ndryshme (PV + Konsumator + HEC), gjithsej 6 subjekte të monitoruara.

Gjatë monitorimeve mbi zbatimin e kërkesave të Kodit, janë hasur disa problematika që kanë ndikuar në përmbushjen e kërkesave dhe standardeve të përcaktuara. Këto sfida lidhen me aspekte të ndryshme teknike dhe organizative, të cilat kërkojnë një përpjekje të koordinuar për t’u adresuar dhe përmirësuar. Disa nga papajtueshmëritë e konstatuara kane të bëjnë me:

- Mosrespektimin e afateve të raportimit nga disa përdorues;
- Ndryshimet në kërkesat teknike dhe infrastrukture;
- Mungesa e përgatitjes teknike në raste të caktuara.

Nëpërmjet monitorimeve, OST sh.a. ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme aktivitetin dhe performancën e përdoruesve të rrjetit të transmetimit, duke monitoruar, komunikuar dhe udhëzuar sipas rastit, me qëllim rritjen e sigurtisë operacionale, evitimin e ngjarjeve shqetësuese në sistem dhe përmirësimin e funksionimit të të gjithë sistemit elektroenergetik. Komunikimi me përdoruesit ka qenë i vazhdueshëm dhe në çdo rast prej tyre është kërkuar që planifikimi dhe operimi i aseteve të tyre të bëhet bazuar në zbatim të dispozitave të Kodit të Transmetimit. Në asnjë rast përdoruesit nuk na janë shprehur se nuk do t’i përmbushin detyrimet që përcakton Kodi i Transmetimit; madje ata kanë shprehur angazhim se do t’i përmbushin detyrimet.

OST sh.a. është përpjekur që papajtueshmëritë t’i zgjidhë nëpërmjet komunikimit dhe si rrjedhojë ka vijuar me procedurën e takimeve në ambientet e OST sh.a., me përfaqësues të lartë të përdoruesve, duke i parashtruar qartë kërkesat, detyrimet e Kodit të Transmetimit dhe si rrjedhojë penalizimet nëse këto kërkesa nuk përmbushen.

Për çdo papajtueshmëri të konstatuar gjatë monitorimeve të realizuara gjatë vitit 2024, OST-ja ka komunikuar me përdoruesit nëpërmjet shkresave zyrtare, ku për dijeni është vënë, gjithashtu, edhe Enti Rregullator i Energjisë.

Në vijim të monitorimeve të realizuara dhe komunikimeve intensive me përdoruesit, vihen re një ndërgjegjësim në disa përdorues, të cilët për kohë të gjatë nuk kishin marrë asnjë masë në përmbushjen e kërkesave, qoftë në aspektin teknik, siç është realizimi i lidhjes me rrjetin e telekomunikacionit apo SCADA, shkëmbimi i të dhënave gjatë



planifikimit-zhvillimit, dispeçerimit apo edhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Lidhjes.

Përmirësime janë konstatuar në shkëmbimin e të dhënave

Marrja e të dhënave të duhura bazuar në parashikimin e gjenerimit dhe ngarkesave (duhet vlerësuar se tashmë më shumë se 70% e përdoruesve e përcjellin planin afatgjatë dhe afatshkurtër sa herë që OST e ka kërkuar), duke bërë të mundur saktësinë e parashikimeve që OST-ja bën në analizat e sigurisë.

Marrja e informacionit në kohë reale

Si rezultat i komunikimeve të deritanishme ndërmjet përdoruesve dhe OST-së, është arritur që shumica e përdoruesve të përcjellin të dhëna në kohë reale në OST.

Nënshkrimi i marrëveshjes së lidhjes

Si rezultat i masave të marra në vijim të monitorimeve të realizuara dhe komunikimeve intensive me përdoruesit, ka pasur rezultat edhe në vijimin e procesit të nënshkrimit të marrëveshjeve të lidhjes me përdorues, të cilët, për arsye të ndryshme, procesi kishte mbetur pezull. Në marrëveshjet e lidhjes, përdoruesit kanë marrë përsipër të zbatojnë të gjitha detyrimet që lindin nga Kodi i Transmetimit dhe Kodi i Lidhjes, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, zbatimin e menjëhershëm të urdhrave të Qendrës Dispeçer, si dhe menaxhimin e nënstacioneve të tyre me personelin e vet, i cili duhet të ketë kualifikimin e përshtatshëm, në respekt të plotë të Kodit të Transmetimit

Si konkluzion, nga ana e OST-së janë ndërmarrë hapat dhe procedurat e kërkuara nga Kodi i Transmetimit, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit dhe pajtueshmërinë me kërkesat e Kodit. Në çdo rast të konstatimit të papajtueshmërisë, është bërë njoftimi i përdoruesve të rrjetit dhe Entit Rregullator të Energjisë, si dhe është kërkuar marrja e masave të duhura për përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nëpërmjet marrëveshjes së lidhjes dhe Kodit të Transmetimit. Si rezultat i këtyre monitorimeve, është arritur përmirësimi i kushteve dhe përmbushja e detyrimeve nga një numër i madh i përdoruesve të rrjetit, sikurse janë masat e përshkruara me lart.⁶

4.1.5 Tregu Balancues i Energjisë Elektrike

Nga data 1 prill 2021, bazuar në Rregullat e Tregut të Balancimit miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, OST-ja operon Tregun Shqiptar të Balancimit në të cilin organizohen procedurat respektive për sigurimin e kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese me qëllim balancimin e sistemit. Në përmbushje të këtij detyrimi, OST-ja bën evidentimin e aktivizimeve, disbalancave dhe menaxhimin kontraktual e financiar të tyre me palët përgjegjëse për disbalancat dhe me ofruesit përkatës të shërbimeve të balancimit.

Tregu shqiptar i balancimit ka mundësuar kalimin përfundimtar nga një mekanizëm i rregulluar me entitete publike në një liberalizim të tregut të energjisë balancuese, ku çdo palë ofruese e shërbimeve të balancimit mund të marrë pjesë dhe të bëhet konkurrese me produktet e saj për shërbimet e balancimit.

4.1.5.1 Pjesëmarrësit e tregut të energjisë

Në përmbushje të detyrimit për akses të barabartë në sistem, OST-ja kryen dhe ndjek procesin e regjistrimit të të gjithë pjesëmarrësve të tregut në bazë të Rregullores për regjistrim në tregun shqiptar të energjisë elektrike (miratuar me vendim të ERE nr. 160, datë 12.10.2017).

Pjesëmarrësit e tregut kanë nënshkruar me OST kontratën për shërbimin e transmetimit (kontratë tip) miratuar nga ERE me vendim nr. 23 datë 15.2.2017, ndryshuar me vendim nr. 99 datë 4.7.2017, me një tarifë të përcaktuar për vitin 2024, të miratuar nga ERE me vendim nr. 72, datë 13.4.2022, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022–2024”.

Të dhëna e lartpërmendura janë të publikuara edhe në *website*-in zyrtar të OST-së. Kjo marrëveshje siguron shërbimin e transmetimit për pjesëmarrësit të tregut në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin e përcaktuar në Programin e Pajtueshmërisë.

Nga data 12 prill 2023, në vijim të zhvillimeve në sektorin elektroenergjetik, pas miratimit nga ERE të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e ALPEX-it, përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes)

⁶ Për më tepër, shih raportin e përcjellë ERE-s me anë të shkresës nr. 654 prot., datë 27.1.2025.



me vendimin nr. 347, datë 27.12.2022, nga OST është bërë njoftimi për pjesëmarrësit e tregut të energjisë, duke sqaruar se:

i. në përputhje me parashikimet e vendimit të ERE-s nr. 126, datë 17.5.2021, “Mbi miratimin e rregullores “Për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (Remit)”, çdo pjesëmarrës tregu apo aplikues i ri duhet të regjistrohet pranë Entit Rregullator të Energjisë në regjistrin e REMIT;

ii. Për t'u regjistruar si “Palë përgjegjëse balancuese” çdo palë e interesuar duhet të plotësojë formularët e publikuar në faqen zyrtare të OST sh.a., me plotësimin e të cilëve do të vijohet me

nënshkrimin e Marrëveshjes për Palën Përgjegjëse Balancuese për regjistrim në Tregun Shqiptar të Balancimit.

Gjithë dokumentacioni dhe informacioni i nevojshëm për palët është i publikuar në faqen zyrtare të OST-së në rubrikën “Tregu i Shqiptar i Balancimit”.

Në vijim të këtij procesi, lista e subjekteve të regjistruar në Tregun Balancues të Energjisë Elektrike si Palë, grup përgjegjës për balancim apo ofrues i shërbimit të balancimit për vitin 2024, paraqitet më poshtë:

Regjistri i ofruesve të Shërbimit të Balancimit të Tregut Shqiptar të Balancimit:

Nr.	Kodi	Kompania
1.	PPB-001	GSA sh.p.k
2.	PPB-003	ReNRGY Trading Group sh.p.k.
3.	PPB-005	GEN-I Tirana sh.p.k.
4.	PPB-007	Energji Ashta sh.p.k.
5.	PPB-009	Danske Commodities Albania sh.p.k.
6.	PPB-010	NOA Energy Trade sh.p.k.
7.	PPB-011	Ayen Energy Trading sh.a
8.	PPB-012	Ayen AS Energji sh.a
9.	PPB-013	EZ-5 Energy sh.p.k.
10.	PPB-014	AXPO Albania sh.a
11.	PPB-015	KESH sh.a
12.	PPB-016	Energy Financing Team Tirana sh.p.k.
13.	PPB-018	Kurum International sh.a.
14.	PPB-019	ENER TRADE sh.p.k
15.	PPB-020	FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË sh.a.
16.	PPB-021	Devoll Hydropower sh.a.
17.	PPB-023	OPERATORI I SITEMIT TË SHPËRNDARJE sh.a.
18.	PPB-027	Lengarica &Energy sh.p.k
19.	PPB-030	TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT sh.p.k.
20.	PPB-031	INFO Telecom sh.p.k.
21.	PPB-032.	DITEKO sh.p.k
22.	PPB-033	Spe Gjadër sh.p.k.
23.	PPB-034	FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL sh.a
24.	PPB-035	AlbEsp Trading & Consulting sh.p.k.
25.	PPB-037	Hec-i Bishnica1,2 sh.p.k.
26.	PPB-038	Heci Tervolit sh.p.k.
27.	PPB-039	ADA Solar SE sh.p.k.
28.	PPB-040	Lajthiza Invest sh.a
29.	PPB-041	FUTURE ENERGY TRADING AND DYNAMICS sh.p.k.
30.	PPB-042	DRAGOBIA ENERGY sh.p.k.
31.	PPB-043	Korça Photovoltaik Park sh.p.k.
32.	PPB-044	SUN BEAT SYSTEM sh.p.k.
33.	PPB-045	New Technology Solution Production (NTSP) sh.p.k.
34.	PPB-046	TREN SUN SYSTEM sh.p.k.
35.	PPB-051	ENERGY 24 sh.p.k.
36.	PPB-052	ENSCO Trading (Albania) sh.p.k.
37.	PPB-056	NATYRE ENERGY sh.p.k.
38.	PPB-057	G.S.K sh.p.k.



Nr.	Kodi	Kompania
1.	PPB-001	GSA sh.p.k
39.	PPB-058	PROINFINIT CONSULTING sh.p.k.
40.	PPB-059	SOLE 24 DOOEL Shkup-Dega në Shqipëri
41.	BRP-060	Duferco Shqipëria sh.p.k.
42.	PPB-061.	KARAVASTA SOLAR sh.p.k
43.	PPB-062	SPV BLUE 1 sh.p.k.
44.	PPB-063	PROTERGIA ENERGY ALBANIA sh.p.k.
45.	PPB-064	NOVA SOLAR SYSTEM sh.p.k.
46.	PPB-065	ALB ENERGY TRADE sh.p.k.
47.	PPB-066	Energy Commodities sh.p.k.
48.	PPB-067	MFT ENERGY KOSOVO
49.	PPB-068	5GX ENERGY sh.p.k.
50.	PPB-069	YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA sh.p.k.
51.	PPB-070	NRG Power sh.p.k.
52.	PPB-071	JUANA sh.p.k.
53.	PPB-072	GreeNNAT Solar Park Ballsh sh.p.k.
54.	PPB-073	ERSEKA SOLAR PARK 1 sh.p.k.

Regjistri i ofruesve të Shërbimit të Balancimit të Tregut Shqiptar të Balancimit:

Nr.	Kodi i regjistrimit	Kompania
1.	OSHB-001	Ayen As Energji Sh.a
2.	OSHB-002	KESH sh.a
3.	OSHB-004	Devoll Hydropower sh.a.
4.	OSHB-005	Hydropower sh.a Kurum International Sh.a

Regjistri i grupeve të Balancimit të Tregut Shqiptar të Balancimit:

Nr.	Emërtimi i Grupit të Balancimit
1	Grupi i Balancimit KESH sh.a.
2	Grupi i Balancimit GSA sh.p.k.
3	Grupi i Balancimit “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË sh.a.
4	ALB ENERGY TRADE sh.p.k.
5	GEN-I Tirana sh.p.k
6	FUTURE ENERGY TRADING AND DYNAMIC sh.p.k.
7	ENER TRADE sh.p.k.

4.1.5.2 Prokurimi i energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit

Referuar ligjit për sektorin e energjisë, rregullave të tregut, rregullave të balancimit, si dhe akteve të tjera rregullatore, OST-ja prokuron energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe për rezervën e energjisë dhe shërbimet e tjera ndihmëse, të kërkuara për operimin e sigurt të sistemit, bazuar në parimet e transparencës, mosdiskriminimit, rregullave të tregut dhe kostos minimale.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e

prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, u vendos që gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizim me energji elektrike (deri në 31 dhjetor 2022), vendosur me VKM-në nr. 584 datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike” (i ndryshuar), sasia e energjisë për mbulimin e humbjeve do të sigurohej nga shoqëria publike e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, pra KESH. Kjo shoqëri furnizon Operatorin e Sistemit të Transmetimit me të gjithë sasinë e nevojshme, për mbulimin e humbjeve, me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike, me çmimin e rregulluar të blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike, ku çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t’u



paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi do të jetë 8565.2 lekë/mwh (për periudhën 2.7.22–8.2.2023) dhe 10,000 lekë/mwh (për periudhën 9.2.23–11.4.2023). Kjo sasi energjie është siguruar në bazë të kontratës ndërmjet shoqërisë publike të prodhimit dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, me nr. prot. 4670, datë 27.7.2022, dhe e miratuar nga ERE me vendimin nr. 230, datë 12.9.2022.

Edhe për periudhën 1.1.2023–11.4.2023, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, sasitë e energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit janë siguruar nga KESH-i me çmimin e rregulluar të blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike, ku çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që u është paguar prodhuesve ekzistues me përparësi ka qenë 8565.2 lekë/mwh (për periudhën 1.1.23–8.9.2023) dhe 10,000 lekë/mwh (për periudhën 9.2.23–11.4.2023).

Prej datës 12 prill 2023 prokurimi i energjisë për mbulimin e humbjeve kryhet nëpërmjet platformës ALPEX, ku ALPEX-i do të sigurojë shlyerjen e volumit të kontraktuar në ALPEX DAM, sipas Rregullave të Tregut dhe, nëse, çmimi klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM është më i lartë se çmimi i kontratës (me KESH sh.a.), Shitësi do të kompensojë Blerësin për diferencën midis çmimit klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM dhe çmimit të kontratës.

Nga verifikimi i faqes *online* të OST-së rezulton që është pasqyruar i gjithë informacioni i duhur për procesin e prokurimit të humbjeve, si dhe rezultatet e dala nga prokurimi, duke iu përmbajtur kërkesave të përcaktuara në pikat 25 dhe 35 të Programit të Pajtuëshmërisë.

4.1.5.3 Ankandet mbi alokimin e kapaciteteve

OST-ja, si Operator i Sistemit të Transmetimit në Republikën e Shqipërisë, është i ngarkuar të përcaktojë vlerat e kapacitetit transmetues ndërkufitar dhe rakordimin e tyre me TSO-të fqinje, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ENTSO-E (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Transmetimit të Energjisë Elektrike).

Në përputhje me kërkesat e rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, “Mbi kushtet për hyrjen në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike” dhe Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Zyra Rajonale e Alokimit të Kapaciteteve “SEE CAO” realizon procedurat e ankandeve për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit në të dyja drejtimet, ndërmjet Zonave të Kontrollit të OST-ve pjesëmarrëse të Evropës Juglindore, ku OST-ja merr pjesë si bashkëpronare me vota të barabarta. Nëpërmjet ankandeve të zhvilluara në këtë zyrë, është bërë alokimi i kapaciteteve ndërkufitare në të dyja drejtimet, për kufirin AL-Greqi dhe AL-Mali i Zi, në bazë të “Rregullave të Harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkoneksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të Ankandeve të Kapacitetit të Interkoneksionit në Evropën Juglindore SEE CAO”.

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së lidhjes së KOSTT-së me ENTSO-E, Kosova njihet si zonë kontrolli e pavarur, ku në bashkëpunim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit – OST dhe bazuar në marrëveshjen për krijimin e bllokut të kontrollit Shqipëri–Kosovë, operojnë brenda këtij blloku, në përputhje me rregullat e ENTSO-E. Me njohjen e KOSTT-së si zonë kontrolli, të gjithë proceset ndërkufitare zhvillohen me kufirin OST-KOSTT.

Në vazhdimësi të këtyre hapave, KOSTT-ja ka njoftuar SEE CAO-n mbi vendimin e RGCE-së për hyrjen në fuqi të marrëveshjes së lidhjes së KOSTT-së me ENTSO-E dhe qëllimin e KOSTT-së për të firmosur marrëveshjen e shërbimeve me SEE CAO për vitin 2021.

SEE CAO ka përgatitur ndryshimet përkatëse të Rregullave të Harmonizuara të Alokimit të kapaciteteve të Interkoneksionit të SEE CAO, me qëllim aplikimin e tyre në kushtet e përfshirjes edhe të KOSTT-së si përfituese e shërbimeve të SEECAO-së.

Me vendim nr. 280, datë 1.11.2022, Bordi i ERE-s ka miratuar Rregullat e Harmonizuara të Alokimit të SEE CAO, për kufijtë Shqipëri–Greqi, Shqipëri–Mali i Zi dhe Shqipëri–Kosovë, si dhe anekset e këtij dokumenti, të cilat aplikohen nga data 1 janar 2023.

Ky proces monitorohet nga ERE, sipas përcaktimeve të rregullave të lartpërmendura. OST-ja e konkretisht Drejtoria e Shërbimeve të Tregut gjatë vitit 2024 ka dërguar informacion periodik çdo



3 muaj, në rrugë elektronike mbi procedurat e ankandëve të zhvilluara nga OST-ja.

Nga monitorimi i kryer, rezulton se në faqen zyrtare të OST-së është publikuar i gjithë informacioni mbi ankandet për alokimin e kapaciteteve sipas përcaktimeve të pikës 9 të Rregullave për alokimin e kapaciteteve.

Gjithashtu, konstatohet se ky proces i kryer nga OST-ja, u ka ofruar shërbimin të gjithë pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, me të njëjtat terma dhe kushte dhe në mënyrë jodiskriminuese.

4.1.5.4 Palët përgjegjëse për balancim

Një nga detyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike, është kryerja e balancimit të sistemit, mbështetur në parime objektive, transparente e jodiskriminuese, në përputhje me Kodin e Transmetimit dhe rregullat e tregut.

Në bazë të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, OST-ja është përgjegjëse për ruajtjen e sigurisë së sistemit dhe për prokurimin e shërbimeve balancuese nga ofruesit e shërbimeve të balancimit (OSHB) në mënyrë që të garantojë sigurinë operationale në sistem.

Krijimi i tregut të balancimit

Krijimi dhe vënia në funksionim e Tregut të Balancimit të energjisë elektrike, në kohë reale për Shqipërinë (ABM) është një hap i rëndësishëm për sektorin elektroenergjetik në vend, në përputhje me detyrimet e Shqipërisë përballë Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe Memorandumin e Mirëkuptimit – WB6 MoU (i nënshkruar midis operatorëve të sistemit të transmetimit, autoriteteve rregullatore kombëtare në fushën e energjisë, bursave të energjisë (PX) dhe ministrive përgjegjëse për energjinë të shteteve përkatëse të Ballkanit Perëndimor si pjesë e procesit “WB6” të drejtuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

ERE, me vendim nr. 106, datë, 2.7.2020, “Mbi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” ka miratuar këto rregulla, të cilat ishin të detyrueshme për t'u zbatuar nga pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike pa efekte financiare deri në datën 31.12.2020, datë e cila u shty

me vendimin e ERE-s nr. 275, datë 28.12.2020”, sipas të cilit Tregu Shqiptar i Balancimit, do të ishte funksional më datën 1 prill 2021.

Nga data 1 prill 2021, OST-ja ka implementuar tregun balancues konform rregullave të tregut shqiptar të balancimit dhe shërbimet balancuese aktualisht prokurohen me bazë tregu.

Tregu i Balancimit i lejon OST-së të përmbushë detyrimet e saj lidhur me balancimin e sistemit në kohë reale, duke siguruar shërbimet e nevojshme në kohë reale bazuar në parimet e tregut të hapur, transparent dhe jodiskriminues.

Në këtë kuadër, OST-ja kryen nëpërmjet SEE CAO:

- Ankandet e Angazhimit për Disponueshmëri për sigurimin e kapacitetit rezervë për balancimin e sistemit, si dhe për llogari të KOSTT-së, referuar marrëveshjes për ndarjen e rezervave OST-KOSTT;

- Ankandet e Angazhimit për Shpërndarje për sigurimin e energjisë balancuese për balancimin e sistemit, si dhe për llogari të KOSTT-së, referuar marrëveshjes për ndarjen e rezervave OST-KOSTT.

Mbi zbatimin e marrëveshjes për shlyerjen financiare të devijimeve ndërkuftare

Në vijim të përmbushjes së detyrimeve që OST-ja ka si palë e ENTSO-E, OST-ja si operatori në qendër të mekanizmit balancues, përgjegjës për ruajtjen e balancës së sistemit elektroenergjetik, është, gjithashtu, përgjegjës për shkëmbimin ose ndarjen e shërbimeve të balancimit me operatorët e sistemit të transmetimit të shteteve fqinj.

Në zbatim të marrëveshjes FSKAR për shlyerjen financiare të devijimeve ndërkuftare, të nënshkruar nga të gjitha TSO-të e zonës sinkrone evropiane dhe vendimit të ENTSO-E, OST-ja ka filluar implementimin e saj prej datës 1 qershor 2021, ku kompensimi i devijimeve të paqëllimshme ndërkuftare, nuk do të bëhet më tej në natyrë, por palët (TSO-të) do të kompensojnë njëra-tjetrën financiarisht.

Për sa më sipër, janë njoftuar gjithë pjesëmarrësit e tregut se duhet të deklarojnë skedulim të balancuar, duke pasur parasysh faktin që janë financiarisht përgjegjëse për disbalancat kundrejt OST, sikurse rrjedhimisht OST-ja është financiarisht përgjegjëse për devijimet në Interkoneksion kundrejt zonës sinkrone.⁷

⁷ Informacion i marrë pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Tregut.



Nga monitorimi rezulton se marrëdhënia e OST-së me palët përgjegjëse për balancim, rregullohet mbi baza transparence dhe mosdiskriminimi. Gjithë informacioni i nevojshëm mbi këtë proces është i publikuar në *website*-in e OST-së.

4.2 Konfidencialiteti i të dhënave dhe i informacionit të ndjeshëm tregtar

Referuar pikës 28 të Programit të Pajtushmërisë, OST-ja duhet të sigurojë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të siguruar nga OST-ja gjatë aktiviteteve funksionale dhe/ose komerciale dhe duhet të marrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të nevojshme për të shmangur shpërndarjen diskriminuese të informacionit të ndjeshëm tregtar, në lidhje me aktivitetet të cilat përmbajnë vlera tregtare për persona të tjerë.

Për të verifikuar përmbushjen e këtij detyrimi, është kërkuar informacion mbi sistemet e teknologjisë së informacionit që OST-ja ka në administrim, të dhënat që hidhen në këto sisteme, si dhe të dhënat që merren nga palët e treta nëpërmjet këtyre sistemeve.

4.2.1 Sistemet e teknologjisë së informacionit

Një nga funksionet kyçe të Operatorit të Sistemit të Transmetimit është të zhvillojë sistemin e transmetimit, në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me energji elektrike, si dhe të koordinojë zhvillimin e rrjetit, si brenda vendit, ashtu dhe me fqinjët. Programet dhe sistemet kompjuterike, të cilat shërbejnë për komandimin, apo monitorimin e rrjetit elektrik zënë një vend të veçantë dhe janë në fokus të vazhdueshëm për sa u përket sigurisë së tyre apo përditësimeve që nevojiten. Gjithashtu, OST-ja zotëron një rrjet të brendshëm të transmetimit të të dhënave i cili përbëhet nga kabllo OPGW të pajisur me fibra optike për lidhjet midis nënstacioneve dhe nga kabllo LAN për rrjetet lokale të njësive apo nënstacioneve të OST-së.

OST-ja ka në pronësi dhe përdor disa sisteme kompjuterike të cilët shërbejnë për menaxhimin e rrjetit energjetik brenda vendit, si dhe në linjat e Interkoneksionit. Gjithashtu, OST-ja zotëron edhe sisteme të cilat shërbejnë për shkëmbimin e informacionit me të tretët, siç janë ENTSO-E, KESH sh.a., Operatorët e ndryshme privat apo shtetëror, HEC-e apo nënstacione.

Sistemi SCADA/EMS (Qendra Kombëtare e Kontrollit)

Sistemi SCADA/EMS (Sistemi i Kontrollit dhe Grumbullimit të të Dhënave/Sistemi i Menaxhimit të Energjisë) shërben për operimin e sistemit energjetik. Ky sistem, përveçse është një zgjidhje efikase për operimin e sistemit është, gjithashtu, një sistem informatik, i cili i siguron OST-së, si vendimmarrës në lidhje me funksionimin e sistemit të transmetimit, informacione të besueshme mbi proceset, duke u mundësuar kështu operatorëve të menaxhojnë sistemin e energjisë në një mënyrë optimale. Platforma e tij e hapur dhe e gjithanshme lejon integrim të lehtë të sistemeve të tjera informative të shërbimeve duke ruajtur nivele të larta të sigurisë së IT-së. Aplikacionet e sistemit SCADA/EMS mund të përshtaten për kontroll dhe analizë në kohë reale, si dhe për qëllime optimizimi dhe planifikimi. Në Sistemin kryesor SCADA të OST-së monitorohen në kohë reale të gjitha të dhënat që operohen nga nënstacionet 220/400 kV dhe nënstacionet më të rëndësishme 110 kV. Stacioni kryesor i sistemit SCADA/EMS është instaluar në ambientet e QDK-së, OST-së. Për të garantuar nivelin më të lartë të disponueshmërisë dhe besueshmërisë, sistemi është plotësisht redundant në drejtim të infrastrukturës *Hardware* dhe *Software*.

Sistemi Emergjent i Kontrollit (ECC)

Sistemi ECC operon në konsistencë me Qendrën ekzistuese Kombëtare të Kontrollit (QDK), e implementuar në një nga nënstacionet e OST-së. Implementimi i një sistemi Emergjent Kontrolli ka ardhur si pasojë e zbatimit të direktivave të ENTSO-E mbi garantimin e vazhdueshmërisë së proceseve për OST-në, e cila duhet të ketë në dispozicion në çdo kohë dhe pa ndërprerje vëzhgueshmërinë e Rrjetit të Transmetimit edhe në rastet e dështimit të sistemit kryesor për arsye të ndryshme. Sistemi ECC punon në mënyrë të pavarur nga sistemi SCADA/EMS i QDS, por përdor të njëjtat burime të të dhënave dhe të njëjtin rrjet telekomunikacioni.

Electronic Highway

OST-ja, në zbatim të direktivave kryesore të ENTSO-E, ka implementuar edhe njëjën e komunikimit për realizimin e shërbimeve të cilat shfrytëzojnë rrjetin e Electronic Highway. OST-ja është pjesë zyrtare e Electronic Highway. Kjo njëjës ndodhet në Qendrën Kombëtare të Kontrollit, në



objektet e OST-së. Për garantimin e nivelit më të lartë të besueshmërisë dhe disponueshmërisë, sistemi është plotësisht redundant në infrastrukturë. Në kuadër të këtij projekti, OST-ja shkëmben të dhëna në kohë reale me IPTO, CGES, ENTSO-E, nëpërmjet një rrjeti të dedikuar e të sigurt, sipas të gjithë rekomandimeve të ENTSO-E. OST-ja ka implementuar edhe shërbimet e tjera të kërkuara nga ENTSO-E, për të cilat EH është vetëm mjet transmetues i tillë si sistemi EAS.

ENTSO-E Awareness System (EAS)

EAS-a është një platformë e centralizuar, e cila ju lejon operatorëve të sistemit të transmetimit të shkëmbejnë të dhëna në kohë reale. EAS-a është një platformë informuese, e cila u pasqyron OST-ve partnere një pamje globale dhe në kohë reale të rrjetit evropian të transmetimit. Operimi i kësaj platforme është shumë i dobishëm në rastet e një avarie, apo situatë kritike në rrjet, pasi informacioni i paraqitur iu jep mundësinë operatorëve për të identifikuar origjinën e problemit, për të realizuar një vlerësim më të mirë të kushteve dhe arsyeve që dërguan në këtë situatë dhe mund të ndihmojë në zgjidhjen e problemit. Përveç dërgimit në mënyrë automatike të të dhënave kryesore të sistemit tonë, operatorët raportojnë çdo ngjarje e cila ndikon në ndryshimin e gjendjes së sistemit, duke ndryshuar treguesin e gjendjes së sistemit dhe duke pasqyruar arsyen e ndryshimit të gjendjes së sistemit. Çdo operim në këtë sistem realizohet bazuar në dokumentin e Kodit të Rrjetit (si Udhëzues i Operimit të Sistemit).

Sistemet Lokale SCADA

Sistemet SCADA lokale shërbejnë si një periferike për marrjen e të dhënave dhe transmetimit e tyre drejt qendrave të kontrollit, si dhe për automatizimin e proceseve që kryhen nëpër N/ST në pronësi të OST-së. Të dhënat ndërmjet sistemeve SCADA/EMS, SCADA/ECC dhe nyjave periferike transmetohen duke përdorur një protokoll të caktuar, duke shfrytëzuar rrjetin e telekomunikacionit të OST sh.a. Këto sisteme ndërveprojnë me të dyja qendra të kontrollit në distancë në të njëjtën kohë. Sistemet lokale SCADA janë plotësisht redundant. Për të siguruar funksionimin normal të sistemit edhe në rastet kur një nga elementet dështon, këto sisteme sigurojnë mbështetje në nivel serverash dhe posteve të punës SCADA për operatorët.

Platforma e Operimit të Tregut

OST-ja është e detyruar të sigurojë transmetim të sigurt dhe të besueshëm të energjisë, kontroll efikas të sistemit energjetik të ndërlidhur me sistemet e energjisë të vendeve të tjera, zhvillim optimal dhe të qëndrueshëm të sistemit të transmetimit, që synon përmbushjen e nevojave të klientëve dhe të gjithë shoqërisë, sigurimin e funksionimit dhe zhvillimit të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, si dhe integrimin e tij në tregun rajonal dhe evropian të brendshëm të energjisë elektrike.

Për të përmbushur të gjitha kërkesat e sipërpërmendura nga muaji dhjetor 2023, OST-ja ka implementuar platformën NOVITA. Kjo platformë ofron zgjidhje të automatizuara për të trajtuar proceset që OST-ja duhet të përmbushë në mënyrë që të jetë në pajtim me standardet. Platforma NOVITA është e organizuar në trajtë modulare, ku modulet janë të ndërlidhur mes tyre dhe kryejnë këto funksione:

- Alokimi i kapacitetit ndërkufitar;
- *Accounting* dhe *Settlement* duke kryer përlllogaritjen e flukseve në pikat e Interkoneksionit të cilat vijnë nga sistemi i matjes *online*;
- Skedulimi ndërkufitar duke analizuar zonën ku do të veprojnë çdo partner, si dhe marrjen e informacionit për procesin e *Day-Ahead* apo *Intraday*, si dhe skedulimi i brendshëm.
- Mekanizmi i balancimit;
- Ankandin e shërbimeve ndihmëse;
- Menaxhimi i të llogaritjeve të disbalancave të palëve të tregut;
- Komunikimi me platformën e transparencës së ENTSO-E;
- Komunikimi me platformën e ALPEX-it.

Platforma e sistemit të matjes

Platforma e sistemit të matjes është e përbërë nga platforma kryesore e menaxhimit të energjisë elektrike dhe nga platforma mbështetëse (*Backup*). Të dyja platformat janë në lidhje paralele funksionimi.

Sistemi i komunikimit ndërmjet platformave dhe pikave të matjes (matësit kryesor dhe kontrollues) realizohet nëpërmjet rrjetit GSM të ofruara nga Vodafone Albania dhe Telekom Albania, rrjetit GPRS të ofruara nga kompanitë celulare ALBtelekom dhe Telekom Albania, duke përdorur komunikimin IPsec VPN dhe TCP nëpërmjet OPGW të Rrjetit të Telekomunikacionit të OST-së.



Për të garantuar nivelin më të lartë të disponueshmërisë dhe të besueshmërisë, sistemi është i mbyllur nga rrjeti i jashtëm dhe i lejueshëm vetëm nga adresa IP të dedikuara. Gjithashtu, është i ndërtuar me mbrojtje nga *Firewall* dhe antivirus të licencuar dhe rinovuar sipas afateve në kohë.

Platforma e sistemit të matjes është në komunikim të dedikuar me platformën e menaxhimit të operatorit të tregut “NOVITA”. Platforma e sistemit të matjes transmeton të dhëna nëpërmjet protokollit FTP në format CVS ose xml, ose nëpërmjet ndërfaqes web për marrjen e të dhënave nga operatori i tregut. Nëpërmjet këtij procesi realizohet leximi dhe dërgimi automatik i të dhënave të energjisë elektrike nga linjat e interkoneksionit në platformën e ENTSO-E.

Platforma e sistemit të matjes mundëson komunikim me sistemet SCADA dhe MiniSCADA me ndërfaqen e Portës së të Dhënave SCADA.

Gjenerimi i të dhënave të platformës së Menaxhimit të Energjisë Elektrike realizohet nëpërmjet ndërfaqes web, e cila lejon dhe kufizon aksesin, bazuar në adresat IP, si nga brenda ashtu dhe nga jashtë rrjetit.

Aksesimi i të dhënave në ndërfaqen Web është i menaxhueshëm nga administratori i rrjetit sipas kërkesave të përdoruesve të brendshëm të OST-së të autorizuar më parë.

Sistemi Oracle EBS

Ky sistem përdoret për përpunimin e të gjitha të dhënave financiare të OST sh.a., duke menaxhuar në këtë mënyrë faturat dhe pagesat. Sistemi në fjalë gjithashtu është i integruar me sistemin e burimeve njerëzore i cili shërben për menaxhimin e punonjësve të kompanisë. Në këtë sistem gjithashtu ruhet dhe dokumentacioni i OST-së në mënyrë elektronike.

Sistemi PSSE

Ky sistem përdoret për krijimin e modeleve të rrjetit sipas formateve të kërkuara nga ENTSO-E.

Sistemi ODMS

Ky sistem është krijuar nga ENTSO-E dhe shërben për shkëmbimin e modeleve të rrjetit midis TSO-ve pjesë e saj. OST sh.a. i kalon modelet e rrjetit në sistemin ODMS dhe më pas i dërgon drejt ENTSO-E.

Sistemi i antivirusit Check Point

Ky sistem antivirusi është i instaluar në çdo kompjuter apo server të OST sh.a. dhe kryen mbrojtjen e pajisjeve elektronike nga viruse të

ndryshëm. Ky sistem është i pajisur me një sistem monitorimi qendror në mënyrë që të mundësojë menaxhimin më të thjeshtë të kompjuterëve, si dhe të rrjetit.

Sistemi WebProxy

Ky sistem monitoron të gjithë trafikun e internetit të krijuar nga përdoruesit apo pajisjet e OST sh.a. dhe kryen bllokimin e faqeve të padëshiruara apo të faqeve që përmbajnë viruse. Ky sistem është i pajisur me një sistem monitorimi qendror në mënyrë që të mundësojë menaxhimin më të thjeshtë të kompjuterëve, si dhe të rrjetit.

Sistemi i mbrojtjes së email-eve

Ky sistem monitoron gjithë trafikun e *email*-eve që vijnë drejt OST sh.a. duke i analizuar ata dhe duke bërë kategorizimin e tyre. Ky sistem kryen mbrojtjen e përdoruesve të *email*-it nga *email*-e të tipit SPAM.

OPDE (Operational Planning Data environment)

OPDE-ja është një platforme në të cilën përcaktohen kërkesat minimale të planifikimit operativ, me qëllim sigurimin e proceseve koherente dhe të koordinuara të planifikimit operativ të zonave të sinkronizuara të zbatueshme për të gjithë përdoruesit e rrjetit me rëndësi specifike, si dhe të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmetimit.

Protokollet dhe certifikatat për standardet e sigurisë ofrohen nga ENTSO-E dhe konfigurohen nga administratorët e sistemit në server të veçantë në ambientet e OST-së.

SharePoint

SharePoint është një platformë aplikative në *web*, e përqendruar dhe e mbrojtur, që i ofron shoqërisë mbështetje për menaxhimin e të dhënave, përmbajtjeve dhe dokumenteve në mënyrë të thjeshtë dhe të sigurt, duke përmirësuar procesin e punës. *Microsoft SharePoint* lejon krijimin e *website*-eve, si dhe menaxhimin e portaleve intranet dhe *extranet*. Sigurinë e huazon drejtpërdrejt nga *Active Directory*, për sa i përket autentifikimit të *user*-ave.

Sistemi JPuna

Është një sistem i cili kryen këto funksione:

- Kontrolli dhe monitorimi i punëve në terren;
- Administrimi i remonteve;
- Evidentimi i defekteve;
- Evidentimi i aseteve;
- Regjistër dhe historik i defekteve;
- Njoftim stafi për remonte të planifikuara;
- Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe vlerësim efektiv të punonjësve në njësitë operative;



- Aksesimi i sistemit Jpuna realizohet si në rrjetin e OST-së dhe jashtë saj.

Phasor Measuring Unit – Wide Area Monitoring System

OST-ja gjatë vitit 2019, krahas sistemeve teknologjike ekzistuese në operim, ka implementuar sistemin e analizimit të rrjetit nëpërmjet PMU-WAMS (*Phasor Measuring Unit – Wide Area Monitoring System*). WAMS është një sistem i përbërë nga disa elemente, të cilat monitorojnë parametra të ndryshëm të sistemit elektroenergjetik, në kohë reale. Sistemi WAMS është në shfrytëzim vetëm për OST, duke mos ofruar të dhëna në mënyrë direkte për palët e treta.

Të dhënat e siguruar në një qendër kontrolli nga një rrjet WAMS janë të ngjashme me të dhënat e siguruar nga SCADA. Disponueshmëria dhe integriteti i të dhënave janë objektivat kryesorë të sigurisë. Matja e tensionit dhe rrymave me njësi matëse fazorësh (PMU) japin mundësi të reja në përpunimin e të dhënave dhe rritjen e dinamikës së sistemit. Qëllimi kryesor i përdorimit është monitorimi i vazhdueshëm i parametrave dinamikë të sistemit energjetik për dy role të përdoruesit: operatori i rrjetit dhe analisti i sistemit.

Software i Monitorimit të Sistemit (SIGUARD) merr të dhënat nga PMU-të të cilat janë instaluar në linjat e lartpërmendura dhe komunikon me programin SIGUARD nëpërmjet një sistemi të përshtatshëm të komunikimit.

Softveri WAMS ofron të gjitha funksionet, si:

- Përqendrimi i të dhënave;
- Ruajtja e të dhënave;
- Rikthimin e të dhënave;
- Përpunimin e të dhënave;
- Analiza e të dhënave të transmetimit;
- Shfaqja e të dhënave.

4.2.2 Siguria e sistemeve të informacionit

Nga informacioni i siguruar pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Drejtoria e Shërbimeve të Automatizuara të Rrjetit rezulton se janë marrë një sërë masash për të rritur sigurinë e informacionit dhe të sistemeve dhe konkretisht:

- Metodologjia e përdorur për të identifikuar dhe menaxhuar pikat e dobëta të sistemeve të informacionit;

Metodologjia e përdorur për të identifikuar pikat e dobëta të sistemeve në shfrytëzim është duke monitoruar më mënyrë të vazhdueshme aktivitetet

që përbëjnë risk. Këto aktivitete identifikohen në bazë të procedurave të standardizuara të riskut, identifikim i cili kryhet çdo 6-muaj. Në zbatim të rekomandimeve nga Drejtoria e Riskut, për çdo incident raportohet sipas procedurave më poshtë:

- PRO-RISK-001 Procedura e Raportimit të Ngjarjeve me Risk Operacional – V.1.0 signed;
- PRO/6.1, 8.2 & 8.3 Procedura për vlerësimin e rrezikut.

Për çdo incident të mundshëm realizohen analizat e nevojshme teknike, mbi të cilat merren masat e duhura.

- *Software* për të monitoruar dhe parandaluar rreziqet gjatë navigimit në internet, përdorimit të postës elektronike, si dhe mbrojtjen e sistemeve nga viruset.

- DSHTI-ja, për t'i ofruar shërbim interneti të gjithë punonjësve të OST-së në mënyrë sa më të sigurt dhe cilësore, ka në përdorim një sistem *Internet Proxy*, i cili monitoron dhe analizon të gjithë trafikun e internetit në OST. Ky sistem është i aftë të realizojë bllokimin automatik të faqeve të padëshiruara apo faqeve *web*, të cilat përmbajnë viruse, si dhe lajmërimin automatik të administratorit të sistemit lidhur me rreziqet e mundshme. Sistemi menaxhohet nga një konsolë qendrore monitorimi/menaxhimi nga ku bëhet raportimi i të gjithë aktiviteteve të zhvilluar gjatë navigimit në internet nga çdo përdorues.

- Sistemi i menaxhimit të postës elektronike *email* në OST menaxhohet në dy servera *microsoft exchange server 2016* të lidhur në cluster. Për të rritur parandalimin dhe monitorimin ndaj *email*-eve keqdashëse të gjitha *email*-et filtrohen nga një sistem i cili është i aftë të monitorojë, parandalojë dhe analizojë të gjitha *email*-et e dyshimta duke mos lejuar kalimin e tyre deri në përdoruesit e postës elektronike të OST-së.

- Dhomat e serverave dhe ambientet teknologjike janë një komponent kritik i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në OST. Për të realizuar një monitorim të parametrave të temperaturës, lagështisë dhe prezencës së ujit në dhomat teknologjike ku janë të vendosura servera, gjatë vitit 2019 është implementuar një sistem monitorimi dhe lajmërimi, nëse ka luhajtje të vlerave normale të kushteve ambientale brenda dhomave teknologjike.

- Rrjetat fizike, të cilat shërbejnë për të transmetuar të dhëna shumë të rëndësishme siç janë



të dhënat SCADA apo ato të matjes, janë tërësisht të ndara nga rrjeti LAN i përdoruesve të OST-së, duke siguruar në këtë mënyrë një siguri të lartë fizike dhe softwerike të këtyre sistemeve;

- Sistemet SCADA nuk janë të ekspozuara në internet. Transmetimi i informacioneve nga nyjat periferike në drejtim të sistemeve SCADA realizohet nëpërmjet rrjetit të brendshëm të telekomunikacionit, i cili është në pronësi të OST dhe përbëhet nga fibra optike. Profilet e përdoruesve janë të mirëpërcaktuar, sipas roleve që duhet të kryejnë në sistem;

- Sistemi SCADA/EMS shfrytëzon *software* dhe pajisje *firewall* të certifikuar nga prodhuesit, nëpërmjet të cilave bëhet përditësimi i politikave të sigurisë, monitorim proaktiv të shkëmbimit të të dhënave në rrjetin SCADA, si dhe marrje masa vlerësuese dhe parandaluese për rritjen e sigurisë të këtyre sistemeve. Gjithashtu, përdoren dhe *Software* të licencuar të posaçëm, të cilët kryejnë masa parandaluese dhe bllokuese mbi viruset e infiltruar në këto sisteme,

- Pajisjet e vecanta të përdorura nga sistemi SCADA janë *firewall* të dedikuar dhe *redundant* ndërmjet njëri-tjetrit, servera të cilët autorizojnë aksesin në këto sisteme dhe antivirusë të licencuar.

Sa u përket masave të marra në kuadër hartimit të një plani masash/politikash sipas standardeve të BE-së dhe praktikave më të mira evropiane që zbatohen në këtë fushë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 2/2017, “Mbi sigurinë kibernetike”, dhe VKM-së nr. 553, datë 15.7.2020, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit” (i ndryshuar), ku OST-ja bën pjesë, për menaxhimin e situatave kritike, si dhe certifikimin e OST-së me ISO 27001 mbi *Cyber Security*, nga informacioni i marrë pranë Sektorit të Politikave të Sigurisë Kibernetike rezulton, se:

Në përmbushje të detyrimeve të nenit 18 të ligjit nr. 2/2017, “Mbi sigurinë kibernetike”, OST sh.a. ka bërë me dije për caktimin e pikës së kontaktit, si dhe në përmbushje të detyrimeve të VKM-së nr. 553 datë 15. 7.2020 (i ndryshuar), është bërë aprovimi si infrastrukturë kritike e informacionit me fokus platforma SCADA.

Gjatë vitit 2024 nuk rezulton të ketë pasur incidente të sigurisë kibernetike.

Më konkretisht politika, procedura dhe SOP (*Standart Operation Procedures*) të miratuara, me qëllim përmbushjen e detyrimeve, janë të radhitura, si më poshtë:

Lista e politikave:

Nr.	Pika e normës	Emri i procedurës
1.	POL/5.2 & A.5.1.1	Politika për sigurinë e informacionit
2.	POL/A.6.2	Politika e pajisjeve elektronike
3.	POL/A.6.2.1	Politika për sigurinë e pajisjeve lëvizëse (mobile)
4.	POL/A.6.2.1/1	Politika për laptopin
5.	POL/A.6.2.2	Politika e <i>Teleworking</i>
6.	POL/A.7 & A.7.2	Politika për internetin
7.	POL/A.7.1.1 & A.12.3	Politika e Postacionit të Punës (<i>Workstation</i>)
8.	POL/A.7.2.2	Politika e trajnimit për rrjetin
9.	POL/A.8.1.3	Politika e përdorimit të pranueshëm të aseteve
10.	POL/A.8.2	Politika për klasifikimin e informacionit të OST sh.a.
11.	POL/A.8.3 & A.11.2.7	Politika e depozitimit dhe shkatërrimit
12.	POL/A.9	Politika për kontrollin e aksesit
13.	POL/A.9.2	Regjistrimi i përdoruesit menaxhimi i aksesit
14.	POL/A.9.4 & A.11	Politika për sigurinë e sistemeve informatike të OST-së
15.	POL/A.9.4.3	Politika e mbrojtjes së fjalëkalimit (<i>Passwordere</i>)
16.	POL/A.10	Politika kriptografike
17.	POL/A.11.1	Politika e sigurisë së dhomës së serverave
18.	POL/A.11.1.2	Politika për kartën e hyrjes
19.	POL/A.11.1.2/1	Politika për vizitorët
20.	POL/A.11.2	Politika e infrastrukturës
21.	POL/A.11.2.9	Politika <i>Clear Desk</i> dhe <i>Clear Screen</i>
22.	POL/A.12.1.2	Kontrolli i ndryshimit



23.	POL/A.12.3	Politika për <i>backup</i> dhe rikuperim
24.	POL/ A.12.5	Politika <i>Freeware</i> dhe <i>Shareware</i>
25.	POL/A.12.6	Politika për menaxhimin e <i>Patch</i> -ve
26.	POL/A.13.1	Politika për rrjetin (LAN-in)
27.	POL/A.13.2.1	Politika për transferimin e të dhënave nga punonjësit
28.	POL/A.13.2.3	Politika e postës elektronike
29.	POL/A.13.2.4	Politika e konfidencialitetit dhe paanshmërisë
30.	POL/A.15.1.1	Politika e sigurisë për kontraktorët/konsulentët/furnitorët
31.	POL/A.17.1	Politika e vazhdimësisë së biznesit
32.	POL/A.18.1.4	Politika për mbrojtjen e të dhënave personale
33.	POL-MB&SIG-SSAA-001	Politikat e Mbrojtjes dhe Sigurisë së OST sh.a.

Lista e procedurave

Nr.	Pika normës	Emri i procedurës
1	PRO/4.1, 4.2 & 4.3	Procedura Konteksti i Organizatës dhe fushëveprimit
2	PRO/4.4	Procedura e Qasjes për Zbatimin e ISMS-së
3	PRO/5.3	Procedura roli dhe përgjegjësia
4	PRO/6.1, 8.2 & 8.3	Procedura për vlerësimin e rrezikut
5	PRO/6.1/1	Procedura për deklaratën e zbatueshmërisë (SoA)
6	PRO/7.2 & 7.3	Procedura e rekrutimit dhe trajnimit të personelit
7	PRO/7.3	Procedura për masat disiplinore
8	PRO/7.4	Procedura e komunikimeve të brendshme dhe të jashtme
9	PRO/7.5	Procedura e menaxhimit të dokumenteve dhe regjistrimeve
10	PRO/ 9.1 & 10.2	Procedura për matje, analiza dhe përmirësim
11	PRO/9.2	Procedura e auditimit të brendshëm
12	PRO/9.3	Procedura rishikimi i menaxhimit të drejtimit
13	PRO/10.1	Procedura për masat korrigjuese dhe jokonformitetin
14	PRO/ A.6	Procedura për Sigurinë e Organizatës
15	PRO/A 6.2	Procedura për menaxhimin e mermorieve të lëvizshme
16	PRO/A 7.1	Procedura për Planifikimin e Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit
17	PRO/A 7.2	Procedura për Sigurinë e Personelit
18	PRO/A 8	Procedura për Klasifikimin dhe Kontrollin e Aseteve
19	PRO/A 9	Procedura për Kontrollin e Aksesit
20	PRO/A 11	Procedura për sigurinë fizike dhe mjedisore
21	PRO/A 11.1.5	Procedura e punës në mjedise të sigurta
22	PRO/A 12.1.2	Procedura për planifikimin e ndryshimeve të procedurave dhe politikave
23	PRO/A 13	Procedura për Komunikimet dhe Menaxhimin e Veprimtarive
24	PRO/A 13.2.4	Procedura e Konfidencialitetit dhe paanshmërisë
25	PRO/A 15	Procedura për vlerësimin e furnitorit
26	PRO/A 15.2	Procedura për administrimin e blerjeve
27	PRO/A 16.1	Procedura e menaxhimit të incidenteve
28	PRO/A 17.1/1	Procedura për strategjinë e ruajtjes dhe rikthimit të të dhënave
29	PRO/A 17.1/2	Procedura për planin e rimëkëmbjes nga katastrofat
30	PRO/A 18.1.1	Procedura e identifikimit të ligjeve dhe kërkesave të tjera
31	PRO/01	Procedura e OST sh.a. për COVID-19

Miratimi dhe hyrja në fuqi e këtyre politikave dhe procedurave u është komunikuar të gjithë stafit të OST nëpërmjet *email*-it zyrtar dhe për më tepër, këto dokumente janë të publikuar edhe në Intranet-in e

OST në rubrikën përkatëse “Politika dhe procedura”.

Nga informacioni i marrë nga Sektori i Sigurisë së Informacionit rezulton se, gjatë vitit 2024 është



kryer rinovimi i certifikimit ISO 27001, ku OST sh.a. është ricertifikuar me ISO 27001:2022. Në bazë të këtij ricertifikimi, janë kryer ndryshimet dhe rishikimet e nevojshme në politikat dhe procedurat përkatëse, në përputhje me kërkesat e standardit ISO.

Në kuadër të ricertifikimit të OST me ISO 27001: 2022 mbi *Cyber Security*, gjatë vitit 2024, janë marrë ndërmarrë masat si vijon:

a) Zgjerimi i Sistemit Antivirus: Sipas rekomandimeve nga Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike, është bërë zgjerimi i sistemit antivirus duke përfshirë Zgjerimin e Detektimit dhe Përgjigjes (XDR) dhe të Parandalimit dhe Përgjigjes së Zgjeruar (XPR), të cilat tejkalojnë masat e sigurisë tradicionale. Kjo nismë lindi nga nevoja për të mbrojtur sistemet kritike me një ndryshim drejt një qasjeje të integruar, inteligjente dhe parashikuese ndaj sigurisë kibernetike.

b) Ristrukturimi i infrastrukturës: Për të rritur sigurinë e informacionit dhe për të mbrojtur sistemet nga sulmet kibernetike, duke minimizuar rrezikun, është bërë një restrukturim të infrastrukturës teknologjike të platformës së matjes së energjisë dhe të sistemeve SCADA/EMS, si dhe të sistemeve të IT-së.

c) Segmentimi i Rrjetit dhe Përmirësimi i *Firewall*-it: është bërë segmentimi i domaineve të Matjes, IT dhe SCADA duke implementuar dhe zëvendësuar *firewall*-e që ishin në fund të jetës së tyre me dy *firewall*-e të reja të gjeneratës së ardhshme *Fortigate*, të cilat janë të konfiguruar si një klaster në rolet aktive/pasive.

a) Siguria dhe Segmentimi i Rrjetit: për të rritur sigurinë e komunikimit midis sistemeve, është realizuar segmentimi i rrjetit, dy *firewall*-e të gjeneratës së fundit model Cisco FTD 1120 janë konfiguruar në një klaster ku të gjitha lidhjet VPN për infrastrukturën e IT-së dhe për platformën e matjes përfundojnë në këto *firewall*-e. Gjithashtu, trafiku i rrjetit, përfshirë menaxhimin ndaj kërcënimeve dhe ekspozimin në internet, menaxhohet përmes *firewall*-eve Cisco FTD, të cilët suportojnë IDS/IPS *Intrusion detection systems/intrusion prevention systems*.

b) Implementimi i Sistemeve të Rezervës: për të siguruar një kopje rezervë të të gjithë infrastrukturës IT dhe platformës së matjes së energjisë, është implementuar një sistem *backup* në kasetë (tape) me kapacitet të mjaftueshëm për ruajtjen e të dhënave.

Procesi *backup* bëhet përmes sistemit *Veeam backup*, sipas standardit 3-2-1-1-0.

c) Në kuadër të rritjes së sigurisë në sistemet OT, duke përfshirë infrastrukturën e sistemit SCADA/EMS dhe të gjitha nënstacionet e OST sh.a., është implementuar një projekt i financuar nga USAID/USEA, me objekt *“Just and Secure Energy Transition Program”*. Me anë të këtij sistemi realizohen funksionet e mëposhtme:

- OT Zbulimi i aseteve;
- OT Menaxhimi i sigurisë së aseteve;
- OT Menaxhimi i cënueshmërisë ;
- OT Menaxhimi i kërcënimeve;
- OT Vlerësimi i vektorit të sulmit;
- OT Baza e modelit të sigurisë;
- OT Zbulimi dhe Monitorimi i Kërcënimeve të

OT & Politikave.

Gjatë vitit 2024, OST-ja ka bërë investime të konsiderueshme në infrastrukturën teknologjike për të rritur sigurinë dhe efikasitetin e sistemit të informacionit, ku përmendim:

a) Zgjerimi i Sistemit SCADA/EMS: sipas rekomandimeve dhe standardeve të sigurisë së informacionit është implementuar një site *backup* për sistemin SCADA/EMS, me qëllim ruajtjen e informacionit në një vendndodhje tjetër në distancë gjeografike 100 km nga distanca e sistemit aktual.

b) Përmirësimi i Infrastrukturës së Serverave: Tre servera të fundit model HPE ProLiant DL380 Gen11 janë instaluar për të mbështetur virtualizimin dhe kalimin e pandërprerë të aplikacioneve në raste emergjence. Kjo infrastrukturë mbështetet nga licencat e VMWARE VSPHERE STANDARD 8 dhe lidhet me *switch*-e *Fibre Channel* dhe *FlexNetwork* për performancë të lartë dhe siguri të rrjetit.

c) Zgjerimi i Sistemeve të Sigurisë së Informacionit: implementimi dhe zgjerimi i masave të sigurisë, si: MFA-ja, ZTNA-ja dhe SIEM-ja, duke përfshirë aksesin e kontrolluar të përdoruesve dhe menaxhimin e aktivitetit të tyre në kohë reale. Sistemi i privilegjuar i aksesit remote nga *BeyondTrust* dhe përditësimi i FortiSIEM janë pjesë kyçe të kësaj strategjie.

d) Përmirësim i sistemit të kontroll monitorimit në nënstacionet 220 kV

Në respektim të rekomandimeve të lëna nga Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike gjatë vitit 2024 është realizuar përditësimi në versionet më të fundit të sistemeve, të cilat e kishin kaluar ciklin e jetës së tyre (*end of life*) në versionet më të fundit për



infrastrukturën kritike të informacionit OT në nënstacionet 220 kV: Tirana 1, Elbasan 1, Babicë dhe Burrel.

Gjithashtu, OST-ja ka vijuar të trajtojë dhe ndërgjegjësojë stafin mbi rëndësinë e sigurisë së informacionit, duke krijuar një kulturë të fortë të mbrojtjes kibernetike. Përmes këtyre masave, OST mbetet e angazhuar për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për operacionet e saj, duke garantuar që infrastruktura e transmetimit të energjisë elektrike të mbetet e mbrojtur dhe funksionale përballë sfidave të vazhdueshme të sigurisë.

4.2.3 Të dhënat e platformave

Platformat elektronike të menaxhuara nga OST-ja përmbajnë të dhëna teknike dhe financiare mbi aktivitetin e OST-së, të cilat hidhen nga punonjës të OST-së që kanë të drejta aksesit dhe disa prej të cilave aksesohen nga përdoruesit e sistemit të transmetimit.

4.2.3.1 Të dhënat që hidhen nga përdoruesit e sistemeve

Sistemi SCADA mbledh në kohë reale dhe përpunon të dhënat e sistemit elektroenergjetik (të tilla si: fuqia *active*, *reactive*, rrymë, tension, frekuence, $\cos \varphi$, pozicion ancafkash, pozicionet e elementeve komutuese, alarme mbi gjendjen e sistemit etj.), për qëllime monitorimi dhe analizash, me fokus kryesor në ruajtjen e qëndrueshmërisë së sistemit elektroenergjetik, marrjes së masave në kohë dhe me eficiencë për parandalimin e avarive dhe minimizimin e kontigjencave. Ato kryejnë, gjithashtu, kontroll (komandim në distancë) të elementeve të sistemit elektroenergjetik, analiza të sistemit të transmetimit në kohë reale, si dhe parashikimin e kongjestionëve në rrjet në rrafsh kohorë të ndryshme.

Platforma NOVITA, ndërfaqëson me një sërë platformash e sistemesh të tilla, si:

- Sistemi i matjeve të OST (QME);
- Platforma e Transparencës së ENTSO-E;
- Zyrën e alokimit të kapaciteteve për Evropën Juglindore (SEE CAO);
- Qendrën e koordinimit të shkëmbimeve ndërkufitare (*Verification Platform*);

Të dhënat që ngarkohen në këtë platformë kryhen nga përdoruesit e kësaj platforme, të cilët janë punonjës të OST-së ose pjesëmarrës të regjistruar në tregjet e energjisë dhe këto të dhëna

lidhen me proceset specifike, të cilat zhvillohen nga ky sistem dhe në varësi të rolit që kanë përdoruesit.

4.2.3.2 Informacioni që palët e treta marrin nëpërmjet platformave

Platforma NOVITA – pjesëmarrësit e tregut, kanë një qasje të kufizuar vetëm në të dhënat dhe proceset e biznesit, që lidhen me rolet të cilat luajnë ata në tregun e energjisë. Këta pjesëmarrës kanë të drejta vetëm në oraret e proceseve dhe ofertat e tyre. Në funksion të proceseve dhe të kohës së zhvillimit të tyre, pjesëmarrësit zhvillojnë aktivitetet e tyre. Të dhënat të cilat shkëmbehen janë mirëpërcaktuar, dakordësuar ndërmjet palëve duke bërë të mundur garantimin maksimal të sigurisë të informacionit për të dhënat sensitive të karakterit tregtar.

Sistemi SCADA – palë të treta të cilat kanë akses në sistemin SCADA janë kontraktorët të cilët kanë nënshkruar një kontratë mirëmbajtje me OST për dhënie suporti mbi këto sisteme. Aksesit i këtyre kontraktorëve zhvillohet mbi baze të një kanali komunikimi të enkriptuar dhe të dedikuar për përdoruesin e autorizuar kontraktualisht, në mënyrë që çdo veprim, ndërhyrje ose akses të dhënash është i monitorueshëm nga specialistët e sektorit SCADA.

Sistemi i matjes *online* – nga ky sistem nxirren dhe përgatiten raportet ditore dhe mujore të energjisë që dërgohen brenda njësive të autorizuar më parë të OST-së.

Raportet ditore përfshijnë:

- Të dhënat orare të të gjitha pikave të matje, ekport aktiv dhe import aktiv;
- Të dhëna orare të të gjitha pikave të OSHEE-së, eksport aktiv dhe import aktiv;
- Të dhënat orare të të gjitha pikave të Konsumatorëve të Tregut të Liberalizuar të Energjisë në nivel 35 kV (të integruara përkohësisht në platformën e sistemit të matjes së energjisë në OST sh.a. deri në vendosjen në funksion të platformës së re të dedikuar për këtë proces);
- Të dhënat orare të humbjeve në sistem.

Raportet mujore përfshijnë:

- Të dhënat orare të të mërkurës së tretë të muajit dhe të dielës para saj, për të gjitha pikat e matjes (ekport, import, aktiv, reaktiv, nivel tensioni);
- Bilancin e energjisë mujore;
- Përgatitjen e aktrakordimit ndërmjet OSHEE-së dhe OST sh.a.;
- Përgatitjen e aktrakordimit ndërmjet KESH dhe OST sh.a.;



- Bilancin dhe Shkëmbimin e Energjisë në Linjat e Interkoneksionit.

OST-ja, në zbatim të rregulloreve EC nr. 714/2009 dhe nr. 543/2013 (Rregullorja e Transparencës) mbi publikimin e të dhënave relevante të energjisë në platformën e transparencës, ka filluar procesin e dërgimit të të dhënave në këtë platformë në mënyrë të automatizuar, duke shfrytëzuar si burim informacioni të dhënat që gjeneron platforma NOVITA, sipas standardeve të mirëpërcaktuara nga ENTSO-E. Të dhënat që OST-ja aktualisht i mundëson ENSTO-E janë si më poshtë:

- Kapaciteti total i instaluar i njësive të prodhimit mbi 100 mw;
- Parashikim i gjenerimit dhe ngarkesës së vendit;
- Skedulimi ndërkufitar orar;
- Alokimi eksplicit;
- Çmimi i disbalancave;
- Pamjaftueshmëria e aseteve të transmetimit etj.

Nga informacioni i marrë dhe monitorimi i kryer rezulton se sistemet e teknologjisë së informacionit dhe rrjeti i brendshëm i OST-së mbrohen në mënyrë efektive nga kërcënimet e viruseve nëpërmjet programeve të veçanta.

Gjithashtu, rezulton se strukturat përgjegjëse për menaxhimin e tyre përdorin metodologji të avancuara për të identifikuar dhe menaxhuar pikat e dobëta të këtyre sistemeve.

Siguria e sistemeve, për të garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit të menaxhuar nga këto sisteme, arrihet duke përdorur teknologji të avancuar dhe duke aplikuar praktikat më të mira, sipas shpjegimeve të bëra në pikën 4.2.2 më lart.

4.3 Pavarësia e shoqërisë

4.3.1 Certifikimi i OST-së si operator i pavarur i transmetimit

OST sh.a. është certifikuar nga ERE me vendimin nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.” duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin e përcaktuar në nenet 54 dhe 58 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9 të direktivës 72/2009 EC, duke mbajtur parasysh rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhënë në “Opinionin 1/17 në bazë të nenit 3(1) të Rregullores EC nr. 714/2009 dhe nenit

10(6) të direktivës 2009/72/EC – Shqipëria – Certifikimi i OST”, datë 23.1.2017.

Certifikimi i OST-së nga ERE si operator i pavarur i transmetimit të energjisë është bërë duke kërkuar nga OST dhënia e garancive shtesë, në lidhje me:

- Pavarësinë e audituesit financiar;
- Mostransferimi i stafit;
- Ndarja e operatorit të tregut;
- Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimi i kompetencave të Ministria e Ekonomisë;
- Programi i Pajtueshmërisë dhe Zyrtari i Pajtueshmërisë.

Përmbushja e këtyre kushteve siguron pavarësinë e OST-së nga kompanitë vertikalisht të integruara që kryejnë ose janë të angazhuara në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror dhe në të njëjtën kohë shmang sjelljet diskriminuese ndaj përdoruesve të rrjetit të transmetimit.

Përmbushja e kushteve mbi pavarësinë e audituesit financiar, mostransferimit të stafit dhe Programit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë, janë trajtuar në këtë raport respektivisht në pikat 4.3.3.2, 4.3.2.4 dhe pika 1 (Hyrje).

- Sa i përket ndarjes së Operatorit të Tregut dhe krijimit të Bursës së Energjisë:

Në zbatim të nenit 57 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” (i ndryshuar), VKM - së nr. 322, datë 15.5.2019, “Për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së kapitalit të operatorit të tregut”, dhe të VKM-së nr. 609, datë 11.9.2019, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e operatorit të tregut”, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë, me urdhrin e tyre të përbashkët nr. 10313/2 prot., datë 14.1.2020, “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e Operatorit të Tregut”, ngritën Komisionin e Posaçëm, i cili ndoqi dhe përmbylli procedurat e përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e Operatorit të Tregut, si dhe hartoi për këtë qëllim raportin e tij përfundimtar. Ky raport u miratua me urdhrin e përbashkët të ministrit të MIE-s dhe të MFE-së nr. 228 datë 28.7.2020. Në zbatim të këtij urdhri dhe njoftimit nr. 5727/2, datë 30.7.2020, nga MIE,



Operatori i Sistemit të Transmetimit – OST sh.a. dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut sh.a. – KOSTT sh.a., zhvilluan negociatat për ndarjen e aksioneve që do të nënshkruheshin nga secila prej palëve për të marrë pjesë si aksionarë në shoqërinë e Operatorit të Tregut – Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, si dhe Statutin dhe Marrëveshjen e Aksionarëve të kësaj shoqërie.

Me vendimin nr. 12, datë 8.9.2020, Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a., miratoi pjesëmarrjen e OST sh.a., si aksionare në Shoqërinë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a., me 57.25% të kapitalit themeltar, si dhe marrëveshjen e aksionarëve dhe statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a., të cilat do të nënshkruheshin nga OST sh.a. dhe KOSTT sh.a.

Me vendimin nr. 130, datë 5.10.2020, Asambleja e Përgjithshme e OST sh.a. – Ministria e Financave dhe Ekonomisë, miratoi pjesëmarrjen e OST sh.a., si aksionare në Shoqërinë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a., me 57.25% të kapitalit themeltar, si dhe marrëveshjen e aksionarëve dhe statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a., të cilat do të nënshkruheshin nga OST sh.a. dhe KOSTT sh.a.

Më datë 5 tetor 2020, përfaqësuesit ligjorë të OST sh.a. dhe KOSTT sh.a. firmosën Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a. – ALPEX.

Shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a. – ALPEX, është regjistruar tashmë në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Tiranë (me NIPT M02223006B).

- Sa i përket kushtit të “Bashkëpunimit ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimi i kompetencave të Ministria e Ekonomisë”, OST ka mbajtur korrespondencë të vazhdueshme me të gjitha institucionet përkatëse për të gjetur zgjidhjen më të mirë për përmbushjen e këtij kushti, por realizimi me sukses i tij i tejkalonte kompetencat e OST-së me gjithë përpjekjet e vazhdueshme.

Në këto kushte, në bazë të kërkesave të OST-së, ERE, me vendimin nr. 58, datë 15.3.2018, vendim nr. 47, datë 19.3.2019, si dhe vendim nr. 207, datë 16.12.2019 ka vendosur shtyrjen e afatit të vendosur në pikën 2 të vendimit nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a., në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit

nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 2009/72/EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, deri më datë 16.6.2020.

Ndërkohë, me shkresë nr. 1434 prot., datë 6.2.2020, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka njoftuar OST mbi vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 836, datë 24.12.2019, “Për propozimin e projektligjit, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’, i ndryshuar”.

Me anë të ligjit nr. 61/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’, i ndryshuar”, janë miratuar ndryshimet në nenin 31 pika 1 të ligjit.

Me vendim nr. 99, datë 24.6.2020, ERE ka vendosur shfuqizimin e pikave 2, 3 dhe 4 të vendimit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.”, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin e përcaktuar në nenet 54 dhe 58, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenin 9 të direktivës 72/2009 EC, duke mbajtur parasysh rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, duke lënë detyrimin për OST të paraqesë në ERE çdo vit ushtrimor informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë.

4.3.2 Pavarësia e menaxhimit

OST sh.a. është e organizuar dhe funksionon si shoqëri tregtare në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, statudit të shoqërisë, si dhe akteve të brendshme të saj. Organet drejtuese të shoqërisë janë: Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori që ushtrojnë kompetencat e tyre sipas përcaktimeve të ligjit të lartpërmendur dhe Statutit të Shoqërisë.

Në referim të nenit 135, pika “b”, të ligjit për shoqëritë tregtare ku përcaktohet, se: “*Asambleja e Përgjithshme merr vendime për emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit (sistemi me një nivel) dhe (në sistemin me dy nivele) të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës*”, si dhe të nenit 13 të statudit të OST-së, ku përcaktohet, se: “*Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme*”, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme, ka emëruar anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të OST-së, duke respektuar



parashikimet e pikës 3, të VKM-së nr. 317, datë 27.4.2016, “Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike”, dhe parashikimet e nenit 54 të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Gjithashtu, administratori i shoqërisë është emëruar nga Këshilli Mbikëqyrës në bazë të nenit 158 të ligjit për shoqëritë tregtare, ku përcaktohet, se: *“Këshilli i administrimit emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet”,* si dhe nenit 20.1 të statutit të OST sh.a. ku përcaktohet, se: *“Këshilli Mbikëqyrës emëron Administratorin e Shoqërisë”.*

4.3.2.1 Këshilli Mbikëqyrës

Deri më datë 31.12.2024, Këshilli Mbikëqyrës përbëhej nga 5 anëtarë, si vijon:

- Znj. Vasilika Vjero (kryetar)
- Znj. Viola Haxhiademi (anëtar)
- Znj. Lira Pipa (anëtar)
- Z. Endrit Yzeiraj (anëtar)
- Z. Antonio Bushati (anëtar)

Gjatë periudhës 1.1.2023 deri më 31.12.2023, me vendimin e Asamblesë së Aksionarit nr. 39, datë 25.6.2024, “Për ndryshime në Këshillin Mbikëqyrës”, janë bërë ndryshime në përbërjen e Këshillit Mbikëqyrës si vijon:

Liruar nga detyra:

- Znj. Merita Gurabardhi (anëtar)
- Z. Nikolla Lera (anëtar)
- Z. Klodian Mene (anëtar)

Emëruar në detyrë:

- Znj. Lira Pipa (anëtar)
- Z. Endrit Yzeiraj (anëtar)
- Znj. Kamela Banushi (anëtar)

Vendim me vendimin e Asamblesë së Aksionarit nr. 1167, datë 30.12.2024, “Për lirim nga Këshilli Mbikëqyrës” është liruar nga detyra:

- Znj. Kamela Banushi (anëtar)

Emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është bërë në përputhje me parashikimet e nenit 135, pika “b”, të ligjit për shoqëritë tregtare, si dhe pikës 3 të VKM-së nr. 317, datë 27.4.2016, “Për përcaktimin e Autoritetit Publik që Përfaqëson Shtetin si Pronar të Shoqërive të Sektorit të Energjisë Elektrike, është përcaktuar, se: *“Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, emërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi,*

duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Duke marrë në konsideratë ndarjen II “Statusi ligjor dhe struktura e shoqërisë”, pika 3, të Programit të Pajtushmërisë, rezulton se emërimi i anëtarëve është bërë duke respektuar kufizimet e imponuara nga neni 54 i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

4.3.2.2 Administratori

Për periudhën 1.1.2024–31.12.2024, OST-ja është drejtuar nga administratori i emëruar, me vendim nr. 3, datë 28.3.2022, të Këshillit Mbikëqyrës, me të cilin është lidhur kontrata për administrimin e shoqërisë, ku parashikohen kushte për ushtrimin e funksionit, duke shmangur konfliktin e interesit, si dhe ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të ndjeshëm tregtar, e cila është nënshkruar nga administratori i shoqërisë.

Emërimi i administratorit të shoqërisë është bërë në bazë të parashikimeve të nenit 158 të ligjit për shoqëritë tregtare, si dhe në bazë të nenit 20.1, të statutit të OST-së.

4.3.2.3 Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

Për periudhën 1.1.2024–31.12.2024, Këshilli Mbikëqyrës ka zhvilluar 13 mbledhje, në të cilat janë miratuar 14 vendime.

Zyrtari i Pajtushmërisë nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e zhvilluara.

Pjesëmarrja e Zyrtarit të Pajtushmërisë në mbledhjet e organeve të shoqërisë, siç është Këshilli mbikëqyrës është një e drejtë që buron nga kontrata për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtushmërisë (pika 56 dhe 57) dhe është veçanërisht e detyrueshme ndjekja e mbledhjeve/takimeve të përcaktuara në pikën 3.1.8 të kontratës. OST-ja ka detyrimin t’i ofrojë Zyrtarit të Pajtushmërisë të gjitha kushtet për përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër, sipas kontratës (shih nenin 5 të kontratës – detyrimet e OST-së).

4.3.2.4 Drejtuesit e OST-së

Në referim të pikës B.1 të Programit të Pajtushmërisë, drejtuesit e OST-së, të tillë si kryetari dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, administratori dhe stafi drejtues (drejtuesit e njësive strukturore), duhet të jenë të pavarur nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të përditshme. Ky detyrim përfshin dhe punonjësit të raportojnë



direkt te menaxhimi për çështje që kanë të bëjnë me operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit.

Programi i Pajtuëshmërisë përcakton disa kërkesa të cilat janë marrë në konsideratë nga Zyrtari i Pajtuëshmërisë për të gjykuar në lidhje me pavarësinë e punonjësve që mbajnë poste drejtuese në OST, e konkretisht: punësimin/lidhjen profesionalisht me kompani vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, përcaktimi i pagës për këta punonjës, interesi ose përfitimet financiare në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, transferimi nga këto kompani dhe anasjelltas, zotërimi ose jo i aksioneve në këto kompani.

Në lidhje me këto kritere, është kërkuar informacion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të OST për personat e emëruar në poste drejtuese për vitin 2024, *background-in* e tyre profesional sipas CV-ve, librezën e tyre të punës, si dhe kontratën individuale të punës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezulton se:

Është lidhur kontratë e re pune për 1 (një) punonjës në nivel drejtori dhe për 1 (një) punonjës në nivel shef sektori. Nuk rezulton që këta punonjës të kenë pasur marrëdhënie pune/interesi/përfitime financiare nga kompanitë shtetërore të prodhimit apo shpërndarjes së energjisë elektrike.

Gjithashtu, janë bërë ndryshime pozicionesh duke kaluar në shef sektori 3 (tre) punonjës të brendshëm të OST-së.

Paga e tyre është përcaktuar në bazë të udhëzimit dhe strukturës së pagave të OST-së miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.

Nuk ka ndonjë informacion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për konflikt të mundshëm interesi për punonjësit aktualë apo atyre të punësuar rishtazi.

Mostransferimi i stafit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike te ndërmarrjet/sipërmarrjet që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit, apo furnizimit të energjisë elektrike, është një nga kushtet e vendosura në vendimin e ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a., në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe në nenin 9,

pika 6, të direktivës 2009/72/EC, mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Në përmbushje të këtij detyrimi, OST-ja ka parashikuar në kontratën kolektive të punës një klauzolë ku përcaktohet se punonjësit që mbajnë pozicione “drejtori” dhe raportojnë direkt tek administratori i shoqërisë dhe “shef sektori” të lidhur me aktivitetet e përditshme të shoqërisë, nuk do të punësohen te ndërmarrjet/sipërmarrjet që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike, për një periudhë 1-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies së punës me OST sh.a. dhe ka informuar ERE-n mbi këtë përcaktim, me anë të shkresës nr. 2143 prot., datë 16.3.2018.

Në dhjetor të vitit 2022 ka përfunduar afati i Kontratës Kolektive të Punës, por në zbatim të nenit 73 të saj, zbatimi i aplikimit të ndalimit të punësimit te ndërmarrjet/sipërmarrjet që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit, apo të furnizimit të energjisë elektrike, i parashikuar në nenin 54 të saj, do të vazhdojë të jetë në fuqi deri në nënshkrimin e kontratës së re kolektive.

Kontrata individuale e punës e hartuar në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, akteve nënligjore në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e punës, si dhe akteve të brendshme të shoqërisë të detyrueshme për t’u zbatuar, përmban parashikime në lidhje me mënyrën e përdorimit dhe trajtimit të informacionit konfidencial nga punonjësit që janë në dijeni të tij, për shkak të pozicionit që ato mbajnë, që është një nga kriteret e pavarësisë së punonjësve gjatë ushtrimit të detyrës së tyre.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij kriteri, parashikimet e ligjit për sektorin e energjisë elektrike dhe të akteve të tjera në fuqi mbi trajtimin e informacionit konfidencial, si dhe sekretit tregtar që punonjësit e OST-së vihen në dijeni për shkak të detyrës, të gjithë punonjësit në pozicione drejtuese në OST sipas kategorive të përcaktuara në Aneksin bashkëlidhur Kontratës Kolektive nr. 8336 prot., datë 16.12.2019, kanë nënshkruar marrëveshjen e konfidencialitetit. Këto ndryshime i janë bërë me dije ERE-s me anë të shkresës 3524/2, datë 10.6.2021.

Nga informacioni i marrë pranë DBNJ-së, rezulton se edhe punonjësit e rinj të punësuar gjatë vitit 2024 kanë nënshkruar marrëveshjen e konfidencialitetit.



4.3.3 Pavarësia financiare

Monitorimi i përmbushjes së këtij detyrimi është bërë duke marrë parasysh programin ekonomik për vitin 2024 dhe miratimin e tij, pasqyrat financiare, si dhe audituesit ligjorë të emëruar.

4.3.3.1 Programi ekonomik

Në lidhje me këtë kriter janë marrë në shqyrtim miratimi i programit ekonomik për vitin 2024, si dhe emërimi i audituesve ligjorë për auditimin e pasqyrave financiare.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton, se:

Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a. me vendim nr. 17, datë 14.12.2023, ka miratuar programin e zhvillimit ekonomik të OST-së për vitin 2024, miratuar me shkresë nr. 716/1, datë 6.2.2024, të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në cilësinë e Aksionarit të Vetëm.

Për të hartuar Programin e Zhvillimit Ekonomik janë marrë parasysh faktorët e mëposhtëm⁸:

- Parashikimet afatmesme dhe afatgjata të investimeve, programimi i shpenzimeve operative të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit normal në funksion të një shërbimi sa më të plotë dhe cilësor dhe përdorimi me efikasitet i aseteve të shoqërisë;

- Kërkesat e Njësie Operative drejtuar OST-së;

- Realizimet ndër vite për secilin zë, realizimi faktik 9-mujor për vitin 2023, si dhe parashikimi për pritshmërinë e vitit 2023;

- Struktura organizative e OST sh.a.;

- Kërkesat që dalin nga aderimi i OST sh.a. në organizmat ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2024, programi ekonomik është ndryshuar me vendimet e Këshillit Mbikëqyrës si vijon:

- Vendim nr. 4, datë 29.5.2024, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 17, datë 14.12.2023, Për miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a. për vitin 2024”;

- Vendim nr. 8, datë 18.7.2024, “Për një ndryshim në vendimin nr. 17, datë 14.12.2023, Për miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a. për vitin 2024”. Ky ndryshim i planit financiar është miratuar me anë të shkresës nr. 10027/1 prot., datë 5.8.2024, të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në cilësinë e Aksionarit të Vetëm;

- Vendim nr. 11, datë 31.10.2024, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 17, datë 14.12.2023, Për miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a. për vitin 2024”.

Këto ndryshime janë kryer me qëllim përshtatjen e programit ekonomik me kushtet aktuale e teknike të OST-së dhe kanë konsistuar konsistuar në rishikimin e tabelës së projekteve të investimeve me fondet e OST sh.a.

4.3.3.2 Pasqyrat financiare

Pasqyrat financiare të OST-së përgatiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“IASB”) dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare (“IFRIC”) të IASB-së.

Me vendim nr. 1, datë 18.4.2024, të Këshillit Mbikëqyrës janë miratuar pasqyrat financiare individuale dhe të konsoliduara të OST-së për vitin 2023.

Me vendim nr. 19, datë 16.5.2024, të aksionarit të vetëm, janë miratuar pasqyrat financiare të OST-së për vitin 2023 të certifikuara nga audituesit ligjorë.

Me shkresën nr. 16509 prot., datë 31.12.2024, të aksionarit të vetëm, janë caktuar audituesit ligjorë për kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm dhe certifikimin e pasqyrave financiare të OST sh.a. për vitin 2024.

Më datë 28 mars 2025 audituesit ligjorë kanë paraqitur raportin e auditimit për pasqyrat financiare individuale të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024, ku kanë shprehur opinion pa rezerva mbi këto pasqyra.

Referuar opinionit të audituesve ligjorë, pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024, paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë më 31 dhjetor 2024, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Aktualisht, është në proces finalizimi auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të shoqërisë, ndërkohë që vijon auditimi i pasqyrave financiare të

⁸ Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria Ekonomike, materialet shpjeguese dërguar Këshillit Mbikëqyrës për miratimin e programit ekonomik për vitin 2024.



projekteve, në përputhje me kërkesat e raportimit të donatorëve.

4.3.3.3 Audituesit ligjorë

Me shkresë nr. 16509 prot., datë 31.12.2024, ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka emëruar audituesit ligjorë për të kontrolluar dhe certifikuar llogaritë vjetore të OST-së për vitin 2024.

Në vijim, me qëllim garantimin e pavarësisë së audituesve ligjorë që është një nga kërkesat e vendimit të ERE-s për certifikimin e OST-së si operator i pavarur, me anë të shkresës nr. 1673 prot., datë 17.3.2025, OST-ja i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e përfaqësuesit të aksionarit të vetëm për shoqëritë KESH dhe OSHEE, duke e informuar mbi audituesit ligjorë të caktuar për auditimin e pasqyrave financiare të OST-së për vitin 2024, me qëllim garantimin e pavarësisë së audituesve të emëruar për auditim në shoqëritë KESH dhe OSHEE.

Kontrata nr. 808 prot., datë 4.2.2025, “Për kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të Pasqyrave Financiare Individuale, Pasqyrave Financiare të Konsoliduara, si dhe Pasqyrave të Projekteve të financuara me fonde të huaja, për vitin ushtrimor të mbyllur më 31.12.2024 të shoqërisë OST sh.a.”, lidhur ndërmjet OST dhe audituesve ligjorë, përmban klauzola mbi konfidencialitetin e informacionit të mbledhur gjatë kryerjes së shërbimit nga ekspertët, si dhe përgjegjësinë për dëmshpërblim në rast të shkeljes së tyre.

4.3.4 Pavarësia operationale

Pavarësia operationale ka të bëjë me: i. burimet e duhura teknike, njerëzore apo të tjera të nevojshme për të operuar në mënyre efiente; dhe ii. një seri kufizimesh në marrëdhëniet me kompanitë vertikalisht të integruara, të cilat sigurojnë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, referuar kushteve të Programit të Pajtueshmërisë.

Rezulton se stafi i OST nuk ka marrëdhënie punësimi me kompanitë vertikalisht të integruara që kryejnë ose janë të angazhuara në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror ose degë të tyre.

Gjithashtu, OST-ja siguron shërbime të suportit teknik nga palë të treta në bazë të kontratave të lidhura.

Nga verifikimi i këtyre kontratave rezulton se ato janë në pajtueshmëri me kushtet e Programit të Pajtueshmërisë (klauzolat e konfidencialitetit).

- Sa i përket ndarjes së ndonjë sistemi informacioni (në terma të *hardware* dhe *software*) me ndonjë nga kompanitë vertikalisht të integruara që kryejnë ose janë të angazhuara në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror ose degë të tyre ose kontraktorë të tyre, në lidhje me sistemet e tyre të sigurisë dhe të informacionit, pas marrjes së informacionit nga Departamenti i Operimit të Sistemit, ka rezultuar se:

Përgjatë vitit 2024, nuk rezulton që OST-ja të ketë ndarë ndonjë sistem informacioni nga pikëpamja *Hardware*. Në lidhje me pjesën *Software*, OST-ja merr informacione nga disa sisteme SCADA të KESH-it dhe OSHEE-së, për qëllime monitorimi të nënstacioneve, si dhe në bazë të kërkesave që duhet të plotësojnë përdoruesit e lidhur në rrjetin e OST-së, referuar Kodit të Transmetimit.

Për sa më lart, shkëmbimi i informacionit bëhet në respektim të dispozitave të Kodit të Transmetimit në lidhje me konfidencialitetin e, konkretisht: nenit 9 “Komunikimi ndërmjet OST-së dhe përdoruesve” dhe neni 10 “Konfidencialiteti”.

Shpjegime të hollësisht mbi sigurinë e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar janë dhënë në pikën 4.2.1 të këtij raporti.

KAPITULLI II

5. Zbatimi i rekomandimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë për një implementim sa më eficient të Programit të Pajtueshmërisë

Kjo pjesë e raportit paraqet masa e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ZP në raportin e vitit 2023.

5.1 Njoftimi zyrtar dhe pjesëmarrja e ZP-së në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

Si një detyrim që lind nga përcaktimet e Programit të Pajtueshmërisë së OST dhe duke marrë parasysh faktin që gjatë vitit 2024 (periudha Nëntor-Dhjetor 2024) ZP nuk është njoftuar mbi mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës, rekomandoj që strukturat përkatëse të OST të njoftojnë zyrtarisht ZP për pjesëmarrje në mbledhjet e këshillit dhe veçanërisht ato të përcaktuara në pikat 56.1, 56.2 dhe 56.3 të Programit të Pajtueshmërisë që do të zhvillohen në vijim, si dhe t'i vënë në dispozicion materialet e nevojshme të mbledhjeve.

Ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.



5.2 Trajnimet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave/sekretit tregtar

Në funksion të përmbushjes së parashikimeve të ligjit për sektorin e energjisë dhe përcaktimeve të Programit të Pajtueshmërisë për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave/informacionit të ndjeshëm tregtar, është e rëndësishme kryerja e trajnimeve të vazhdueshme me të gjithë punonjësit e OST dhe veçanërisht me ato punonjës që kanë të drejta akses në platformat elektronike të OST.

Në lidhje me këtë pikë, nga Zyrtari i Pajtueshmërisë është rekomanduar hartimi dhe përgatitja e një programi trajnues nga Sektori i Politikave të Sigurisë së Informacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve TI dhe Drejtorinë e Shërbimeve të Automatizuara të Rrjetit, i cili të përmbajë tema të veçanta dhe të personalizuar sipas platformave në menaxhim dhe punonjësve që do të trajnohen. Nga verifikimi i kryer, rezulton se gjatë vitit 2024 është bërë asistim i vazhdueshëm i punonjësve të rinj nga punonjësit aktualë dhe me eksperiencë në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave/informacionit të ndjeshëm apo sekretit tregtar për punonjësit të cilët kanë akses në platformat që OST menaxhon, në respektim të politikave të sigurisë së informacionit dhe marrëveshjeve individuale të konfidencialitetit. Nga Sektori i Politikave të Sigurisë Kibernetike janë dërguar email-e ndërgjegjësimi për stafin në Aparatin Qendror në kuadër të Sigurisë së Informacionit me qëllim rritjen e vëmendjes dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e Sigurisë Kibernetike.

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

5.3 Informimi i ZP mbi vënien në dispozicion të të tretëve të rrjetit të fibrave optive (OPGW) që OST zotëron

Duke qenë se OST ka tashmë si objekt të veprimtarisë së saj zhvillimin dhe funksionimin në fushën e komunikimeve elektronike sikurse është vënia në dispozicion e rrjetit të fibrave optike (OPGW) në dispozicion të të tretëve, është rekomanduar që ZP të informohet vazhdimisht nga Drejtoria e Shërbimeve të Telekomunikacionit mbi ecurinë e projektit, si dhe t'i vihet në dispozicion paraprakisht draft-kontrata që do të lidhet me të tretët, në lidhje me kushtet që do të vendosen për sigurinë e sistemit të transmetimit, si dhe sigurinë kibernetike.

Nga informacioni i marrë, trajtuar në pikën 4.1.2.1, rezulton që ky informacion i është vënë në

dispozicion Zyrtarit të Pajtueshmërisë në momentin që është kërkuar për hartimin e këtij raporti.

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

5.4 Rishikimi dhe përditësimi i Programit të Pajtueshmërisë

Duke marrë në konsideratë ndryshimet më të fundit në aktet ligjore, nënligjore, rregullatore, si dhe të strukturës organizative të OST është rekomanduar që OST të bëjë rishikimin e Programit të Pajtueshmërisë, duke reflektuar në të ndryshimet e përmendura me lart.

Nga verifikimi i kryer rezulton që Programi i Pajtueshmërisë nuk është rishikuar.

Për sa më lart, rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

6. Rekomandimet e Zyrtarit të Pajtueshmërisë për një implementim sa më eficient të Programit të Pajtueshmërisë

Kjo pjesë e raportit paraqet procedurat e nevojshme që duhen ndjekur për të zhvilluar dhe implementuar një seri veprimesh të cilat do të aktivizojnë sensin e kulturës korporative për ndërgjegjësimin e stafit të shoqërisë mbi çështjet e pajtueshmërisë.

6.1 Njoftimi zyrtar dhe pjesëmarrja e ZP në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

Si një detyrim që lind nga përcaktimet e Programit të Pajtueshmërisë së OST dhe duke marrë parasysh faktin që gjatë vitit 2023 ZP nuk është njoftuar mbi mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës, rekomandoj që strukturat përkatëse të OST të njoftojnë zyrtarisht ZP për pjesëmarrje në mbledhjet e këshillit dhe veçanërisht ato të përcaktuara në pikat 56.1, 56.2 dhe 56.3 të Programit të Pajtueshmërisë që do të zhvillohen në vijim, si dhe t'i vënë në dispozicion materialet e nevojshme të mbledhjeve.

6.2 Trajnimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave/informacionit të ndjeshëm tregtar

Në funksion të përmbushjes së parashikimeve të ligjit për sektorin e energjisë dhe përcaktimeve të Programit të Pajtueshmërisë për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave/informacionit të ndjeshëm tregtar, është e rëndësishme kryerja e trajnimeve të vazhdueshme me të gjithë punonjësit e OST dhe veçanërisht me ato punonjës që kanë të drejta akses në platformat elektronike të OST.

Në lidhje me këtë pikë, rekomandoj mbajtjen në fokus të veçantë nga Sektori i Politikave të Sigurisë së Informacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve TI dhe Drejtorinë e Shërbimeve të



Automatizuara të Rrjetit, informimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve dhe veçanërisht të atyre të punësuar rishtazi për ruajtjen e konfidencialitetit të dhënave/informacionit të ndjeshëm tregtar.

6.3 Informimi i ZP mbi vënien në dispozicion të të tretëve të rrjetit të fibrave optive (OPGW) që OST zotëron

Duke qenë se OST do të vijojë me veprimtaritë e ardhshme në fushën e komunikimeve elektronike sikurse është vënia në dispozicion e rrjetit të fibrave optike (OPGW) në dispozicion të të tretëve, rekomandoj që ZP të vijojë të informohet vazhdimisht nga Drejtoria e Shërbimeve të Telekomunikacionit mbi ecurinë e projektit, si dhe t'i vihet në dispozicion paraprakisht draft-kontrata që do të lidhet me të tretët, në lidhje me kushtet që do të vendosen për sigurinë e sistemit të transmetimit, si dhe sigurinë kibernetike.

6.4 Rishikimi dhe përditësimi i Programit të Pajtueshmërisë

Duke marrë në konsideratë ndryshimet më të fundit në aktet ligjore, nënligjore, rregullatore, si dhe të strukturës organizative të OST duhet bërë rishikimi i Programit të Pajtueshmërisë me qëllim përshtatjen me ndryshimet më të fundit.

Përsa më lart, rekomandoj që OST të bëjë rishikimin e Programit të Pajtueshmërisë, duke reflektuar në të ndryshimet më të fundit ligjore, nënligjore, rregullatore, si dhe ndryshimet e strukturës organizative të OST.

KAPITULLI III

7. Konkluzione

Duke marrë në konsideratë sa është reflektuar në këtë raport për vitin 2024, në kuadër të angazhimeve të marra përsipër nga OST-ja me certifikimin e tij si operator i pavarur i transmetimit të energjisë elektrike, si dhe në përballje me sfidat që vijnë nga operimi i tregut të balancimit i cili ka mundur kalimin përfundimtar nga një mekanizëm i rregulluar me entitete publike, në një liberalizim të tregut të energjisë balancuese, ku çdo palë ofruese e shërbimeve të balancimit mund të marrë pjesë dhe të bëhet konkurruese me produktet e saj për shërbimet e balancimit, shoqëria ka bërë përpjekje dhe angazhohet vazhdimisht në përmbushjen e kushteve të pavarësisë së shoqërisë në drejtim të:

i. sigurimit të shërbimeve të nevojshme për balancimin e sistemit, në kohë reale, bazuar në parimet e tregut të hapur, transparent dhe

jodiskriminues për të gjitha palët ofruese të shërbimeve të balancimit; dhe

ii. trajtimin e barabartë të përdoruesve të sistemit të transmetimit në drejtim të transparencës dhe aksesit të barabartë për të gjithë përdoruesit, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator që drejton sektorin e energjisë elektrike.

Gjithashtu, rezulton se shoqëria ka ruajtur më së miri pavarësinë e saj nga kompanitë vertikalisht të integruara, që kryejnë ose janë të angazhuara në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, duke marrë në konsideratë:

i. pavarësinë e menaxhimit, në vlerësim të kriterëve që kanë të bëjnë me punësimin/lidhjen profesionalisht me kompani vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, përcaktimit të pagës për këta punonjës, interesit ose përfitimeve financiare në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, transferimit nga këto kompani dhe anasjelltas, zotërimit ose jo i aksioneve në këto kompani, si dhe zbatimit të klauzolës së ndalimit të punësimit të ndërmarrjet/sipërmarrjet që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike;

ii. pavarësinë financiare, në vlerësim të hartimit të pasqyrave financiare, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare ("IFRIC") të IASB-së; si dhe

iii. pavarësinë operacionale, në vlerësim të veprimtarisë së kryer duke respektuar klauzolat e konfidencialitetit gjatë shkëmbimit të informacionit me kompanitë e prodhimit apo shpërndarjes apo palët e treta.

Raporti i vitit 2024 nuk nxjerr në pah ndonjë shkelje të qenësishme që të rezultojë në mosplotësim të ndonjë prej kërkesave të pajtueshmërisë që do të cenonte: i. pavarësinë e OST-së nga kompanitë vertikalisht të integruara që kryejnë ose janë të angazhuara në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror; ii. konfidencialitetin e të dhënave dhe të informacionit të ndjeshëm tregtar; si dhe iii. trajtimin e barabartë të përdoruesve të sistemit. Vlen të theksohet që janë për t'u vlerësuar përpjekjet e



bëra dhe masat e marra në kuadër të sigurisë kibernetike dhe sigurisë së informacionit, duke shmangur në këtë mënyrë incidente si për shërbimet e brendshme të sistemit, ashtu dhe për shërbimet që operatorët e tjerë përfitojnë nëpërmjet rrjetit e të dhënave me fibër optike, duke ndikuar në këtë mënyrë në një operim të sigurt të sistemit.

Vijimi i një bashkëpunimi të ngushtë dhe të vazhdueshëm të organeve drejtuese, si dhe i stafit të shoqërisë me Zyrtarin e Pajtueshmërisë, është një domosdoshmëri për përmbushjen e plotë, brenda afateve të përcaktuara, si dhe në cilësinë e duhur, të detyrimeve që burojnë nga kontrata për ofrimin e shërbimeve të ZP-së, me qëllim identifikimin dhe shmangien e rasteve të sjelljeve diskriminuese ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit dhe ofruesve të shërbimeve të balancimit, ruajtjen e të dhënave dhe të informacionit të ndjeshëm tregtar, si dhe pavarësinë e stafit drejtues dhe punonjësve të tjerë të shoqërisë në shmangien e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës së tyre.

Ndërgjegjësimi i stafit të shoqërisë mbi Programin e Pajtueshmërisë, si dhe respektimi i detyrimeve të përcaktuara në të, të monitoruara prej Zyrtarit të Pajtueshmërisë ndihmon në krijimin e një kulture korporative mbi çështjet e pajtueshmërisë.

Në përfundim, përfshirja e Zyrtarit të Pajtueshmërisë, brenda kuadrit të detyrave të ngarkuara nga Programi i Pajtueshmërisë dhe kontrata e ZP-së, si dhe informimi i vazhdueshëm i tij nga strukturat përkatëse mbi çdo problematikë të shfaqur dhe që cenon shtyllat kryesore që sigurojnë parimet themelore të veprimtarisë së OST-së, konsiderohet një hap i rëndësishëm për mbikëqyrjen dhe garantimin e respektimit të këtyre primeve.

Tiranë, më 29.4.2025

Brunilda Veizi

Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST sh.a.

**Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 337, datë
18.12.2025**

VLERËSIMI I RAPORTIT VJETOR TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES PËR VITIN 2024

Enti Rregullator i Energjisë (ERE), në cilësinë e autoritetit rregullator të pavarur për sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në Shqipëri, ka një rol të rëndësishëm në garantimin e funksionimit të drejtë, transparent dhe jodiskriminues të tregut të energjisë elektrike. Një nga mekanizmat kyç të këtij funksioni mbikëqyrës është analiza dhe vlerësimi i raportit vjetor të pajtueshmërisë, i hartuar nga Zyrtari i Pajtueshmërisë të operatorëve të sistemit të energjisë elektrike. Qëllimi i analizës së raportit vjetor të pajtueshmërisë është të sigurojë se shoqëria po respekton në praktikë ndarjen e funksioneve, mbron informacionin konfidencial dhe nuk favorizon palë të treta të lidhura në mënyrë të padrejtë etj.

Kjo detyrë e ERE-s mbështetet në nenin 54 “Ndarja e pronësisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit” dhe 58 “Certifikimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, i cili përcakton parimin e ndarjes ligjore, funksionale dhe organizative të operatorëve të sistemit të shpërndarjes dhe transmetimit që operojnë në sektorin e energjisë elektrike dhe që janë pjesë e një grupi të integruar vertikalisht, në vendimin të Bordit të ERE-s nr. 103, datë 30.4.2018, ku përcaktohen detyrimet e OST sh.a. për zbatimin dhe monitorimin e Programit të Pajtueshmërisë, si dhe roli i Zyrtarit të Pajtueshmërisë në raportim dhe mbikëqyrje. Vendimet nr. 194/2019 dhe nr. 252/2024 përcaktojnë obligimet e OST sh.a. për raportimin mbi përdorimin e rrjetit OPGW dhe kryerjen e detyrave të Zyrtarit të Pajtueshmërisë deri në miratimin e emërimit të tij nga ERE, si dhe nenin 9 të direktivës 2009/72/EC, dhe çdo akt tjetër ligjor në aspekt të këtij detyrimi.

Duke konsideruar raportin vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të OST sh.a. për vitin 2024, si një dokument zyrtar, që synon të informojë rregullatorin mbi masat e marra për zbatimin e detyrimeve të Programit të Pajtueshmërisë dhe për sigurimin e një veprimtarie të pavarur, transparente



dhe jodiskriminuese të operatorit në treg; duke vlerësuar se raporti për vitin 2024 është hartuar dhe dorëzuar në përputhje me afatet dhe standardet e përcaktuara në program, është i strukturuar sipas metodologjisë së kontrollit të miratuar dhe reflekton zbatimin e shumicës së rekomandimeve të mëparshme të ERE-s,

VLERËSON:

Në vijim të shqyrtimit të raportit vjetor për vitin 2024, në zbatim të Programit të Pajtushmërisë, Bordi i ERE-s konstaton:

1. OST sh.a. ka përmbushur pjesërisht detyrimet thelbësore që rrjedhin nga Programi i Pajtushmërisë, ligji nr. 43/2015 dhe aktet rregullatore në fuqi.

2. Veprimtaria e OST sh.a. gjatë vitit raportues është zhvilluar përgjithësisht në përputhje me parimet e mosdiskriminimit, transparencës dhe ndarjes funksionale.

3. Përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe institucionale për dorëzimin e raportit në gjuhën shqipe dhe angleze.

4. Zbatimin e një metodologjie, të strukturuar kontrolli për mbledhjen dhe analizimin e informacionit, përfshirë monitorimin e proceseve vendimmarrëse të operatorit, kontratave, ankesave dhe të dhënave të raportuara nga strukturat e brendshme.

5. Statusi ligjor i shoqërisë; në përputhje me Programin, dhe detyrimet ligjore është garantuar ndarja dhe pavarësia e OST sh.a. Shoqëria ka si aksionar të vetëm shtetin, sipas VKM-së nr. 317/2016, çka siguron pavarësi operative dhe institucionale nga operatorët e tjerë të sektorit energjetik në **përputhje** me kërkesat ligjore në fuqi.

6. Struktura organizative e OST-së: struktura organizative është konceptuar në mënyrë të tillë që të mbështesë ndarjen funksionale të përgjegjësisë, të sigurojë pavarësinë operative dhe të mundësojë përmbushjen efektive të detyrimeve ligjore dhe rregullatore të shoqërisë. Emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe i administratorit është realizuar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 43/2015, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 317/2016 dhe statutit të OST-së. Vendimet përkatëse të Asamblesë së Përgjithshme, që lidhen me emërimet dhe riemërimet, janë publikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, duke garantuar transparencë dhe respektim të kërkesave ligjore.

7. Ndarja dhe pavarësia e OST-së: pavarësia institucionale e OST-së gjatë vitit 2024 është garantuar në përputhje me kërkesat e nenit 54 dhe 58 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike. Gjithashtu, shoqëria demonstroi pavarësi të plotë financiare dhe respekton standardet e raportimit dhe transparencës të kërkuara nga ERE dhe Traktati i Komunitetit të Energjisë, si dhe ka respektuar pavarësinë operacionale, duke përmbushur detyrimet që burojnë nga rregullorja e ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020 dhe marrëveshjet me SEE CAO e ENTSO-E. OST sh.a. ka përmbushur detyrimet ligjore dhe rregullatore për pavarësinë funksionale dhe vendimmarrëse. Detyrimi për pavarësinë e audituesit financiar është përmbushur plotësisht. Zyrtari ka vlerësuar se OST-ja ka respektuar parimet e vendosjes së pagave dhe ndalesës së punësimit/transferimit, duke garantuar pavarësinë e drejtuesve.

8. Përfshirja e sjelljes diskriminuese: OST sh.a. ka zbatuar parimet e përfshirjes të sjelljes diskriminuese dhe menaxhimit të konfliktit të interesit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe Programin e Pajtushmërisë. Kontratat dhe dokumentacioni përkatës janë administruar dhe arkivuar rregullisht dhe kanë qenë të disponueshme për verifikim. Gjatë periudhës raportuese nuk janë paraqitur ankesa, raportime apo raste të evidentuara lidhur me konfliktin e interesit nga drejtuesit, punonjësit apo palët e treta, çka dëshmon funksionimin e mekanizmave parandalues dhe të kontrollit të brendshëm të shoqërisë.

9. Siguria dhe sistemet e informacionit: gjatë vitit 2024, OST-ja ka garantuar sigurinë e informacionit përmes sistemeve të sigurta dhe të kontrolluara për përpunimin e të dhënave teknike dhe tregtare, në përputhje me standardet e ENTSO-E dhe Programin e Pajtushmërisë. Masat e sigurisë kibernetike janë zbatuar në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe standardet e BE-së, ndërsa menaxhimi i riskut është realizuar në mënyrë proaktive dhe të dokumentuar. Kontrolli mbi të dhënat sensitive dhe transparenca kanë qenë efektive. Gjatë vitit 2024 nuk janë raportuar incidente të sigurisë kibernetike.

10. Informacioni publik: gjatë vitit 2024, OST sh.a. ka respektuar pjesërisht kërkesat e Programit të Pajtushmërisë lidhur me informacionin publik. Informacioni me karakter publik, i cili nuk klasifikohet si konfidencial apo tregtarisht i



ndjeshëm, është vënë në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut, përdoruesve të rrjetit dhe palëve të treta, në përputhje me legjislacionin në fuqi. OST-ja ka publikuar në faqen zyrtare informacionin e kërkuar mbi shërbimet e ofruara, kushtet teknike për akses dhe lidhje me sistemin e transmetimit, si dhe të dhëna mbi kapacitetet e sistemit dhe vëllimet e energjisë së transmetuar.

11. Monitorimi i zbatimit të Programit: Zyrtari i Pajtuëshmërisë ka realizuar shumicën e detyrave të përcaktuara në Programin e Pajtuëshmërisë, duke përfshirë monitorimin e zbatimit të Programit, raportimin vjetor, dhënien e rekomandimeve brenda OST, hetimin e shkeljeve të pretenduara, menaxhimin e konflikteve të interesit, koordinimin me ERE dhe autoritetet e tjera, si dhe dhënien e opinioneve mbi përputhshmërinë e dokumenteve dhe veprimeve të OST Sh.a.,

REKOMANDON:

1. Zyrtari i Pajtuëshmërisë të raportojë në mënyrë të plotë, të qartë dhe të strukturuar mbi strukturën aktuale organizative, funksionale dhe teknike të OST sh.a., duke pasqyruar ndarjen e funksioneve, linjat e varësisë dhe përgjegjësitë përkatëse, si dhe çdo ndryshim të kryer gjatë vitit raportues 2024 ose konstatimin e mungesës së ndryshimeve. Raportimi duhet të përfshijë, gjithashtu, vendimarrjet përkatëse për miratimin, apo ndryshimin e strukturës organizative, si dhe planifikimin e ndryshimeve të mundshme në përputhje me nevojat operationale të shoqërisë.

2. Ky raportim duhet të realizohet në përputhje me përcaktimet e Programit të Pajtuëshmërisë, përfshirë dispozitat përkatëse mbi statusin ligjor dhe strukturën e shoqërisë, si dhe me strukturën organizative të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, me qëllim garantimin e vazhdueshëm të pavarësisë funksionale, menaxheriale dhe vendimmarrëse të operatorit. Raportimi rekomandohet të kryhet brenda dy muajve të parë të vitit pasardhës.

3. Informacioni publik: konstatohet se gjatë vitit 2024 nuk është publikuar metodologjia për përcaktimin e tarifës, siç parashikohet në pikën 43.2, germa “C”, të Programit të Pajtuëshmërisë. Rekomandohet që OST sh.a. të publikojë metodologjitë përkatëse në faqen zyrtare, në përputhje me kërkesat e Programit të Pajtuëshmërisë. Zyrtari i Pajtuëshmërisë duhet të monitorojë dhe të raportojë pranë ERE-s

përbushjen e këtij detyrimi, brenda afateve të përcaktuara.

4. Monitorimi i zbatimit të Programit: rekomandohet forcimi i monitorimit të trajnimeve dhe udhëzimeve, përfshirë zhvillimin e trajnimeve të detajuara për stafin e ri përpara fillimit të detyrës, si dhe vendosja e një mekanizmi të qartë dhe të dokumentuar për raportimin dhe ndjekjen e shkeljeve të Programit të Pajtuëshmërisë. Gjithashtu, rekomandohet sigurimi i përbushjes së plotë të detyrimeve lidhur me informacionin publik, përfshirë publikimin e të dhënave të kërkuara nga Programi, veçanërisht metodologjitë për përcaktimin e tarifave të transmetimit dhe të tarifës së lidhjes, si dhe përfshirja e një dokumentimi sistematik të udhëzimeve dhe konsultimeve të dhëna për stafin e OST sh.a. Rritja e transparencës në raportimin mbi investimet dhe propozimet e planit 10-vjeçar për rrjetin e transmetimit, duke marrë pjesë në takimet e strukturave përcaktuar kjo edhe në programin e pajtuëshmërisë

5. Rekomandohet që OST sh.a. dhe Zyrtari i Pajtuëshmërisë të marrin masat e nevojshme për përbushjen e plotë të rekomandimeve të dhëna nga ERE për vitin 2023, duke siguruar raportim të detajuar mbi veprimet e ndërmarra dhe nivelin e zbatimit të tyre, në përputhje me Programin e Pajtuëshmërisë dhe kuadrin rregullator në fuqi.

- Zyrtari i Pajtuëshmërisë të depozitojë pranë ERE-së informacion të detajuar mbi përdorimin e të ardhurave nga rrjeti OPGW, duke përfshirë analizën e kryer nga Drejtoria Teknike dhe vlerësimin e tij të pavarur, me qëllim garantimin e transparencës dhe pavarësisë financiare dhe operationale të OST sh.a., në përputhje me Programin e Pajtuëshmërisë dhe vendimin nr. 194/2019 dhe korrespondencave të realizuara për këtë qëllim gjatë vitit 2024.

- OST sh.a. të sigurojë njoftimin ndaj Zyrtarit të Pajtuëshmërisë për mbledhjet e planifikuara, Zyrtari i Pajtuëshmërisë të sigurojë marrjen pjesë në të gjitha mbledhjet e organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse të shoqërisë, përfshirë Këshillin Mbikëqyrës dhe Asamblenë e Përgjithshme, në përputhje me pikat 57 dhe 58 të germës “B” të Programit të Pajtuëshmërisë. Për këtë qëllim, të përmirësohen mekanizmat e njoftimit dhe komunikimit të brendshëm, duke garantuar aksesin e Zyrtarit në materialet dhe informacionet përkatëse përpara zhvillimit të mbledhjeve.



- Të përmirësohet niveli i detajimit dhe dokumentimit të rezultateve të monitorimit të ndryshimeve ligjore dhe rregullatore, lidhur me njohjen dhe zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë

KËRKESË

Shtetasi Ali Mukaj kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë shpalljen të vdekur të shtetasit Jeto Mukaj.

KËRKUES
Ali Mukaj

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 464 lekë

